# VEND / KULTURE / IDENTITETE

## nga brigjet e Vjoses ne internet

duke luajtur me muziken dhe fjalet

libri i nxenesit



# Vend / Kulture / Identitete
# Nga brigjet e Vjoses ne internet

## Duke luajtur me muzikën dhe fjalët
## Libri i nxenesit

Uneversiteti i Janinës, 2008

Vepra u realizua ne kuadrin e Programit INTERREG III / PROGRAMI I FQINJESISE GREQI – SHQIPERI
Boshti 2 – Metri 2.2. me bashkefinancim nga Fondi Evropian i Zhvillimit Periferik (F.E.ZH.P.) dhe nga Burime Kombetare.
Pergjegjes Shkencor: Anastasios Emvalotis, Profesor Asistent i Universitetit te Janines

Vend / Kulture / Identitete
Nga brigjet e Vjoses ne internet

Duke luajtur me muzikën dhe fjalët
Libri i nxenesit

ISBN: 978-960-233-190-3

copyright © Uneversiteti i Janinës, 2008

Anastasios Emvalotis
e-mail: aemvalot@uoi.gr

## Pjesmarrës botimi

***Përgjegjes shkencor i veprës***

Anastasios Emvalotis, Profesor Asistent i Universitetit te Janines

***Koordinues i veprimeve të veprës***

Dhimitris Paraskevakis

***Pergjegjes shkencor i grumbullimit i materialit kerkues***

Vasilis Niciakos, Profesor i Universitetit te Janinës

***Grupi Kerkues***

Kostas Manxhos, Vasilis Raptis, Kostas Lolis,
Niko Michail, Thomas Porikis

***Inçizim***

Nikos Dhionisopulos

***Përgjegjes shkencor i zhvillimit të materialit edukativ***

Jeorgjios Kapsalis, Profesor në Universitetin e Janinës

***Vlerësimi ë skenarëve edukativë***

Athanasios Verdis, Lektor në Universitetin e Athinës

***Grup i zhvillimit të skenarëve edukativë***

Vasiliki Basina, Vasiliki Leondari, Harilaos Nucos,
Athanasios Verdis, Tatiani Derdemezis, Fotini Mballomenu

***Përkujdesja e materialit pamor dëgjimor***

Tatiani Derdemeyis

***Përkujdesja e skenarëve edukativë në greqisht***

Fotini Mballomenu

***Përkujdesje e skenarëve edukativë në shqip***

Maria Sidheri-Skopi

***Digjitalizim I materialit***

Argjiris Janelos

***Planifikimi dhe përkujdesje grafike e botimit***

Jeorgjia Koloka

## Pasqyara e lëndës

Pershkrim i verpes ..... 4

Grupi i punës përbëhet ..... 6

Pak fjalët nga shkrimtarët ..... 7

Hyrje ë skenarëve edukativë ..... 9

Arti i tingullit ..... 11
- niveli 1 ..... 12
- niveli 2 ..... 20
- niveli 3 ..... 20

Cikli i jetës ..... 37
- niveli 1 ..... 38
- niveli 2 ..... 46
- niveli 3 ..... 58

Kafshët dhe natyra ..... 63
- niveli 1 ..... 64
- niveli 2 ..... 82
- niveli 3 ..... 96

Uji na fletë ..... 109
- niveli 1 ..... 110
- niveli 2 ..... 110
- niveli 3 ..... 110

Profesionet tradicionale ..... 133
- niveli 1 ..... 134
- niveli 2 ..... 146
- niveli 3 ..... 162

Mërgimi ..... 177
- niveli 1 ..... 178
- niveli 2 ..... 184
- niveli 3 ..... 197

Epilog ..... 213

## Nga brigjet e Vjoses ne internet

Vepra synon ne bashkepunimin kerkues Greqi–Shqiperi me qellim paraqitjen e elementeve te perbashketa kulturore ne zonen nderkufitare si dhe vleresimin pedagogjik e didaktik me ndihmen e Teklologjive te Informacionit dhe te Komunikimeve. Vecanerisht, brenda nga fusha e kerkimit sistematik shkencor u bene regjistrime ne zonen e aplikimit te programit. Vendi ku u zgjodh per grumbullimin e materialit empirik, qe ishin krahinat e Konices ne Greqi, dhe e Permetit ne Shqiperi, mund te perfytyrohet brenda nga takimi i dy kufijve. Njeri, kufiri politik rezultat i zhvillimeve historike, dhe tjetri, lumi Vjosa, qe duke u nisur nga malet e Pindit pershkon ne menyre te njepasnjeshme fushen e Konices dhe luginen e Permetit, duke krijuar nje «tjeter» lidhje territori, qe cojne ne kohe te ndryshme nga ato te kufirit politik. Historiku i kufirit (politik) dhe historiku i lumit cojne ne historikun e grupeve shoqerore qe jetojne ne brigjet e tij. Duke u bazuar ne kete historik ose ne historike, nderhyrja kerkimore perpiqet te paraqese te dhena te zonave ne Greqi dhe ne Shqiperi qe bashkohen dhe ndahen njekohesisht nga kufiri dhe lumi dhe t'i vleresoje didaktikisht ne Arsimin e Shalles se Pare. Veprimet e vepres perfshijne kerkimin bibliografik, grumbullim ne vend, krahasimin dhe vleresimin e meterialit kerkues me emfaze ne traditen muzikore popullore dhe zhvillimin e skenareve edukative per Arsimin e Shkalles se Pare. Veprimet e vepres perfshijne kerkimin bibliografik, grumbullim ne vend, krahasimin dhe vleresimin e meterialit kerkues me emfaze ne traditen muzikore popullore dhe zhvillimin e skenareve edukative per Arsimin e Shkalles se Pare. Vecanerisht:

### KERKIM / GRUMBULLIM / KONFIRMIM

***Kerkim na vend dhe grumbullim i materialit origjinal:*** Kerkimi (ne vend) dhe grumbullimi i materialit mozikor ishte nje nga pikat me kritike ne realizimin e programit kerkues. Shkencetare te cpesializuar ne degen e tyre (antropologe shoqerore, muzikologe, shkencetare qe merren me studimin dhe kerkimin e te dhenave kulturore etj) bashkepunuan, qe te perfundoje brenda afatit dhe me menyre ta sakte shkencore grumbullimi i materialit. U morren parasysh modele nderkombetare dhe «praktika te mira» te afirmuara. Regjistrimet u bene ne terren dhe ne kuadrin shoqerore te traditave te gjalla te grupeve konkrete qe uperkasin valleve instrumentale te ekzekutuara nga kompani muzikore dhe kengeve origjinale fonetike popullore qe u kenduan nga njerez te thjeshte-banore te zonave. Duhet permendur se ne kete zone gjeografike gjenden shume tradita te pasura muzikore, por dhe varinate te shumta te kengeve popullore (monofonia, difonia, polifonia). Kerkimi dhe regjistrimi lejoi krahasimin dhe paraqitjen e ngjashmerive dhe ndryshimeve. U krijua

keshtu nje harte etnologjike dhe kulturore e zones se gjere qe ndan kufijte kombetare.

***Konfirmin i materialit:*** Materiali u perkthye (nga shqip ne greqisht dhe anasjelltas) dhe u konfirmua qe te jete i mundur vleresimi i tij nga arsimtaret dhe kerkuesit ne Greqi dhe ne Shqiperi.

## PRODHIMI I MATERIALIT EDUKATIV MULTIMATION DHE ZHVILLIMI I ZBATIMIT NE INTERNET TE EDUKIMIT NGA LARGESIA.

Ne kuadrin e kesaj veprimtarie u krijuan:

1. Dy CD me kenge origjinale tradicionale te incizuara te zones se zbatimit te planit. Nje zbatim multimedia i disponueshem ne forme DVD me shembuj skenaresh edukativ.

2. Mteriali edukativ qe u prodhua lejon vleresimin autonom te produktit kulturor ne klasat e arsimit te shkalles se pare, si ne palen greke, ashtu dhe ne palen shqiptare. Me ndihmen e zbatimit multimedia nxenesit ne kuadrin e skenareve edukative te propozuar vijne ne kontakt me tingujt dhe muziken popullore. Ne kuadrin e afrimeve ndertematike vleresojne regjistrimet dhe traditat, te cilat u perkasin valleve instrumentale dhe kengeve popullore fonetike.

3. Zbatim ne internet i edukimit nga largesia me shembuj skenaresh edukative dhe me afrim pedagogjik te perfunduar. Zbatimi qe u planifikua dhe u zhvillua ne moodle (http://moodle.com) lejon hyrjen, gjetjen tematike, perdorimin dhe paraqitjen ne internet te nje ser skenaresh edukative. Perbehet nga faqe interneti (web pages) dhe nga numerues faqesh (web browser). Platforma elektronike mbeshtetet kryesisht ne nje nensistem qe vendos permbajtjen e adreses elektronike ne internet ku publiku mund te hyje (nensistem paraqitjeje), kurse me ndihmen e nensistemit shoqerues perdorues te autorizuar (arsimtare ose kerkues), regjistrojne, aktualizojne dhe vleresojne materialin edukativ, krijojne grupime ose administrojne informacionin multimation (nensistem perdorimi).

4. Se fundi, jashte detyrimeve konvencionale u hartua dhe u zhvillua vend interneti ne dy gjuhe (greqisht dhe shqip).

# Grupi i punës përbëhet

| | |
|---|---|
| *Përgjegjes shkencor i veprës* | *Anastasios Emvalotis, Profesor Asistent i Universitetit te Janines* |
| *Pergjegjes Shkencor i Grumbullimit i Materialit Kerkues* | *Vasilis Niciakos, Profesor i Universitetit te Janines* |
| *Grupi Kerkues* | *Kostas Manxhos, Vasilis Raptis, Kostas Lolis, Niko Michail, Thomas Porikis* |
| *Inçizim* | *Nikos Dhionisopulos* |
| *Pergjegjes shkencor i zhvillimit te materialit edukativ* | *Jeorgjios Kapsalis, Profesor i Universitetit te Janines* |
| *Grup i zhvillimit te skenareve edukative* | *Vasiliki Basina, Vasiliki Leondari, Harilaos Nucos, Athanasios Verdis, Tatiani Derdemezis, Fotini Mballomenu* |
| *Zbatim pilotik dhe vlerësimi* | *Anastasios Emvalotis, Athanasios Verdis* |
| *Perkthim nga greqisht ne shqip* | *Maria Sidheri–Skopi* |
| *Perkthim nga shqip ne greqisht* | *Kostas Lolis* |
| *Grupi i administrimit te ndjekjes se programit* | *Dhimitris Paraskevakis, Ekaterini Dalabira* |
| *Grupi i mbeshtetjes teknike* | *Jeorgjia Koloka, Argiris Janelos, Dhimitris Vangjelis* |

# Pak fjalët nga shkrimtarët

Librin që mban në duart e tua është shkruar me një mënyrë të tillë që të të japë rastin të njohësh vendin tënd brenda nga muzika e tij tradicionale. Muzika është një gjuhë e përbashkët për të gjithë, bashkon popuj dhe vende.

Duke ndjekur, pra, muzikën dhe rrjedhën e lumit Vjosë të ftojmë brenda nga ky libër të njohësh traditën muzikore të njerëzve, që gjenden tej vijës së kufirit, jo shumë larg që këtej. Një grup shkencetarësh specialistë vizitoi banorët e atyre fshatrave që ruajnë të gjallë traditën e tyre muzikore dhe e inçizoi. Pjesë të këtyre inçizimeve do të dëgjosh në cd që shoqërojnë librat. Ndoshta provon supriza duke parë sa ngjajnë këngët që vijnë nga krahinat e një vendi tjetër, me këngët e atdheut tënd.

Temat që përmbahen në këtë libër shpalosën në tetë skenare. Skenari i parë të futë në botën e muzikës, në **«Tekniken e tingujve»**, përbëjnë materialet e para për prodhim dhe kompozim muzike. Tinguj që takojmë brenda në natyrë ose tinguj që prodhojmë brenda nga aktivitetet e përditshme më të thjeshta. Pastaj kalojmë në një skenar tjetër që e quajmë **«Cikël të jetës»**. Njerëzit disponojnë një numër shumë të madh këngësh që flasin për ngjarjet më të rëndësishme të jetës së tyre. Të gjitha këto ngjarje (dasmë, lindje, vdekje etj) krijnë ciklin e madh të jetës, që me radhën e tij ushqen dhe frymëzon shprehjen artistike të njerëzve. Skenari që vijon na kujton se brezat e mëparshëm ruajnë një lidhje shumë të ngushtë me natyrën, e cila fiksohet në një prodhim shumë të pasur muzikor, pjesë të së cilës do të njohim brenda nga skenari **«Kafshët dhe natyra»**, **«Uji na fletë»**. Këtij materiali të çmuar i kushtojmë një skenar të veçantë, meqenëse kishte gjithmonë një vend të veçantë se lidhet me vetë jetën dhe me lidhjen me të ngushtë të njeriut me mjedisin e tij.

Së fundi, dy skenarë të tjerë kanë si përmbajtje anë të veçanta të jetës shoqërore të mjedisit tonë të largët dhe të tanishëm. Njëri merret me **«Profesionet tradicionale»**. Tjetri merret me një fenomen tepër të njohur në shoqëritë e prindërve dhe të gjyshërve tanë, që është i njohur si **«Mërgim»** ose **«të mërguarit»**, qëndrimi d.m.th, në vende të huaja e të largëta për kërkim zgjidhjesh në probleme serioze, si mjerimi etj.

Së fundi, ky libër u hartua me një mënyrë të tillë me qellim që të përfshijë një shumicë veprimtarish të ndryshme ku do të të japin ty rastin dhe bashkënxënësve të tu të luash, të propozosh, të gjitha këto mënyra dhe rrugët, që do të të sjellin më afër kulturës së prindërve dhe gjyshërve të tu. Do të mundesh të zbulosh vlerën e çmuar që fsheh saj kjo traditë e largët muzikore. Do të mundesh ta shohesh si një pjesë të kësaj kulture të madhe popullore, në të cilën dhe ti je vazhdimi dhe trashëgimtari i saj. Por, njëkohësisht, do të mësosh se këto vlera të çmuara të kulturës dhe të vendit tënd që të bëjnë të ndihesh me të drejtë krenar, të sjellin dhe afërnjerëzve të tjerë.

Por, pse duket se ndryshojnë kaq shumë njerëzit e popujve të tjerë, shprehin dhe shfaqin edhe ata ankthin, peripecitë, hidhërimet dhe gëzimet e jetës me mënyra që ngjajnë midis tyre. Ndoshta me në fund mësimi më i çmuar për të gjithë ne të jetë se atë që ndjejmë më tepër tonën, është dhe ajo që mund të ndajmë më shumë me të tjerët.

ky libër i përket

..................................................................................

ky është nxënësi në klasë ..................................

në ......................... shkolle fillore .............................



Tungjatjeta fëmijë!

Quhem Mirela dhe jam shtojzovallja e vogël e lumit Vjosë.

Linda në burimet e lumit dhe u rrita në brigjet e tij, duke njohur njerëzit dhe nga Greqia dhe nga Shqipëria.

Miku im më i mirë është një bretkosë e gjelbër që jeton në anën tjetër te kufirit. Equajnë Apollona, dhe nëse të njeh mirë nuk pushon së foluri!

Bashkë me Mirelën dhe lëpirësin e saj magjik do të udhëtojmë në Vjosë për të njohur njerëzit që jetojnë pranë tij dhe të zbulojmë të fshehtat e këngëve të tyre.

Do të njohim zakonet e tyre,do të kujtojmë profesionet e tyre tradicionale dhe do të shohim për narsye u detyruan të mërgohen vendet e tyre. Duke u shoqëruar nga uji i pastër i Vjosës do të mësojmë të dallojmë tingujt. Do të njohim miqtë e mi, kafshët dhe bimët, që jetojnë në Greqi dhe në Shqipëri dhe do të mësojmë të mbrojmë mjedisin dhe lumin plak Vjosë.



Ejani të luajmë muzikën dhe fjalët!!!

# arti i tingullit



Muzika lindi në kohët e lashta. Të merrni me mend se njeriu nuk kishte zbuluar ende shkrimin. Kaq herët. Për këtë nuk do të mësojmë kurrë si dhe pse ata, stërgjyshërit tanë kaq të largët vendosen të komunikonin midis tyre, duke përdorur në vend të fjalëve muzikën. Kjo nuk ka ndoshta dhe rëndësi kaq të madhe. Megjithatë ekziston një konstatim kaq i rëndëshishëm sa dhe i thjeshtë që i shpjegon vetë të gjitha këto:

Si do të mundte ndokush të imagjinojë botën pa muzikën!

Si do të mundim, ne njerëzit të jetojmë dhe të krijojmë në të gjithë këta shekuj, pa ritëm, pa melodi, pa ata tinguj që na trazojnë ëmbël, që na udhëtojnë, që na nanurisin, që na ngrenë në këmbë, që na ngushëllojnë, që na mahnitin kaq shumë disa herë, sa të harrojmë ato që na hidhërojnë.



Ejani të njohim teknikën e tingujve me anë të këngëve popullore dhe traditat e Greqisë dhe të Shqipërisë.

## 1. Tingujt natyrorë



















Dëgjo tingujt dhe përpiqu t'i korrespodosh me figurën që shikon.

Mund t'i imitosh? Vlerëso atë tingull që mund të prodhosh me pjesët e trupit tuaj (gojën, duart, këmbët etj). Më poshtë i ndaj tingujt në të qetë dhe në të fortë:

të qetë ..............................................................................................................

të fortë ..............................................................................................................

Shkruani dhe tregoni një histori me titull: «Një ditë në natyrë». Në historinë tuaj duhet të vlerësoni sa më shumë tinguj mundoni nga ata që dëgjuat.

## 2. Tinguj artificialë


①


②


③


④


⑤


⑥

Dëgjo këta tinguj dhe përpiqu t'i imitosh.

Mund t'i imitosh? Vlerëso atë tingull që mund të prodhosh me pjesët e trupit tënd (gojën, duart, këmbët,etj). Më poshtë i ndaj në të qetë e në të fortë:

të qetë ..........................................................................................................

të fortë ..........................................................................................................

Bëni një histori me titull: «Një ditë në shtëpinë time». Në historinë tuaj duhet të vlerësoni sa më shumë tinguj nga ato që dëgjuat.

3. Dëgjoni me kujdes këngët e mëposhtme.

***Ju zogj fluturues***

*Ju zogj fluturues*
*fluturoni në ajër*
*ju shpejt martoheni*
*dhe bëheni çift*
*dhe unë turtulli jetim*
*turtull i mjerë*
*dhe ku do të bëjë folenë?*
*Në kallamishte në rrënjë.*
*Vënë zjarr në kallamishte*
*dhe dogjën folenë time.*
*Dhe ku do të ndërtojë gjetkë folenë?*
*Në buzë të pusit,*
*shkojnë vajzat për ujë*
*prishën folenë time.*
*Dhe ku do të ndërtojë gjetkë fole?*

***Në këtë sofër që erdhëm***

*Në këtë sofër që erdhëm (të shkruar sytëe mi)*
*në këtë tavoline (tri syzeza, na gostitin)*
*tri syzeza na qerasin (të shkruar sytë e mi)*
*dhe të trija zonja të mira (njëra qeras, e leshverdha ime, me syze)*
*Njëra qeras me gota qelqi (sytë, bre, sytë e mi)*
*Tjetra me kupën (gostit na, leshverdha, gostit na verë të ëmbël)*
*E treta më e vogla (sytë e mi të shkruar)*
*me mastrapa të argjendtë (gostit na, leshverdha ime, gostit na verë të ëmbël).*

- Në cilën këngë shkojnë më shumë tingujt natyrorë dhe në cilat tingult artificialë?
- Me preteks të dyja këmbët, vizatoni përkrahësisht një figurë nga natyra dhe një nga jeta familiare në shtëpinë tuaj.

## 4. Le të luajmë «Rri urtë»

Kjo lojë luhet brenda në klasë. Por më parë duhet të mësojmë të gjithë të këndojmë. Dëgjojeni me kujdes dhe pastaj me ndihmën e mësuesit tuaj mësoni të këndoni.

***Drenushë***

*Drenushë, rri urtë, xhelozja ime,*
*që të shohin fëmijët*
*dhe të gjithë trimat, xhelozja ime,*
*dhe të gjithë trimat, drenushja ime.*

E mësuat?

Zgjedhim dy djem. Njëri do të jetë «i çrregullt» dhe tjetri shoqëruesi i tij. «i çregullti» duhet të hyjë në qëndrën e klasës dhe të lidhë sytë e tij. Shoqëruesi i tij e merr përdorë dhe e rrotullon brenda klasës, por edhe rreth tij,deri sa të humbasë orjentimin e tij. Sapo të mbarojë, njëri nga djemtë e klasës duhet t'i këndojë «të çrregulltit», këngën «Drenushë rri urtë». I çrregullti duhet të njohë cili e këndon dhe të tregojë me dorë drejtimin nga i cili beson se vjen tingulli. Në vazhdim ndërrojnë rolet.

5. Dëgjoni veglat e mëposhtme dhe korrespodoni tingullin me figurën e saktë.

①


②


③


④


⑤


⑥


Le të luajmë me tingujt dhe me trupin tonë!

Për çdo pjesë që do të dëgjoni,bëni dhe një lëvizje konkrete me trupin tuaj (p.sh. kur dëgjojmë pjanon, përplasim duart, kur dëgjojmë kitarën, bëjmë një rrotullim rreth vetes etj).

Bëni një rreth brenda në klasë. Provoni një herë të dëgjoni me radhë veglat dhe të bëni lëvizjen përkatëse. Mësuesi ose mësuesja juaj,do të vërë tani vegla të trazuara t'i dëgjoni dhe ju do të bëni lëvizjen që keni vendosur. Kush ngatërrohet del nga rrethi. Fiton ai që do të mbetet i fundit.

## 6. Lëviz me muzikën

- Dëgjoni pjesën A.7.2. «Me vegla muzikore». Mund të dalloni veglat që dëgjohen? Shpërndahuni brenda në klasë. Sapo fillon pjesa, ecni lirshëm, duke patur kujdes të kaloni nga të gjitha vendet e klasës. Çdo herë që afroheni shokut tuaj duhet ta përshëndesni duke i rënë lehtë në supet. Sapo dëgjohet vetëm gërneta dhe ndalen veglat e tjera, qëndroni pa lëvizur në qëndrimin që u gjëndet atë çast. Fillon përsëri lëvizja kur hyjnë dhe veglat e tjera.

- Dëgjoni pjesën A.7.11. «Me vegla muzikore». Dalloni edhe një herë veglat. Shpërndahuni brenda në klasë. Sapo fillon pjesa, ecni lirshëm, për klasë, duke patur kujdes të kaloni nga të gjitha vendet e klasës suaj. Çdo herë që i afroheni shokut tuaj duhet ta përshëndesni,duke bashkuar supet tuaja. Në vendin që muzika fiton ritëm, formoni sa më shpejt një rreth dhe ecni në mënyrë rrethore.

- Dëgjoni pjesën A.7.3. «Me vegla muzikore» dhe dalloni edhe një herë veglat. Përpiquni të mblidheni në ritmin që luan dajreja. Mund të ndihmoni dajrenë të dëggjohet më fortë? Mbani bashkë me të ritmin duke përplasur duart. Shpërndahuni përsëri brenda në klasën tuajdhe ecni. Vini pjesën të dëgjohet. Mësuesja juaj i bën me shenjë njërit prej jush dha ai ecën, duke përplasur duart në ritmin që luan dajreja. Kur tregon tjetrin, ai duhet të bëjë të njëjtën gjë, duke ndjekur të parin. Loja vazhdon deri sa të hyjnë të gjithë në një radhë dhe të ecin si shumëkëmbëshi, duke mbajtur njëkohësisht ritmin e pjesës.

## 7. Duke kënduar...

Dëgjoni të dyja këngët (E.9.6. dhe E.9 17).

**Plaku – Lingos**

*–Zogjtë e mi të bardhë, dallandyshet e mia të zeza*
*bre, mos patë, mos takuat*
*Janin levendin kryekaçakun (Plaku – Lingo)?*
*–Bre dje e pamë, e takuam*
*në shtëpi të vllehëve ku pinte dhe hante (Plaku – Lingo)*
*Pesë gjashtë çobanka e gostitnin (Plaku – Lingo)*
*Dhe më e vogla, më e bukura*
*fshehurazi bisedon nuk martohesh (Plaku – Lingo)*
*nuk merr një çobankë si mua (Plaku – Lingo)?*

- Çfarë vëreni? Cilën këngë këndon burri dhe cilën gruaja?
- Ndani klasën në djem dhe vajza. Mësoni veças të këndoni këngën dhe zgjidhni cilat vargje do të thotë grupi i vajzave dhe cilat grupi i djemve. Këndojeni në klasë.

Dëgjoni tani këngët E.9.5 dhe E.9.7.

- Këndon një apo më shumë?
- Në E.9.5. sa mendoni se këndojnë? Këndojnë të njëjtën melodi të gjithë apo të ndryshme?
- Në E.9.7. sa mendoni se këndojnë? Këndojnë të njëjtën melodi të gjithë apo të ndryshme?

♪ Kur muzika ka edhe fjalë, atëhere themi se flasim për këngë.

♪ Kur ekzistojnë vetëm vegla, muzikën e themi organike.

♪ Kur zërat ose veglat këndojnë të njëjtën melodi, muzikën e themi monofonike.

♪ Kur zërat ose veglat këndojnë melodi të ndryshme, muzikën e themi polifonike.

Dhe një të fundit... Dëgjoni tani këngën (A.7.12.) dhe plotësoni fjalinë me fjalët që ju jepen në kllapa.

KUJDES: një fjalë është gabim!

polifonike monofonike të veglave

Kjo këngë u përket këngëve ..........................................
të Shqipërisë dhe këndohet me shoqërim
..........................................

Zakonisht kur zgjedhim muzikë që do të shoqërojë tregimin tonë, kemi kujdes për dy gjëra:

- preferoni pjesët organike, që të mos ngatërrohen vargjet me fjalët e tregimit dhe
- muzika të mos ketë të fortë të dhënën ritmike, që të mos kemi mundësi, për shembull, ta kërcejmë lehtë ose të përplasim duart.



## 8. Duke veshur historinë me kulturë

Dëgjo vjershën e mëposhtme: E.10.14. «Nënë me të nëntë bijtë e saj». Kuptuat historinë e vjershës?

Uluni në klasë, duke formuar një rreth. Thoni përsëri historinë e vjershës, por këtë herë si përrallë. Secili nga ju, do të thotë një fjali. Kërkoni nga mësuesja juaj të shkruajë përrallën në tabelë.

Filloni me shprehjen: «Një herë e një kohë».

Tani lexoni së bashku vjershën, por këtë herë do të dëgjohet njëkohësisht dhe një pjesë organike që të shoqërojë recitimin tuaj. Zgjidhni, për shoqërim të muzikës suaj një nga pjesët e mëposhtme, duke justifikuar zgjedhjen tuaj: A.7.2., A.7.8., E.5.6.

## 1. Nuanca



1



2



3



4



5



6

Dëgjoni tingujt dhe përpiquni të korrespodoni secilin tingull me figurën e tij.

Mund t'i imitosh? Vlerëso çfarë tingull mund të prodhosh me trupin tënd (gojën,duart,këmbët etj). Bëni një histori me titull:

«Një ditë në natyrë»

Në historinë tuaj duhet të vlerësoni sa më shumë tinguj mundeni nga ato që dëgjuat.

Çdo tingull, si edhe ngjyrat, është i veçantë. Të gjitha karakteristikat që e bëjnë të veçantë dhe të dallueshëm nga ne, përbëjnë nuancën e tij.

## 2. Lartësia



















Dëgjoni tingujt dhe përpiquni të korrespodoni secilin me figurën e tij.

Mund t'i imitosh? Vlerëso çfarë tingull mund të prodhosh me trupin tënd (gojën, duart, këmbët etj).

Më poshtë ndaj në të thellë e në të mprehtë:

në të thellë ........................................................................................

në të mprehtë ....................................................................................

Një tjetër karakteristikë bazë e tingullit është lartësia domëthënë sa i thellë ose i mprehtë është.

## 3. Intensiteti


①


②


③


④


⑤


⑥

Një tjetër karakteristikë bazë e tingullit është intensiteti d.m.th sa i fortë osi i dobët eshtë.

Dëgjo dhe këta tinguj dhe përpiqu të bësh të njëjtën gjë.

Mund t'i imitosh? Vlerëso çfarë tingull mund të prodhosh me trupin tënd (gojë, duart, këmbët etj). Më poshtë ndaji tingujt në të dobët dhe në të fortë:

të dobët ..........................................................................................................

të fortë ..........................................................................................................

Bëni një histori me titull:

«Një ditë në shtëpinë time»

Në historinë tuaj duhet të vlerësoni sa më shumë tinguj mundeni nga ato që dëgjuat.

①



②



## 4. Zgjatja

Dëgjo dhe këta tinguj dhe përpiqu të bësh të njëjtën gjë. Mund t'i imitosh? Vlerëso çfarë tingull mund të prodhosh me trupin tend (gojë, duart, këmbët etj). Më poshtë ndaji në të çastit dhe në të vazhdueshëm:

të çastit ..............................................................

..............................................................

të vazhdueshëm ..............................................................

..............................................................

③



④



⑤



⑥



Një nga karakteristikat
e tingullit është zgjatja,
d.m.th sa kohë zgjat.

## 5. Muzika, arti i tingullit

Ç' është muzika? Le të lexojmë rregullin që na jep fjalori:

> Muzika është një bashkësi tingujsh të organizuar [...]
>
> që të përbëjnë një dëgjim të këndshëm për veshin.
>
> J. Babinjotis, «Fjalor i gjuhës së re Greke»

Pra, muzika janë tingujt. Por, janë të gjithë tingujt? Dhe kur themi organizuar, pikërisht ç' kuptojmë?

Le të luajmë lojën e mëposhtme me tingujt. Dëgjo dhe këta tinguj dhe përpiqu të bësh të njëjtën gjë.


1


2


3


4


5


6

Më poshtë ndaji tingujt të përsëritshëm dhe ritmike dhe jo ritmike.

ritmike ...............................................................................................................................

jo ritmike ...........................................................................................................................

6. Le të përpiqemi të gjejmë karakteristikat bazë të tingullit, këtë herë në tinguj që prodhojnë veglat muzikore. Dëgjo veglat dhe përpiqu të korrespodosh tingullin me figurën e saktë:



Sipas këtyre që mësove në aktivitetet e mëparshme, plotësoni shprehjen e mëposhtme me fjalën e duhur nga ato që janë në kllapa:

(nuanca lartësia intensiteti zgjatja)

Ajo që na bën t'i dallojmë veglat muzikore është

.................................... që është njëra nga veçoritë bazë të tingullit.

Mund të kërkosh edhe veti të tjera të tingullit në veglat muzikore?
Përdorni po ato vegla muzikore ose sill edhe të tjera si shembull në klasë.

Le të përpiqemi të zbulojmë, nëse veglat muzikore disponojnë edhe ato veçoritë e tingullit, siç pamë më lart. Dëgjoni veglat muzikorë dhe përpiqu të korrespodosh tingullin me figurën e saktë.


1


2


3


4


5


6

Më poshtë ndaji në ato që beson se kanë tingull të thellë dhe në ato që kanë tingull të mprehtë:

i thellë ..........................................................................................................

i mprehtë ........................................................................................................

7. Njeriu, për të bërë muzikë u përpoq të gjejë mënyrë të vlerësojë të gjitha vetitë e tingullit.



Që të ketë nuancë të ndryshme, ndërto vegla muzikore të ndryshme. Zbulo se tingullin mund ta prodhojë me dy mënyra të ndryshme: me të **goditur** dhe me të **fryrë**. Përpiqu të vlerësosh këto dy mënyra dhe me vegël trupin tënd të prodhosh sa më shumë tinguj mundesh. Sipas mënyrës që përdorte materialet mund të përdorte tingujt të panumërt dhe t'i vlerësojë për të luajtur muzikën që donte çdo herë. Dëgjo veglat e mëposhtme dhe plotëso më poshtë mënyrën me të cilën beson se prodhohet tingulli.



Në kitarë tingulli prodhohet ..............................................................

Në daullet tingulli prodhohet ...........................................................



Në gërnetë tingulli prodhohet ...........................................................

Në ksilofon tingulli prodhohet ...........................................................



Sipas mënyrës me të cilën prodhon çdo vegël tingullin lindën katër familje të mëdha veglash:

| | |
|---|---|
| Kordofonet | prodhojnë tingullin me goditjen e telit. |
| Membranofonet | prodhojnë tingullin me goditjen e membranës. |
| Aerofonet: | prodhojnë tingullin me fryrjen e ajërit brenda nga tubi. |
| Idiofonet | prodhojnë tingullin me dridhje të vetë trupit të tyre. |

Më poshtë janë të ngatërruara shumë vegla që duhen gjetur me familjet e tyre. Ndihmoni!



Ndahuni në katër grupe. Çdo grup do të marrë përsipër dhe një familje veglash. Mund të sillni informacione për ndërtimin e tyre, për mënyrën që prodhojmë tingullin, për llojin e muzikës,në të cilën i takojmë.
Sukses të mirë!

8. Dëgjoni pjesët.

- Mund t'i dallosh veglat muzikore që dëgjohen?
- Mund t'i renditni në familjet e tyre?
- Pjesët që dëgjove vijnë nga fshatrat e Shqipërisë. Gjen vegla të përbashkëta me ato që dallove në muzikën e vendit tënd? Cilat janë këto?

9. Pamë se njeriu me veglat e ndryshme arriti të kishte shumëllojshmëri nuancash të tingujve që donte të vlerësonte për të krijuar muzikë. Për të parë ç'bëri me lartësinë, me zgjatjen dhe me intensitetin...

Dëgjoni këngën E.12.11. «Limoni i shkurtër», disa herë me kujdes dhe përpiquni ta mësoni. Këndojeni të gjithë bashkë.

***Limoni i shkurtër***
*Mor limoni i shkurtër,*
*me limonë shumë,visanjote,*
*të putha dhe u sëmura dhe as mjek nuk thira*
*kur i vogël , kur i vogël u rrite*
*dhe lëshove filiza,visanjote,të putha dhe u sëmura.*

- Në cilat pika zëri juaj ngrihet më lartë dhe në cilat ulet?
- Cilat rrokje këndoni më shpejt, në cilat qëndroni shumë orë?

Lartësia e tingullit, në artin e muzikës, njerëzit gjetën mënyrë ta simbolizojnë, duke krijuar një **«alfabet»** muzikor. Simbolet e tij i quajtën **nota**.

Shkruani në pentagramin e mëposhtëm notat e muzikës duke filluar nga nota e parë do poshtë pentagramit deri në fushën e tretë.



Që të përcaktojnë sa zgjat çdo tingull,krijuam vlera të veçanta:
**të plotën, gjysmën, të katërtën, të tretën, të gjashtëmbëdhjetën.**



*të plotën* *gjysmën* *të katërtën* *të tretën* *të gjashtëmbëdhjetën*

Deri ku beson se mund të arrijnë vlerat? Vëreni me kujdes figurat dhe plotësoni fjalitë. Mund të shkruash fjalitë e mësipërme me thyesa?

E plota ka ........................................................ gjysma.

Gjysma ka ........................................................ të katërta.

E katërta ka ........................................................ të teta.

E plota ka ........................................................ të katërta.

E plota ka ........................................................................................ të teta.

Gjysma ka ........................................................................................ të teta.

10. Njerëzit zbuluan mënyra për të paraqitur lartësinë tonike dhe zgjatjen e tingullit në muzikë. Në partiturat e mëposhtme përpiqu të dallosh sa më shumë simbole di.

- Cilat janë fare të panjohura?
- Mund të imagjinosh cilat lloje të muzikës vlerësojnë partiturat përkatëse?
- Kërkoni shembuj muzikorë nga partiturat që nuk njeh.




Të shkruarit me simbole të muzikës bizantine



Partiturë e shkruar me dorë
J. S.Bach (1685-1750)




Partiturë e shkrimit me simbole moderne të sh. 20të



Të shkruarit me simbole të muzikës evropiane

11. Duke kërkuar në enciklopedinë, gjetëm përkufizimin e mëposhtëm për këngën popullore:

«Kënga popullore si lloj letrar thith meterialin e saj nga tradita letrare gojore, ajo që u zhvillua në territorin më të gjerë gjeopolitik të Ballkanit që lidhet me pamje të aktivitetit shoqëror të asaj kohe [...]»
http://el.wikipedia.org

- Ç'do të thotë termi traditë gojore?
- Beson se kënga popullore vlerësoi simbolet muzikore?
- Nëse jo, si arrijmë dhe njohim këngët popullore të sh.19të deri më sot.

Duke vazhduar enciklopedinë lexojmë:

> «Bërthama bazë e këngëve popullore përfshin të dhëna [...], në të cilat mbizotëron emocioni dhe referimet direkte në jetën e përditshme, gëzimet dhe hidhërimet e popullit që i krijoi dhe i përdor. Sa në ciklin e jetës (ninullat, vajet, të dasmës, të mërgimit) aq dhe në ciklin e kohës (kolendrat, dita e karnavaleve) këngët popullore janë të lidhura me zokonet përkatëse.»
>
> http://el.wikipedia.org

- Sipas textit, për të cilat rrethana krijoi populli këngët popullore?
- Mund të mendohesh dhe të plotësosh dhe rrethana të tjera ku njerëzit këndojnë?



Për muzikën moderne të sh. 20të kërkoni informacione për jetën, për veprën e kompozitorit grek J. Ksenaki.

12. Dëgjoni këngët E.2.15. «Ditën e enjte», E.2.18. «Nani nani fëmijën», E.5.6. «Hyni vajza në valle», E.11.2. «Vaj» dhe përpiqu të imagjinosh kur i këndojmë. Në këngët që vijojnë mund të mos kuptosh fjalët. Por mund të imagjinosh në cilën nga të trija pikturat u përkasin?



«E dashura e gjyshës»
J. Iakovidis



«E fejuara izraelite»
Rembrandt



«La pieta»
Michelangelo

Këngët vijnë nga Greqia dhe Shqipëria. Pikturat dhe skulpturat nga Greqia, Hollanda dhe Italia.

- Sa e përbashkët është mënyra që shprehin njerëzit emocionet e tyre tek të gjithë popujt?

## 13. Ç' janë këngët polifonike?

Janë këngë popullore nga zonat kufitare të Shqipërisë (Pogoni, Dropulli, Delvina, Himara, Leskovik). Këto këngë, njëra nga format muzikore më interesante në të gjithë botën, kanë disa veçori. Këndohen nga katër deri në dhjetë interpretues.



Grupi polifonik i Vlorës



Grupi polifonik i Përmetit

Besoni takime të tilla mund të ndihmojnë:

- në ruajtjen e trashëgimeve kulturore të përbashkët?
- në krijimin e marrëdhënieve miqësore midis banorëve në të dyja zonat?
- në pakësimin e frikës së diferencimit?
- në ç' gjë tjetër mund të ndihmojnë?

14. Me Domna Samiu kënga popullore e vlefshme për të sotmen dhe të ardhmen!

Domna Samiu u pyet me ç'mënura një arsimtar ose prind mund të frymëzojnë dashurinë dhe interesin për këngën popullore për të rinjtë. Dhe u përgjegj:

«Fëmijët nuk duan shumë teori.Thithin këngën si sfungjerë, e kam parë nga përvoja ime këtë. Ka rëndësi të madhe fëmija të vijë në kontakt me këngën popullore nga mosha parashkollore. Kur e njeh këngën qysh atëhere dhe më vonë në shkollën fillore dhe nëntëvjeçare vazhdon ta mësojë dhe ta dëgjojë, kur arrin në shkollën e mesme do t'i japin rëndësi. Do të jetë rritur me këto dëgjime dhe do t'i jenë të dashura».

(Gazeta Erevnites, v.71, f 10-11)

- Je dakort me pikpamjen e Domna Samiu?
- Ç'mund të bëhet tjetër nëpër shkollat? Bëni propozimet tuaja.



Në verën e vitit 1999 u realizua takimi ndërkombëtar i këngës polifonike që u bë pjesën veriperëndimore të Epirit. Atje u takuan gjithsej 11 grupe polifonike grekefone, shqipofone dhe të vllehëve dhe u bashkuan nën tingullin e gërnetës Grekët, Shqiptarët dhe Vllehët, me valle rrethore të lashtë (Gazeta Erevnites, v. 54, f.10-11).

# cikli i jetës

1 2 3



Kënga ishte gjithmonë mjet i shprehjes së ndjenjave të njeriut. Brenda nga kënga njeriu fliste për gëzimin ose për hidhërimin e tij,për lodhjen ose për shkujdesjen e tij, për dashurinë dhe delikatesën e tij, por, për dëshpërimin dhe dhimbjen e tij. Nuk mund të mungonte, pra, nga të trija stacionet kryesore të jetës së tij: lindjen, dashurinë por edhe vdekjen.

Tek ninullat njeriu u pëproq të mbyllë gjithë delikatesën, dashurinë që ndjen për jetën e re që vjen në botë. Në këngët e dashurisë dhe të dasmës foli për dashurinë dhe lumturinë që e përmbush, kur takon shokun e tij. Dhe së fundi brenda nga vajet u përpoq të zbutë dhimbjen e tij përballë vdekjes, që është ngjarja më e trishtuar por edhe kjo është brenda në jetë.



Le të ndjekim bashkë ciklin e jetës duke na shoqëruar këngët tona popullore!

Në Greqinë e lashtë ekzistonte një qenie mitologjike që quhej Sfinks. Thonë se ishte një luan me pendë me kokë gruaje që jetonte në Thivë. Atje qëndronte dhe pyeste kalimtarët:

*Ç' është ajo që në mëngjes qëndron në katër, në drekë në dy dhe në darkë në tri?*

Atë që nuk mund të zgjidhte gjëegjëzën, Sfinksi e mbyste. Vendi ishte bërë shumë i rrezikshëm, sepse asnjëri nuk mundi të jepte përgjigje. Banorët e Thivës ishin dëshpëruar, sepse asnjëri nuk vinte më në qytetin e tyre. Prandaj kishin nxjerrë një shpallje se ai që do të zgjidhi gjëegjëzën do të bëhet mbret i qytetit.

Mund të japësh përgjigje ti?



Një ditë kaloi andej një burrë që vinte nga Korinthi. Atë burrë e quanin Idhipodha. Sfinksi tha dhe në atë gjëegjëzën. Idhipodhas u mendua pak dhe pastaj u përgjegj:

*Njeriu! Sepse njeriu në fillim ecën me katër, kur rritet ecën me të dyja këmbët dhe kur plaket mbështetet tek bastuni, prandaj i duhen tri këmbë që të qëndrojë.*

Sapo u zgjidh gjëegjëza i tij, Sfinksi u rrëzua nga shkëmbi që qëndronte dhe u vra.Kështu Idhipodhas shpëtoi banorët e Thivës dhe u bë mbreti i tyre.

- Si e imagjinon Sfinksin, sipas informatave?
- Mund ta vizatosh?

## Cikli i jetës

Vizato njeriun, në të gjitha stadet që kërkon Sfinksi dhe ndërto ciklin e jetës.

Gjëegjëzën e Sfinksit e përdorin dhe në Shqipëri dhe thotë: Në mëngjes ecën me këmbë e duar, në drekë ecën me të dja këmbët dhe në darkë ecën me tri.



1. Vëreni me kujdes të dyja figurat. Gjeni ngjashmëritë dhe ndryshimet. Mund të mbështetim se paraqitet një stad nga cikli i jetës në të dyja pikturat? Cila dhe me ç' mënyrë?



J. Iakovidis, «Hapat e para»

Dëgjo me kujdes këngën e mëposhtme dhe plotëso fjalët që mungojnë:

Nani, nani ..........................................

Sa ta marrë gjumi

T' i .......................................... nëna e tij

.......................................... gjëra

të .......................................... çudirat.

Bëj të njëjtën gjë dhe në këtë këngë:

Nani, nani

Sa të vijë .......................................... e ve.

T'i sjellë diçka

.......................................... një letër

për të. .......................................... .



J. Iakovidis, «E dashura e gjyshës»

- Kush këndon dhe për cilin në të dyja këngët?
- Çfarë synon me këngën?
- Çfarë i premton nëna djalit?
- Cilat fjalë përdorim kur duam të vëmë në gjumë foshnjën?
- Tregojnë diçka këto fjalë?

- Në cilën fazë të jetës së njeriut beson se u përkasin të dyja këngët?

Dëgjo tani dy këngë nga Shqipëria (A.1.22. dhe A.13.11.). Përpiqu të kuptosh kur i këndojnë.

- Mund të imagjinosh fjalët?
- Ekzistojnë fjalë të përbashkëta midis ninullave shqiptare dhe greke?

## 2. Le të punojmë dhe pak me ninullat...

Kërko nga mësuesja jote të të vendosë përsëri të dëgjosh dhe të katër ninullat që dëgjuam më parë. Përpiqu këtë herë të përqëndrohesh tek muzika dhe jo tek fjalët e këngës.

- Janë të ngadalta apo të shpejta?
- Këndohen fortë apo qetë ?

Plotësoni vendet boshe në fjalinë e mëposhtme duke zgjedhur fjalët e duhura nga ato që janë në kllapa.

( të ngadaltë     me zë të ulët     këngë )

Ninullat janë ..................................................që kanë qëllim të vënë në gjumë dhe të qetësojnë fëmijët, prandaj dhe këndohen .................................................. dhe kanë ritëm të qetë dhe ..................................................

3. Dëgjo veglat e mëposhtme dhe përpiqu të korrespodosh tingullin me figurën e duhur. Po të duhej t'i këngoje një ninullë foshnjës, cilat vegla do të zgjidhje për të ekzekutuar dhe cilat jo? Pse?



①



③



②



④

4. Nëse, me gjithë ninullat që themi fëmijët nuk i zë gjumi dhe qajnë, gjyshet e dy zonave gjenin shkakun. Dhe ishin të njëjtat çdo herë. «Syri». Atëhere duhej të largojnë «syrin e keq». Në çdo fshat ekzistonte një grua e moshuar që ishte «kopetente» për të gjitha këto. Gjithashtu, kishin dhe nishanin për t'i mbrojtur foshnjat. Në këtë grua rendnin edhe për sëmundjet e fëmijëve. Pyesni më të mëdhenjtë dhe grumbulloni informata:

- për mënyrat me të cilat përballonin «syrin».
- për paragjykime të tjera që besonin.
- këngë dhe yshtje që thoshin gjatë procesit të largimit të «syrin e keq».
- nëse dhe sot besojnë «në syrin e keq».

Përpiquni të shpjegoni arsyet për të cilat besoni në këto paragjykime.

## 5. Ëndrra të ëmbla! «Gjumë që merr fëmijët, eja merr dhe këtë... »

Ëndrrat janë pjesë e gjumit dhe gjumi është i domosdoshëm për të jetuar. Sa organizmi ynë çlodhet ne zëmë vend para ekranit të trurit tonë për të ndjekur vepra të ndryshme çdo natë. Kështu nuk ngjajnë ëndrrat?

Mbyllni sytë dhe ëndërroni ëndrrën më të çuditshme! Regjistroni ëndrrat tuaja dhe i lexoni në klasën tuaj.

Shpjegimi i ëndrrave gjithmonë shqetësonte njeriun. Përpjekjet e para për shpjegimin e tyre u gjenden tek papirusit 4000 vjet p.e.s. Pyesni më të rriturit dhe grumbulloni shpjegime që jepnin për ëndrrat. Mund të jepni edhe shpjegimet tuaja. Vini re formulimin!

Po të shikosh në gjumin tënd ...................................., do të ...........................................................
p.sh. po të shikosh në gjumin tënd peshq atëherë llahtarë të madhe do të marrësh!

## 6. Kërkues të vegjël

Ndahuni në grupe. Çdo grup duhet të bëjë një kërkim muzikor që të grumbullojë ninulla të zonës së tij.

### Stadet e kërkimit

**Stadi i parë:**

1) Ndani krahinën tuaj në zona dhe sipas venbanimit tuaj ndahuni në grupe, me qëllim që zonën që do të merrni përsipër të jetë afër shtëpisë suaj.
2) Bëni një tabelë në klasën tuaj me grupet që krijuat dhe zonat që ka marrë përsipër çdo grup. Nëse doni mund të jepni një emër në çdo grup.
3) Çdo grup duhet t'u jap punë pjesëtarëve të tij. Kjo do të thotë se duhet të caktojë persona për këto punime:

- <u>Përpiloni hartën.gjeografike të krahinës:</u> Një pjesëtar merr përsipër të ndihmojë grupin që të zbulojë zonën gjeorgafike që I përket dhe të zbulojë rrugët.
- <u>Regjistrim kalendarik i kërkimit:</u> Në një fletore një pjesëtar mban shënime për ecurinë e kërkimit (ku u bë inçizimi, kur dhe nga cilët, nëse hasi grupi disa vështirësi dhe çdo gjë tjetër që gjykohet e domosdoshme.
- <u>Personi që inçizon:</u> Merr përsipër inçizimet dhe përdor kasetofonin ose cd recorder që do të përdoret. Para çdo inçizimi thotë emrin e grupit, zonën në të cilën u bë inçizimi, datën, emrin e personit atij që këndon dhe titullin e ninullës nëse ekziston. Po të jenë më shumë se një ninullë dhe nuk ekzistojnë tituj, thjesht numëron ninullat. p.sh. *«Grupi A, E shtunë 14 qershor 2008, Zona A. Këndon zonja Maria Papadhopullu, ninullë nr.1»*.
- <u>Protokollim:</u> Një pjesëtar merr përsipër të rregullojë kasetat ose cd në zona dhe në data dhe të kopjojë të dhënat në kopertinat e tyre.
- <u>Fletëanketë:</u> Dy ose më shumë pjesëtarë marrin përsipër të bëjnë fletëanketat, t'i klasifikojnë dhe të përpunojnë rezultatet (për këtë punë duhen më shumë se dy veta).

4) Secili prej jush mund të marr përsipër më shumë se një punim, sipas numrit të personave që përbëhet grupi juaj.

**Stadi i dytë:**

1) Bëni fletëanketën, për të grumbulluar të dhëna për ninullat që do t' ju këndojnë. Nga pyetjet duhet të mësojmë:
   - Moshën dhe seksin e personit që këndon.
   - Nga cila zonë e Shqipërisë vjen ninulla.
   - Nga e mësoi ninullën personi që këndon.
2) Mendoni nëse duhen dhe informata të tjera për ninullat që do të grumbulloni dhe shtoni pyetjen e duhur në fletëanketën tuaj.

**Stadi i tretë:** Filloni inçizimet. Paralelisht duhet të ndani fletëanketën dhe të bëni regjistrim kalendarik.

**Stadi i katërt:** Sapo të mbaroni inçizimet, filloni protokollimin dhe përpunimin e fletëanketave.

**Stadi i pestë:** Paraqitni rezultatet e kërkimit tuaj në klasë.

**Stadi i gjashtë:** Kërkoni nga shkolla që bashkëpunini në anën tjetër të kufijve t' ju dërgojnë materialin që grumbulloi. Ninullat që keni grumbulluar mund t'i regjistoni dhe të botoni librin tuaj me titull: «Këngë djepi». Shkruani fjalët e ninullave në kompjuter, ilustroni librin dhe shkruani parathënien dhe përshtypjet tuaja nga gjithë procesi. Në fund mund të inçizoni dhe vetë disa ninulla që keni mësuar të këndoni. Gjithashtu dhe cd të shoqërojë librin. Së fundi për libralidhjen mund të merreni dhe ju vetë. Mund të shponi me një zhvirgjërues faqet dhe me kordele shumëngjyrëshe t' lidhni.



1. Një nga stacionet ndoshta më të rëndësishme të njeriut është dashuria dhea dasma e tij, në ciklin e jetës. Dhe kjo sepse prej andej do të fillojë një cikël i ri me krijimin e familjes dhe me lindjen e një fëmije.



*A. Roden, «Puthja»*



*P. Kaliari, «Dasma e Kanasë»*

Dëgjo këngën e mëposhtme:

***Në Adhin do të zbres***
*Në Adhin do të sbresë dhe në Parajsë*
*Vdekjen të takoj dy fjalë t'i them*
*–Vdekje,më fal shigjeta të mprehta*
*të shkoj t'u hedhj dy- tre ismere.*
*I hodha një shigjetë një vajze të re të shkurtër dhe bionde*
*që ka buzët e lyera,në faqe ka nishan.*

- Është burrë apo grua ai që këndon?
- Mund të kuptosh nëse këndon një person ose më shumë?
- Këndojnë të gjithë të njëjtën melodi apo të ndryshme?
- Përpiqu të thuash me fjalë të tua kuptimin e këngës.
- Ato që thotë mund të realizohen apo jo?

Shumë herë, që të themi diçka më me forcë dhe me dukje,përdorim mjete të ndryshme shprehëse. Mund të kuptosh çfarë tregojnë shprehjet e mëposhtme?

- Ikën si era / Τρέχει σαν λαγός (Πάει σαν άνεμος).
- Këndon si bilbil / Τραγουδάει σαν αηδόνι.
- U çmend nga dashuria / Είναι τρελός από αγάπη.

Mund të gjesh shembuj të tjerë dhe të plotësosh rëndësinë e tyre?
Dëgjo tani edhe një këngë tjetër:

***Pini të pimë***

*Pini të pimë, more djema, pini të pimë, o dulberë.*
*Hajde, dhe mos pini shumë,mos pini shumë o dulberë.*
*Hajde, dhe nesër rrugë kemi, more djema.*
*Hajde, rrugë për Korçën, more djema, rrugë për Korçën.*
*Nuse që të marrim, more djema.*
*Hajde,dhe po nuk na e dhanë, more djema, po nuk na e dhanë,o dulberë*
*Hajde, luftë do të nisim more djema, luftë do të nisim, o dulberë.*

- Është burrë apo grua ai që këndon?
- Mund të kuptosh nëse këndon një person ose më shumë?
- Këndojnë të gjithë të njëjtën melodi apo të ndryshme?
- Përpiqu të thuash me fjalë të tua kuptimin e këngës.
- Për çfarë janë gati të bëjnë burrat e këngës nëse ndokush do të ndalojë dasmën?

- Beson se kjo gjë është e vërtetë apo e thonë në mënyre alegorike?
- Çfarë duan të na thonë dhe të dyja këngët për forcën e dashurisë?

2. Dëgjo edhe një herë të dyja këngët. Në cilën këngë këndojnë të gjithë të njëjtën melodi dhe në cilën jo?



Kur në një këngë këndojnë të gjithë të njëjtën melodi, kënga quhet monofonike. Kur këndojnë melodi të ndryshme, quhet polifonike .

Mund të gjesh nga cilat fjalë më të vogla përbëhen fjalët monofonike dhe polifonike?

Monofonike = .................................... + ..................................................

Polifonike =....................................... + ..................................................

Fjalët që mund të ndahen në më të vogla, quhen të përbëra.

Pasi të dëgjosh përsëri të dyja këngët, plotëso vendet boshe në fjalitë e mëposhtme me fjalën e saktë në kllapa:

( monofonike polifonike )

Kënga «Në Adhin do të zbres» është ______________________

Kënga «Pini të pimë» është ______________________

3. Dëgjoni këngët: «Djali i arkondit martohet» dhe «Janos dhe Marigo».

**Djali i arkondit martohet** (këngë nga Greqia)

*Djali i arkondit martohet dhe merr një emigrante*
*–vjehrra dhe vjehrri pemët çrrënjosin*
*të gjejnë gjarpërinj, të gjejnë nëpërka, nëpërka me dy kokë.*
*Gjetën gjarpërinj, gjetën nëpërka, nëpërka me dy kokë.*
*Kuzhinierit ia dhanë, t'i skuqë mirë.*
*–Ulu, nusja ime, të hash, të pish mirë.*
*–Unë hëngra, në nënën time, jam dhe e ngopur.*
*–Dhe ne za– dhe ne zakon e kemi.*
*të marrë nu– të marrë nusja një herë,*
*të marrë tri dhe pesë.*
*Dhe me pirunin e parë u helmua zemra e saj.*
*–Dhe ti vjehrra ime e mirë, ujë për shëndetin tim.*
*–Ti ujë, ti ujë nuk solle dhe ç'ujë kërkon.*
*–Dhe ti, vjehrri im i mirë, ujë për shëndetin tim.*
*–Dhe ti ujë nuk solle dhe ç' ujë kërkon.*
*–Dhe ti, bashkëshorti im i mire, ujë për shëndetin tim.*
*Mastrapën, rrëmbeu dhe tek burrimi vete.*
*Deri sa të vete, dhe deri sa të vijë, e gjen të vdekur.*
*Një thikë, vuri në anën e majtë të tij.*
*I morën dhe i varrën bashkë në një varrezë*
*tek njeri mbiu kallam dhe tek tjetri qiparis.*
*Përkulet kallami dhe puth qiparisin.*
*përkulet, qiparisi dhe puth kallamin.*
*–Shikoni, që kanë pak ditë dhe jetë të shkurtër*
*që nuk u puthën të gjallë, por puthen të vdekur.*

Mësoni të këndoni kolektivisht këngën «Në Adhin do të zbres».

Përpiquni të kuptoni sa melodi dëgjohen në këngë «Pini të pimë».

Ndahuni në grupe dhe mësoni të këndoni këngën me shumë zëra.

***Janos dhe Marigo***

(këngë nga Shqipëria e Jugut, thuhet se është hidtori e vërtetë)

*Janos dhe Marigo*
*në një shkollë po shkonin. (dy herë)*
*Janos mëson shkronja*
*dhe Marigo këngë. (dy herë)*
*Të dy u dashuruan*
*asnjëri nuk e di. (dy herë)*
*Dhe vendosi Janos*
*nënës t'ia thotë. (dy herë)*
*Nënë, Maron dashuroj*
*dhe dua ta marrë. (dy herë)*
*Ç'thua more palodjalë*
*dhe gjarpërngrënë. (dy herë)*
*Maro është kushërira jote*
*kushërira jote e parë. (dy herë)*
*Më mire të dëgjoj qefin*
*që të të qefinoj. (dy herë)*
*Sesa të dëgjoj kurrora*
*që të të martoj. (dy herë)*
*Maro fejohet*
*dhe Janos vdes. (dy herë)*
*Krushq dhe lipsane*
*në rrugë u bënë një. (dy herë)*
*Asnjë nuk pyeti*
*nga krushqit. (dy herë)*
*Maro u turpërua*
*ndalon dhe i pyet. (dy herë)*
*I kujt është lipsani*
*me arkivolin e artë. (dy herë)*
*I Janos është lipsani*
*me arkivolin e artë. (dy herë)*
*I bie të fikët së resë*
*dhe vdes. (dy herë)*
*I morën dhe i varrosën*
*në një kryqëzim rruge. (dy herë)*
*Janos mbin kallam*
*dhe bija qiparis. (dy herë)*
*Rrotullohet kallami*
*phe puth qiparisin. (dy herë)*
*Pa shikoni këtë çift*
*të shumëdashuruar. (dy herë)*
*që nuk u puthën të gjallë*
*puthen të vdekur. (dy herë)*

- Ç' tregojnë fjalët: "djali i arhondit" dhe "emigrante"?
- Pse imagjinoni se prindërit e birit të arhondit nuk donin të martonin djalin e tyre me emigranten?
- Çfarë bënin që të mos realizohej dasma?
- Mundën së fundit të dy të rinj të jenë bashkë? Nëse po, me ç' mënyrë?

- Si u njohën Janos me Marigonë?
- Pse nëna e Janos nuk donte të martohej biri i saj Marigon?
- Ç' mallkim i dha që të mos bëhej dasma?
- Krahasoni mënyrën që mbarojnë të dyja këngët. Ekzistojnë të dhëna të përbashkëta?

Uluni të gjithë fëmijët në një rreth.Përpiquni të thoni çdo këngë si përrallë. Secili prej jush duhet të thotë një fjali. Kërkoni nga mësuesi ose mësuesja juaj të shkruajë në tabelë fjalitë tuaja, dhe në fund lexoni të gjithë bashkë përrallën.

Fjalia e parë do të fillojë si më poshtë: «Një herë dhe një kohë ishte ...»

4. Dëgjoni këngën A.7.15. «Trëndafil me gjethe»

- Këndon një njeri ose më shumë?
- Burra,gra apo të dy?
- Dëgjohen vetëm zëra apo dhe vegla?
- Përpiqu të dallosh sa më shumë vegla mundesh.

Dëgjo tani këngën E.5.2. «Lahet arkondi I vogël».
- Këndon një njeri ose më shumë?
- Burra, gra apo të dy?
- Dëgjohen vetëm zëra apo dhe vegla?

Më poshtë janë vargjet nga të dyja këngët. Pasi I lexon me kujdes, përpiqu tu përgjigjes pyetjeve.

***Trëndafil me gjethe***

*Trëndafil me gjethe*
*U ngjite sokakëve*

*Pas vijnë të rinjtë*
*Të të marrin veshjen tënde,*
*Veshjen e beqarit*
*Dhe të të veshin veshjen e dhendrit*
*Borzilok, more borzilok,*
*Mos u rrit*
*Sepse vijnë krushqit*
*Dhe të këpusin.*
*Të vënë nëpër xhepa,*
*Në xhepat,në jelekë*
*Dhe në mes të dyshekut. (Të shtratit)*

***Lahet arhondi i vogël***

*Lahet arkondi i vogël në një kanë të artë.*
*Rosa sjell ujin dhe pata*
*dhe motra e ngathët i sjell kanë të artë.*
*Tek guri rri dhëndri*
*dhe guri lëshoi ujë*
*për të rruajtur dhëndrin*
*dora e berberit ka një pjesë argjendi.*

- Kur imagjinon se këndohen të dyja këngët?
- Për ç' gjë bëjnë fjalë?
- Ç'zakon ekziston për dhëndrin para dasmës në të dyja vendet?

5. Dëgjoni këngët e mëposhtme, lexoni vargjet dhe shkruani doket dhe zakonet:

A.1.19-20. *«Të premten të shtunën në darkë*
A.4.7. *«Doli nusja tek shkalla»*



A.5.4 «Kur vishet dhëndri»
A.5.10. «Rrugë të mbarë bija ime»
A.5.11. «Shkove për ujë apo jo»
A.5.12. «Kunata jonë nuse e re»
A.5.14. «Erdhi të pa kunata»
A.6.4. «Filxhani i rrumbullaktë»
A.6.12. «Traka truk nëpër shkallë»
A.6.13. «Doli fshati dhe shikon»
A.7.12. «Ç' gëzim sa mirë»
A.9.3. «Moj e bardha si borë»
A.9.9. «Kur merr sitën dhe gatuan»
A.10.9. «More krushq»
A.15-16. «Ku ka shtëpinë krushku»

Video (http://www.youtube.com/watch?v=hhGUehNeQRI) paraqet zakonet e dasmës. Ekzistojnë këto zakone në zonën tuaj?

6. Dëgjo këngët e mëposhtme:

***Dil vjehërr tek shkalla***

*Dil, vjehërr tek shkalla, me mjaltin me qumështin*
*Të sjellë i riu një pëllumbeshë, sjell i riu një syzezë.*
*Të lutem, nun, të na vësh kurrorat*
*T' ia japësh vjehrrës sime t'i vendosë në sënduk*
*t'i vendosë në sënduk, në sënduk katua*
*Brenda shtëpisë tek dhëndri i ri*
*Dhe atje fole të ngresh, tetëmbëdhjetë zogj të vesh.*

**Dil, vjehërr tek porta**

*Dil, vjehërr tek porta*
*me mjaltin me qumështin,*
*me sheqerin në dorë,*
*të pranosh thëllëzën tënde*
*që ta sjell unë zonja jote.*

**Erdhi të pa kunata**

*Erdhi të pa kunata,*
*O e mirë,me hurma.*
*Nuk di ç' të dha,*
*Florinj dhe urime.*
*Erdhi të të shohë kunati.*
*O e mirë, me hurma.*
*Të dha treqind florinj.*
*O e mirë, me hurma.*

- Ç' zakone takojmë për dasmën tek këngët?
- Mund të gjeni zakone të përbashkëta në të dy popujt?
- Ndahuni në grupe dhe grumbulloni zakone që i takojnë dasmës në zonën tuaj. Grupet mund të ndahen si më poshtë:

GRUPI A: Këngë tradicionale dhe valle të dasmës.
GRUPI B: Veshje tradicionale.
GRUPI C: Gjellë tradicionale që gatuhen veçanërisht për dasmën.
GRUPI D: Zakone të tjera që kanë lidhje me dasmën (dhurata, pritja e nuses dhe të dhëndrit etj).

## 7. Kërkues të vegjël

Ndahuni në grupe. Çdo grup duhet të bëjë një kërkim muzikor që të grumbullojë ninulla të zonës së tij.

### Stadet e kërkimit

**Stadi i parë:**

1) Ndani krahinën tuaj në zona dhe sipas venbanimit tuaj ndahuni në grupe, me qëllim që zonën që do të merrni përsipër të jetë afër shtëpisë suaj.
2) Bëni një tabelë në klasën tuaj me grupet që krijuat dhe zonat që ka marrë përsipër çdo grup. Nëse doni mund të jepni një emër në çdo grup.
3) Çdo grup duhet t'u jap punë pjesëtarëve të tij. Kjo do të thotë se duhet të caktojë persona për këto punime:
   - Përpiloni hartën.gjeografike të krahinës: Një pjesëtar merr përsipër të ndihmojë grupin që të zbulojë zonën gjeorgafike që i përket dhe të zbulojë rrugët.
   - Regjistrim kalendarik i kërkimit: Në një fletore një pjesëtar mban shënime për ecurinë e kërkimit (ku u bë inçizimi, kur dhe nga cilët, nëse hasi grupi disa vështirësi dhe çdo gjë tjetër që gjykohet e domosdoshme.
   - Personi që inçizon: Merr përsipër inçizimet dhe përdor kasetofonin ose cd recorder që do të përdoret. Para çdo inçizimi thotë emrin e grupit, zonën në të cilën u bë inçizimi, datën, emrin e personit atij që këndon dhe titullin e ninullës nëse ekziston. Po të jenë më shumë se një ninullë dhe nuk ekzistojnë tituj, thjesht numëron ninullat. p.sh. *«Grupi A, E shtunë 14 qershor 2008, Zona A. Këndon zonja Maria Papadhopullu, ninullë nr.1»*.
   - Protokollim: Një pjesëtar merr përsipër të rregullojë kasetat ose cd në zona dhe në data dhe të kopjojë të dhënat në kopertinat e tyre.
   - Fletëanketë: Dy ose më shumë pjesëtarë marrin përsipër të bëjnë fletëanketat, t'i klasifikojnë dhe të përpunojnë rezultatet (për këtë punë duhen më shumë se dy veta).
4) Secili prej jush mund të marrë përsipër më shumë se një punim, sipas numrit të personave që përbëhet grupi juaj.

Organizoni një shfaqje në të cilën do të paraqesni rezultatet e kërkimit tuaj. Sukses të mire!

**Stadi i dytë:**

1) Bëni fletëanketën, për të grumbulluar të dhëna për ninullat që do t' ju këndojnë. Nga pyetjet duhet të mësojmë:
   - Moshën dhe seksin e personit që këndon.
   - Nga cila zonë e Shqipërisë vjen ninulla.
   - Nga e mësoi ninullën personi që këndon.
2) Mendohuni nëse duhen dhe informata të tjera për ninullat që do të grumbulloni dhe shtoni pyetjen e duhur në fletëanketën tuaj.

**Stadi i tretë:** Filloni inçizimet. Paralelisht duhet të ndani fletëanketën dhe të bëni regjistrim kalendarik.

**Stadi i katërt:** Sapo të mbaroni inçizimet, filloni protokollimin dhe përpunimin e fletëanketave.

**Stadi i pestë:** Paraqitni rezultatet e kërkimit tuaj në klasë.

**Stadi i gjashtë:** Kërkoni nga shkolla që bashkëpunoni në anën tjetër të kufijve t' ju dërgojnë materialin që grumbulloi.

8. Dëgjoni këngët: E.13.3. «Nëna jote dhe nëna ime», E.5.7. «Zaharulla», A.1.13. «Përtej detit mburrin një vajzë të re», A.1.23. «Më dhembi dhëmbi im», A.15.22-23. «Shko, nënë i thuaj Janit» dhe diskutoni në klasë për njohjen e të rinjve dhe për mblesërinë në shoqëritë e dy vendeve.

9. Dëgjoni këngën A.11.14. «U lodha, moj nënë». Në Dropullin e Shqipërisë këndojnë para dasmës këngën e mëposhtme: *«Tri ditë shkruajnë pajën dhe tri pajën e sipërme...»*. Në figurën e mëposhtme paraqitet një marrëveshje paje nga zona e Greqisë (e vitit 1929). Cili është zakoni i përbashkët që ekziston para dasmës në të dyja zonat?



Εἰς τὸ ὄνομα τοῦ Πατρὸς καὶ τοῦ Υἱοῦ καὶ τοῦ ἁγίου Πνεύματος Ἀμήν.

Σήμερον τὴν 2 Ιανουαρίου 1929 ἐσυμφώνησαν ἡ κυρία Ἀντωνίτσα [illegible] μετὰ τοῦ κυρίου Κυριακοῦ Γ. [illegible]. Ἔχων θυγατέρα Παναγιώτα καὶ δίδει αὐτὴν εἰς τὸν κύριον Κυριάκον σύζυγον δυνάμει τῶν Ορθοδόξων ἐκκλησιαστικῶν Κανόνων τῆς ορθοδόξου Ανατολικῆς Ἐκκλησίας. Δίδει εἰς αὐτὴν ὡς προῖκα τὰ ἑξῆς πράγματα.

1, ἕνα φέσι
2, ἕνα βέλο
3, ἕνα ζεῦγος σκουλαρίκια
4, Μία καρφίτσα
5, δύο δακτυλίδια
6, δύο Ζακέτες
7, Ἕνα ἐπανωφόριον
8, δέκα φορέματα διάφορα
9, δέκα μεσοφόρια, και [illegible]
10, δώδεκα υποκάμισα γυναικεία
11, δώδεκα [illegible]
12, δώδεκα υποκάμισα ανδρικά
13, δώδεκα σώβρακα
14, δώδεκα πετσέτες προσώπου.
15, δώδεκα φαγητοῦ
16, πέντε τραπεζομάντηλα
17, Ὀκτὼ σεντόνια
18, Ἕνα ζεῦγος [illegible]
19, ἕνα ζεῦγος [illegible]
20, δεκαπέντε μαξιλάρια διάφορα
21, Τέσσαρες [illegible]
22, πέντε [illegible]
23, δώδεκα ζεύγη κάλτσες γυναικείες
24, Ἕξ ζεύγη κάλτσες ανδρικές
25, δύο [illegible]
26, Ἕνα [illegible]
27, δώδεκα μαντήλια μεταξωτά
28, δώδεκα μαντήλια βαμβακερά
29, Τρεῖς [illegible]
30, [illegible]
31, Μία [illegible]
32, Ἕνα [illegible]
33, δύο [illegible]
34, δύο κουβέρτες
35, δύο [illegible]
36, [illegible] Αριθ. 4
37, τρία [illegible]
38, δύο τεψιά
39, Μία [illegible]
40, Ἕνα [illegible]
41, Δύο τιγάνι Αριθ. 2
42, δύο [illegible]
43, Ἕνα ζεῦγος [illegible]
44, Καὶ [illegible] χιλιάδες μετρητές

http://www.pi-schools.gr/download/programs/EuZin/ergasies_03_04/Peloponnisos/Peloponisos_19_34.pdf

Lexoni marrëveshjen e pajës dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.:

- Midis cilëve bëhet marrëveshja? Cila është marrëveshja?
- Marrëveshja e tyre është e lidhur me betim?
- Ç' përfshin paja?
- Cili është mendimi juaj për pajën? Ruhet procesi i pajës?
- Në të gjithë popujt dhe në të gjitha kohët familja e nuses gjithmonë jep pajë?

1. Cikli i çdo jete mbyllet me të njëjtën mënyrë për të gjithë dhe shkakton të njëjtin hidhërim tek ata që mbeten pas. Si në lindjen, në dashurinë, kështu dhe në emocionet që ndjen njeriu para vdekjes i shprehu në këngët e tij. Në muzikën popullore këto këngë quhen vaje. Dëgjo këngët e mëposhtme: E.9.10. «Curliut», E.11.2. «Vaji», A.1.2. «Dhimitraqi i nënës», A.13.20. «Të lava dhe të ndërrova, biri im». Dy vijnë nga zonat e Shqipërisë dhe dy nga zonat e Epirit.

- Ç' emocione të shkaktojnë?
- Ç' emocione beson se përpiqen të shprehin vajet që dëgjove?
- Me ç' mënyrë shprehin të dy popujt hidhërimin e tyre për humbjen e një personi të dashur?
- Sipas atyre që mësove në aktivitet të mëparshëm,mund t'i ndash këngët në polifonike dhe monofonike?

2. Dëgjoni pjesët e mëposhtme instrumentale: A.7.2. «Instrumentale» dhe A.7.8. «Instrumentale».

- Pse beson se i themi instrumentale?
- Mund të dallosh veglat që dallohen?

Shkruani në tabelën e mëposhtme emocionet që beson se mund të shprehin të dyja pjesët:

| A.7.2. Instrumentale | A.7.8. Instrumentale |
| --- | --- |
| .................................... | .................................... |
| .................................... | .................................... |
| .................................... | .................................... |

Për cilën pikë të ciklit të jetës do të përdorje njërën dhe për cilin tjetrën?

Shumë shpesh përdorim shprehjen «gërneta qan».

- Beson se e përdorim me kuptim real apo me kuptim metaforik?
- Ç'duam të themi kur përdorim këtë shprehje?
- Në cilën nga pjesët që dëgjove beson se shkon më shumë?

3. Lexojmë të dhëna nga enciklopedia lidhur me lumenjtë e Epirit.

Lumenjtë e Epirit janë: Arahthos i cili buron nga mali Lakmo dhe Micikeli dhe pranon gjatë rrugës së tij degët e tij që derdhen në Gjirin e Ambrakisë. Luros i cili buron nga mali i omaros dhe derdhet në Gjirin e Ambrakisë Thiamis (ose Kalamas) buron nga mali Dusko dhe derdhet në detin e Korfuzit nga Ormos i Valtos. Aherondas (ose Lumi i Zi) buron nga mali Tomaros dhe derdhet në Detin Jon nga Gjiri i Fanarit. Vjosa (Aoos) buron nga rafshnalta e Mecovës «Pesë lëmenj» dhe derdhet në detin Adriatik. Aheloos (ose Lumi i Bardhë) buron nga mali Lakmos dhe derdhet në lagunën e Mesollongjit.

www.live-pedia.gr

Mund të gjesh lumenjtë e Epirit në hartën? Njëri nga pesë lumenjtë e mëdhenj që përshkojnë Epirin, është i lidhur fortë me fazën e fundit të ciklit të jetës, dmth me vdekjen. Ky është lumi Aheronda. Kërkoni informata nga mitologjia lidhur me lumin Aheronda..

## 4. Kërkues të vegjël.

Ndahuni në grupe. Çdo grup duhet të bëjë një kërkim muzikor që të grumbullojë ninulla të zonës së tij.




© Googlemaps

### Stadet e kërkimit

**Stadi i parë:**

1) Ndani krahinën tuaj në zona dhe sipas venbanimit tuaj ndahuni në grupe, me qëllim që zonën që do të merrni përsipër të jetë afër shtëpisë suaj.
2) Bëni një tabelë në klasën tuaj me grupet që krijuat dhe zonat që ka marrë përsipër çdo grup. Nëse doni mund të jepni një emër në çdo grup.
3) Çdo grup duhet t'u jap punë pjesëtarëve të tij. Kjo do të thotë se duhet të caktojë persona për këto punime:
   - ✖ Përpiloni hartën. gjeografike të krahinës: Një pjesëtar merr përsipër të ndihmojë grupin që të

zbulojë zonën gjeorgafike që i përket dhe të zbulojë rrugët.

- Regjistrim kalendarik i kërkimit: Në një fletore një pjesëtar mban shënime për ecurinë e kërkimit (ku u bë inçizimi, kur dhe nga cilët, nëse hasi grupi disa vështirësi dhe çdo gjë tjetër që gjykohet e domosdoshme.
- Personi që inçizon: Merr përsipër inçizimet dhe përdor kasetofonin ose cd recorder që do të përdoret. Para çdo inçizimi thotë emrin e grupit, zonën në të cilën u bë inçizimi, datën, emrin e personit atij që këndon dhe titullin e ninullës nëse ekziston. Po të jenë më shumë se një ninullë dhe nuk ekzistojnë tituj, thjesht numëron ninullat. p.sh. *«Grupi A, E shtunë 14 qershor 2008, Zona A. Këndon zonja Maria Papadhopullu, ninullë nr.1».*
- Protokollim: Një pjesëtar merr përsipër të rregullojë kasetat ose cd në zona dhe në data dhe të kopjojë të dhënat në kopertinat e tyre.
- Fletëanketë: Dy ose më shumë pjesëtarë marrin përsipër të bëjnë fletëanketat, t'i klasifikojnë dhe të përpunojnë rezultatet (për këtë punë duhen më shumë se dy veta).

4) Secili prej jush mund të marrë përsipër më shumë se një punim, sipas numrit të personave që përbëhet grupi juaj.

**Stadi i dytë:**

1) Bëni fletëanketën, për të grumbulluar të dhëna për ninullat që do t' ju këndojnë. Nga pyetjet duhet të mësojmë:
   - Moshën dhe seksin e personit që këndon.
   - Nga cila zonë e Shqipërisë vjen ninulla.
   - Nga e mësoi ninullën personi që këndon.
2) Mendoni nëse duhen dhe informata të tjera për ninullat që do të grumbulloni dhe shtoni pyetjen e duhur në fletëanketën tuaj.

**Stadi i tretë:** Filloni inçizimet. Paralelisht duhet të ndani fletëanketën dhe të bëni rregjistrim kalendarik.

**Stadi i katërt:** Sapo të mbaroni inçizimet, filloni protokollimin dhe përpunimin e fletëanketave.

**Stadi i pestë:** Paraqitni rezultatet e kërkimit tuaj në klasë.

**Stadi i gjashtë:** Kërkoni nga shkolla që bashkëpunini në anën tjetër të kufijve t' ju dërgojnë materialin që grumbulloi.

Mund të lexoni libra që kanë lidhje me to:


Kaliocos Pandelis, «Ati dhe biri», Patakis, Athinë 1995.

Manthopulos Dimitris, «Ditët e Alqionës», Psihogios, Athinë 1993.

Marra Irini, «Një histori për dy», Kastanjoti, Athinë1985.

Metaksa-Paksinu Meri, «I saktë dhe i padëmtuar... nga familja», Kedros, Athinë 2003.

Panajotopulu Lica, «Një baba për mua», Sighroni Epohi, Athinë 1990.

Sari Zorz, «Gënjeshtra», Patakis, Athinë 1995.

«Shtëpi për pesë» të Lotis Petroviç - Andhrucopulu.




# kafshët dhe natyra



1 2 3

Natyra përbënte gjithmonë burim frymëzimi për njeriun.

Njeriu admironte bukurinë e saj dhe e bënte këngë, vjershë, fabul, pikturë. Vëreni karakteristikat e kafshëve dhe të bimëve dhe çmoni vlerën e tyre dhe rolin që luajnë në jetën e tyre dhe në jetën e gjithë planetit.

Shqiponja, thëllëza, limoni, rrapi dhe llojet e tjera të florës dhe të faunës të zonës jetojnë brenda në këngët popullore të dy popujve.

Le të njohim bukurinë e botës bimore dhe shtazore dhe lidhjen e tyre me njeriun nëpërmjet këngëve popullore.



1. Përpiquni të korrespodoni tingullin me figurën e saktë:


1


2


3


4


5


6

2. Dëgjo veglat dhe përpiqu t'i korrespodosh tingujt me figurën e saktë.

Nëse duhej të vëje ecjen e kafshëve, që të jepen më poshtë, me ndonjë nga veglat muzikore që dëgjove, si do të bëje korrespodimin?

Shkruaj pranë emrit të çdo vegle, emrin e kafshës që beson se shkon më mirë:

elefant mace luan bilbil kal flutur

①



........................................

②



③



④



⑤



⑥



3. Si kemi thënë, muzika është arti, që përdor si material të saj tingujt. Por ekziston edhe një tingull tjetër i rëndësishëm, të cilit nuk i japim zakonisht rëndësinë e duhur. Ky është tingulli i qetësisë së plotë dhe është shumë i rëndësishëm, sepse «pastron» veshët tona, që të pranojnë më mirë tingujt që do të vijojnë. Në këtë muzikë qetësia e plotë, d.m.th kur nuk dëgjohet asgjë fare, quhet pushim dhe ka dhe ky simbolet e tij, si çdo notë. Kështu kemi pushim të plotë, gjysëm pushimi, pushim 1/4, pushim1/8 etj. Çdo herë që lexojmë në një pjesë muzikore (partiturë) një pushim, në fakt matim përbrenda sa orë të MOS luajmë, ose të MOS këndojmë:

- Dëgjoni këngën: «Këndojnë gjashtë bilbila» dhe numëroni sa pushime ekzistojnë.
- Luajmë lojën «Karriget muzikore».
- Numëroni sa veta jeni në klasën tuaj dhe vendosni karriget në klasë në mënyrë që një bashkënxënësi juaj të jetë në këmbë.
- Kërkoni nga mësuesja juaj të vendosë këngën «Këndojnë gjashtë bilbila». Sa dëgjohet kënga ecni lirshëm nëpër klasë. Kur bëhet pushim, secili prej jush duhet të arrijë të ulet në një nga karriget. Kush tepron, del nga loja dhe hiqni një karrige. Fiton ai që mbetet i fundit.
- Kërkoni nga mësuesja juaj ose nga mësuesi juaj që përdor cd player ose kasetofonin, të ndalojë këngën tek pushimet sa më shumë kohë.

4. Lojë!

Kjo lojë luhet brenda në klasë. Duhet më parë të mësojmë të gjithë të këndojmë një këngë. Dëgjoni me kujdes dhe pastaj me ndihmën e mësuesit tuaj mësoni ta këndoni.

**_Drenushe_**

*Drenushe, rri urtë, xhelozja ime,*
*Që të të shikojnë fëmijët,*
*dhe të gjithë trimat, xhelozja ime,*
*dhe të gjithë trimat, drenushja ime.*

E mësuat?

Zgjedhim dy fëmijë. Njëri do të jetë «i çregullti» dhe tjetri shoqëruesi i tij. «I çregullti» duhet të hijë në qendrën e klasës dhe të lidhë sytë e tij. Shoqëruesi i tij e merr nga dora dhe e sjell reth e rrotull klasës dhe rreth vetes së tyre deri sa të humbasin orientimin e tyre. Kur ndalon, njëri nga fëmijët e klasës duhet t'i këndojë të çregulltit këngën «drenushe,rri urtë». I çregullti duhet të njohë cili i këndon dhe të tregojë me dorë drejtimin nga i cili beson se i vjen tingulli. Pastaj ndërrohen rolet.

Dëgjo pjesën orkestrale A.7.9. «instrumentale», të ndarë në dy grupe, luani lojën «parashiko kafshën». Njëri grup imiton një kafshë dhe tjetri përpiqet ta parashikojë.



5. Me pretekst këngët të njohë piktorë të shquar dhe të dallojë mënyrën që pikturojnë. Dëgjo këngët e mëposhtme: A.11.4. «Mbrëmë me dritën e yjeve», E.10.2. «Lule nga lëndina» dhe E.12.11. «Limoni i shkurtër».

- Cilën këngë do ta korrespodoje me secilën nga pikturat e mësipërme?
- Vëzhgo me kujdes dhe përpiqu t'i përshkruash me çdo hollësi.
- Është ndonjë prej tyre që të pëlqen më shumë?



Sezan, «Natyrë e vdekur»

6. Dëgjo këngën «Manushaqe».

- Mësojmë ta këndojmë kolektivisht. Ndahuni në dy grupe.
- Një grup merr përsipër këngën dhe tjetri të shoqërojë me duartrokitje, ose me vegla muzikore me përkusion që ekzistojnë në klasën tuaj.
- Fillon grupi me këngën dhe grupi me veglat muzikore me përkusion hyn vetëm në vargjet:

*«manushaqe-manushaqe, aromë dhe karafila*

*manushaqe-manushaqe, do t'ua jap fëmijëve»*



Van Gong, «Natë me dritë yjesh»

Mësojmë të këndojmë kolektivisht këngën «Mor limon i shkurtër».





Mone, «Lëkonja»

7. Shtëpia ime, shtëpiza ime

Më trego shtëpinë tënde, të të them kush je! Korrespodo çdo kafshë me folenë e saj. Gjeni fotografi ose vizatoni kafshët dhe foletë e tyre.

     

____ ____ ____ ____ ____ ____

**1. Foleja më tërheqëse:** Ndoshta jam arkitekti më i shkathët i natyrës! Bëj pëlhurën time prej mëndafshi që prodhohet nga trupi im. Përveç shtëpisë së sigurtë, është një grackë e mirë për insektet e vogla që përbëjnë ushqimin tim.

**2. Shtëpi lëvizëse:** Në vend që të ndërtoj folenë time jam brenda asaj. Guaska ime e fortë më mbron nga koha e keqe dhe nga armiqtë e mi, si gjarpërinjtë. Pa atë nuk do të mundesha të rroja.

**3. Fole të nëndheshme:** Jam ekskavatori më i mirë në mbretërinë e kafshëve. Kam duar me maja dhe thonjë të mprehta, si dhe kocka të forta dhe gjoks për të lëvizur lirshëm në vende të nëndheshme që krijoj.

**4. Fole me materiale natyrore:** Ndërtoj folenë time nga materiale që gjej në natyrë. Trazoj mbeturinat e druve me përshtymën time dhe krijoj një masë të lëngët që bëj lehtë, që të marrë formën e dëshiruar.

**5. Me shtëpinë në shpinë:** Mbart shtëpinë time në shpinë. Guaska ime është pjesë e trupit tim dhe kur ndiej se rrezikohem nga ndonjë armik ose nga koha e keqe mblidhem brenda saj dhe kënaqem me ngrohtësinë dhe sigurinë «e shtëpisë sime».

**6. Fluturime nga foleja në fole**: Balta është materiali më i mirl «ndërtimor» për folenë time. Është e lagësht dhe punohet lehtë dhe kur thahet bëhet e fortë si guri. Si murator me përvojë shtoj në përzierje dhe pak kashtë që të jem i sigurtë se nuk do të rrëzohet.

8. Dëgjoni këngët: E.13.7. «Ku ishe, thëllëzë e shkruar», E.13.8. «Lepuri»

- Ç'hanë kafshët e këngëve për të jetuar?
- Krijoni me figura zinxhir ushqimor.
- Po të thyhet një hallkë e zinxhirit çdo të ndodhë?
- Po të zhduket një kafshë nga njëra anë e kufirit, do të ndikohet zinxhiri ushqimor?

9. Dëgjoni këngët: E.1.9. «Ju zogj fluturues», E.10.13. «Drenushe», E.13.6. «Ku ishe, thëllëzë e shkruar», E.13.8. «Lepuri», A.6.9. «Thëllëzë mbi shkëmbinj», A.9.4. «U mbush oborri me pendë palloi».

Dilni në natyrë duke pasur me vete një fletë pune dhe të shkruani vërejtjet tuaja. Fleta e punës mund të ketë formën e mëposhtme.

FLETA E PUNËS

Pa prishur ekuilibrin e territorit shkruaj:

Tingujt që dëgjoj

........................................

Gjurmët e kafshëve

........................................

Fole kafshësh

........................................

Vepra njerëzore

........................................

10. Ndoshta keni ndjekur në televizor shfaqje cirku që kanë role kryesore kafshët.

- Cilat kafshë takojmë tek cirku?
- Në cilat vende jetojnë?
- Si u gjenden kafshët në cirk?
- Është vendi i përshtatshëm për të jetuar?
- Si është vendi i cirkut në të cilin janë kafshët?
- Ç' paraqiti çdo kafshë?
- Është në natyrën e tyre të bëjnë ushtrime akrobatike dhe numra të tjerë?

- Si mësuan të dëgjojnë urdhërat e zbutësit të egërsirave?
- Po nuk dëgjojnë, çdo të pësojnë?
- Duke njohur të gjitha këto, cila është pikpamja juaj për shfaqjet me kafshët?
- Πώς έμαθαν να υπακούουν στις εντολές του θηριοδαμαστή;

## 11. Lexoni historinë e ngatërruar të Markos

Jo, nuk bëhet fjalë për ndonjë djalë, por për një ari të murmë. Malet nga të dyja anët e kufijve grekoshqiptare ishin vendi dhe shtëpia e tij dhe u ndodh, në vitet e para të jetës së tij në një cirk dhe e keqpërdorin. Sot është 16 vjeç dhe jeton me të gjitha të mirat në strehim të ariut të murmë, në Nimfeo të Florinës. Vini figurat me legjendën në radhë. (Gazeta «Erevnites», v. 310 f. 14-15)

1) Sot Markos është një ari i madh dhe i fortë. I pëlqen të shtrihet në bar dhe të qendrojë në diell, duke gëzuar çastet e mira të jetës në natyrë!
2) «Do të bësh ato që do të them», e urdhëronte një zotëri i gjatë me një kapelë të lartë.
3) Vitet kaluan dhe Markos u rrit, kur një ditë fëmijët e liruan: arkturos do të merrte shokun e tyre përsëri në mal.
4) Markos jetoi vitet e para të jetës së tij në një cirk.
5) «Nuk dua, nuk më pëlqen, nuk mundem», mendonte Markos.
6) Atje çdo ditë Markos kishte vizita, por ndiente gjithmonë mërzitje. Fëmijët e kuptuan shumë shpejt dhe filluan të mendohen si ta lirojnë.
7) Udhëtimi ishte i gjatë dhe i lodhshëm, por rruga bëhej gjithmonë dhe më e bukur kur ngjiteshim më lartë brenda në pyje dhe lart në male.
8) «Nuk bën asgjë saktë», tha dikur një zotëri i gjatë me një kapelë të lartë dhe e dërgoi në kopshtin zoologjik.

















«Është i vetëm dhe e rezervuar, kur i afrohen njerëzit».

- Pse besoni se reagon kështu me njerëzit?
- Gjeni informata për organizatën «Arkturos» që mirëpret Markon.
- Shkruani një letër tek ariu Marko dhe i kërkoni falje për sjelljen e keqe të njerëzve. Firmosni letrën të gjithë nxënësit e klasës.



(Skicë: Gazeta «Erevnites», v. 222, f. 21)

12. Gjej nga cilat kafshë përbëhet kafsha e çuditshme e figurës.

- Cila karakteristikë të ndihmoi për ta gjetur?
- Këto kafshë ekzistojnë në zonën tënde?
- Mund t'i takosh edhe në anën tjetër të kufijve?

13. Lexojmë përrallat: «Të tre këlyshet e ujkut» të Evjenios Trivizas dhe «Mikropapucica» të Smaragdës Mandadaki.

- Cilat përralla na kujtojnë? I tregojmë apo i lexojmë dhe këto në klasë? Gjeni ngjashmëritë dhe ndryshimet.
- Cili është i keqi dhe i miri në çdo përrallë?
- Ekzistojnë kafshë të mira dhe të këqija?

14. Nga ato kafshë që janë të shkruara më poshtë, shuaj ato që beson që nuk jetojnë në Pind:

| | | | |
|---|---|---|---|
| luani | ujk | dhelpër | zorkadh |
| derri e egër | shqiponjë | vidër | kameleoni |
| nepërkë | delfini | kunadhe | ari |
| çakall | gushëkuqi | pinguin | bretkosë |
| breshkë | krokodil | papagall | kec i egër |

Nga ato kafshë që janë të shkruara më poshtë, shuaj ato që beson që nuk jetojnë në malet e Shqipërisë së jugut:

| | | | |
|---|---|---|---|
| luani | ujk | dhelpër | zorkadh |
| derri e egër | shqiponjë | vidër | kameleoni |
| nepërkë | delfini | kunadhe | ari |
| çakall | gushëkuqi | pinguin | bretkosë |
| breshkë | krokodil | papagall | kec i egër |

Cilat kafshë janë të përbashkëta në të dyja zonat? Pse ndodh kjo?

## 15. Luani gjahtarin

Fëmijët janë kapur në rreth. Çdo fëmijë luan rolin e një kafshe të pyllit. Një fëmijë, që bën gjahtarin, ndodhet jashtë rrethit. Fëmijët këndojnë këngën e njohur nga loja tradicionale, ujku, «eci nëpër pyll, kur ujku nuk është këtu» por i përkthyer jo fjalë për fjalë.

«Eci, eci nëpër pyll, kur gjahtari nuk është këtu». Djali gjahtar i përgjigjet pyetjes duke thënë çdo herë se vesh pantallonat ose këmishën ose këpucët ose kapelën e tij dhe në fund merr pushkën dhe i ndjek. Fëmijët vrapojnë nëpër territorin për të shpëtuar. Fëmijë që kapet nga gjahtari, del nga loja. Kjo gjë vazhdon deri sa ujku t'i kapë të gjithë fëmijët. Atëherë pylli mbetet i shkretë.



## 16. Dëgjo përrallën muzikore të Sergjei Prokofief «Petros dhe ujku».

Përralla fillon kështu: «Do t'ju them një histori», thotë treguesi. «Një histori muzikore. Qëllimi, fëmijë, është të dëgjoni tingullin që nxjerrin disa vegla muzikore. Në historinë, çdo karakter ekzekutohet nga një vegël tjetër. Flauti bën zogun... oboe rosën... klarineti bën macen... fagoti bën gjyshin e rreptë të petros... tri korneta luajnë ujkun gri... veglat kordofone, të ghitha bashkëpetron, të famshmin... gjahtarët i bëjnë. veglat frymore prej druri... ndërsa daullet dhe grankasat oshëtijnë si të shtënat e gjahtarëve». Dhe historia fillon...

Ju pëlqeu përralla? Le të bëjmë tani një përrallë tjetër në bazë të historisë që dëgjuam. Ndahuni në dy grupe.

- Njëri do të marrë përsipër të gjejë fotografi nga kafshët që përmenden brenda në përrallë.

- Tjetri do të marrë përsipër të sjellë fotografi nga veglat që dëgjohen brenda në përrallë.
- Çdo grup të blejë nga një karton të madh dhe të bëjë një kollazh me fotografi që sollët në klasë.
- Kujdes! Vini në tabelat që do të ndërtoni vendin përkatës në çdo vegël njërën nga kafshët.
- Varni tablotë tuaja në klasë.

17. Muzika është një nga të shtatë artet, por, llojet e saja janë të shumta. Çdo epokë dhe çdo popull gjen me mënyra të ndryshme të shprehet nëpërmjet muzikës. Do të mundim si fillim, të ndajmë muzikën në dy kategori shumë të mëdha: **klasikën** dhe **tradicionalen**.

- Përpiqu të përshkruash me gojë çdo njërën nga këto dy kategori.
- Dëgjo dy shembuj muzikorë: Një pjesë nga përralla muzukore «Petros dhe ujku» dhe këngën E.1.9. «Ju zogj fluturues».
- Cilën do të karakterizoje si vepër klasike dhe cilën si repër tradicionale të muzikës?

18. Dëgjoni këngët: E.13.7. «Ku ishe,thëllëzë e shkruar», E.13.8. «Lepuri». Ç' hanë kafshët e këngëve për të jetuar? Korrespodo kafshët e mëposhtme me ushqimin e tyre. Nëse zhduken kafshët dhe bimët e vijës së dytë çfarë do të ndo në kafshët e vijës së parë?

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| lepuri | dhelpra | ujku | ariu | shqiponja | thëllëzë |
| gjarpërinj | krimba | manafera | lakra | zorkadhe | minj |

19. Dëgjoni këngët:
E.1.9. «Ju zogj flututues», E.10.11. «Bilbil i vogël», E.13.7. «Ku ishe, thëllëzë e shkruar», A.15.8-9. «Zura një thëllëzë», A 15.13. «Këndojnë gjashtë bilbila».

Korrespodoni emrat e kafshëve në greqisht dhe në shqip me fotografitë e tyre:

1) Αετός / Shqiponjë

2) Αγριόπαπια / Rosë e egër

3) Τρυγόνι / Turtulli

4) Πέρδικα / Thëllëza

5) Αηδόνι / Bilbil

6) Χήνα / Pata








20. Dëgjoni këngët: E.10.13. «Drenushe», A.14.11. «Po zbret thëllëza nga mali», A.8.14. «Kur kaloje rrëzë malit».

Njerëzit e këngëve që dëgjuat krahasohen me kafshë. Dhe në këngët greke dhe në këngët shqiptare, disa veti të e kafshëve jepen në njerëz. Bëni krahasimet tuaja duke lidhur personat e shtyllës së parë me kafshët e shtyllës së dytë që kanë karakteristika të përbashkëta. Mund të plotësoni dhe ju krahasime të tjera.

| | | |
|---|---|---|
| Janis dhe Nikos hahen | | ujku |
| №ton | | dhelpra |
| Ka uri | | qeni me macen |
| Petros këndon | si | tigri |
| U zemërua dhe o hodh | | peshku |
| Eleni është dinake | | breshka |
| Maria vrapon shpejt | | lepuri |
| Ecën ngadalë | | bilbil |




21. Kushtet klimaterike që ekzistojnë në të dyja zonat detyrojnë kafshët të gjejnë mënyra, për t'i përballuar. Si e përballojnë kafshët të ftohtin?
Në një karton shkruaj mënyrat që e përballojnë të ftohtin kafshët dhe ngjitni pranë fotografinë e kafshës përkatëse.

22. Dhjetë kafshë të Pindit u fshehën në kriptogramin e mëposhtëm. Kërko t'i gjesh.

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| a | k | ë | t | v | z | o | w | f | p |
| s | l | o | n | u | r | i | t | h | x |
| ç | s | g | a | j | t | f | b | e | d |
| u | h | b | m | k | n | h | l | k | h |
| d | q | m | k | u | n | a | d | h | e |
| i | i | n | z | r | ë | ç | h | u | l |
| o | p | t | s | e | i | l | i | r | p |
| z | o | r | k | a | d | h | e | p | a |
| k | n | g | i | z | p | i | e | l | m |
| l | j | h | f | t | e | p | g | b | f |
| d | e | d | t | r | w | l | ë | x | b |
| c | n | s | e | e | q | a | r | i | s |
| k | e | t | r | i | a | g | t | p | k |
| s | d | ë | k | y | t | z | ç | j | l |
| a | h | j | a | i | n | e | h | o | o |

23. 4 Tetor dita ndërkombëtare e kafshëve (Gazeta «Erevnites», 5-10-2002). Krijoni një tablo me të drejtat e kafshëve duke u bazuar në Shpalljen Ndërkombëtare të të Drejtave të kafshëve («Bashkimi i të Drejtave të kafshëve», Paris, 1978). Vendosni tablonë në një vend qendror të shkollës suaj. Vini titullin: «Të drejtat e miaaaaa!!!»

## «Të drejtat e miaaaaaaaa!!!»

**Neni 1**

Të gjitha kafshët lindin me të njëjtat të drejta ekzistimi.

**Neni 2**

Njeriu duhet të respektojë jetën e çdo kafshe dhe të përdorë njohuritë e tij për të drejtat e kafshëve.

**Neni 3**

Asnjë kafshë nuk duhet të keqpërdoret. Nëse vdekja e saj është e domosdosmke, duhet të bëhet shpejt, pa dhimbje të kafshës.

**Neni 4**

Çdo kafshë duhet të jetojë në vendin e saj të natyrshëm dhe të riprodhohet sipas ligjeve të natyrës.

**Neni 5**

Çdo kafshë që sipas traditës është shtëpiake, ka të drejtë të jetojë me kushte të jetës dhe të lirisë që i përkasin llojit të saj.

**Neni 6**

Çdo kafshë, mik i njeriut, ka të drejtë të jetojë gjatë sipas jetesës së saj natyrore. Braktisja e saj konsiderohet si veprim çnjerëzor dhe poshtërues.

**Neni 7**

Ndalohet shfytëzimi i kafshëve për dëfrimin e njerëzve. Shfaqjet që përdorin kafshë, përbëjnë zhdukje dinjiteti, respekti për jetën e kafshës.

**Neni 8**

Çdo veprim që shkakton vdekjen e një numri të madh kafshësh të egra quhet «gjenocid», është krim përballë llojit. Ndotja dhe shkatërimi i mjedisit natyror çojnë në gjenocid.

**Neni 9**

Respekt duhet edhe te kafsha e vdekur.

**Neni 10**

Të derjtat e kafshëve duhet të sigurohen nga ligje si dhe të njerëzve.

Korrespodoni nenet me të drejtat e kafshëve me fotografitë e mëposhtme. Shtoni, nëse doni edhe fotografitë tuaja. Shkruani në gazetën e shkollës suaj ose në ndonjë gazetë tjetër, një artikull me temë «të drejtat e kafshëve».





















..............................

..............................

..............................

24. Në kryeqytetet e dy vendeve, Shqipërisë dhe Greqisë, ekzistojnë kopshte zoologjike. Mund t'i vizitoni. Nëse kjo gjë është e pamundur, interneti juaj ju jep mundësinë t'i vizitoni me imagjinatën tuaj. Vizitoni, të dy kopshtet zoologjike dhe mblidhni fotografi dhe informata për kafshët që mirëpresin.
Faqe interneti të kopshtit zoologjik të Tiranës: http://www.desave-pz.com/albumi/index.php?cat=013 dhe faqe interneti Atiku parku: http://www.atticapark.com/animals_gr.htm.

Në vendin rrjetor të internetit të Universitetit të Janinës (http://www.viopikilotita.uoi.gr) ekzistojnë informata për kafshët dhe bimët e Epirit. Mund ta vizitoni dhe t'i njihni.



1. Dëgjoni këngët: E.14.7. «Pesë rrape», A.14.8. «Kajsi e mbushur».

Paraqitni pemëm që gjendet në oborrin e shkollës, duke e fotografuar dhe në të katër stinët e vitit. Dërgoni fotografitë në një shkollë të vendit fqinj, duke kërkuar t'ju dërgojnë fotografitë e tyre. Krahasoni pemët.

dimri

pranvera

vera

vjeshta

2. Dëgjoni këngët: E.1.2. «Nerënxë gjethë-shumë», E.12.11. «Limon i shkurtër», A.12.22. «Nerënxa ime ç'të thashë».

- Bëni një alfabet të bimëve. Për çdo shkronjë gjeni një bimë ose diçka të përafërt me atë. Preni aq kartela sa dhe shkronjat e alfabetit. Në çdo kartel shkruani emrin tuaj, fjalën që gjetët dhe vizatoni diçka që lidhet me fjalën p.sh. Arra, Bajame, etj.

- Gjeni pemë frutore të vendit tuaj dhe shkruani emërtimin e tyre poshtë frutës përkatëse. Emërtimet ngjajnë dhe në të dyja gjuhët? Shkruani emërtimet e frutave dhe të pemëve në gjuhën tuaj. Kërkoni nga bashkënxënësit tuaj që njohin gjuhën tjetër, të plotësojnë emërtimet dhe në gjuhën e dytë.






3. Dëgjoni këngët: E.10.2. «Lule nga lëndina», A.11.19. «Manushaqe».

Ndahuni në grupe. Çdo grup zgjedh të paraqesë një bimë të përbashkët të dy zonave. Pastaj nga ckskursioni në natyrë gjeni bimën dhe përgjigjuni pyetjeve në fleteänketën:

- Cila karakteristikë e bimës ju ndihmoi ta dalloni?
- Vëreni gjethet e saj. I përshkruani

- Ka lule apo fruta? I përshkruani.
- Sa e madhe është? Nga se besoni se varet madhësia e saj?
- Dhe tani skiconi këtu mostrën që keni. Vëreni skicën që ndërtuat dhe njëkohësisht zonën që paraqitet. Sa lloje të ndryshme bimësh shikoni?

Një në tetë bimë në gjithë botën rrezikohet me zhdukje. Ka mundësi në disa dekada të mos ekzistojnë të gjitha llojet e ndryshme të bimëve.

- Ç'rezultat do të kishte?
- Besoni se ekzistojnë dhe organizma «pa vlerë» në mjedisin tonë?
- Po të zhduken nga zjarri ose nga ndonjë shkak tjetër bimët gjatë vijës kufitare të një vendi çdo të ndodhë në ikosistemet e dy vendeve.

### 4. Gjelbëroj shkollën time.

Dëgjoni këngët: E.13.10. «Dil nënë, të shikosh diellin», A.8.4. «Më pranon në kopshtin tënd». Gjeni një kënd në shkollën tuaj, në të cilën do të bëni një kopsht tematik. Gjeni fara dhe bimë të vogla nga lloje farmaceutike dhe aromatike si trumza, sherbelë, dafinë, rigon, çaj, kamomil, livandë etj. dhe i mbillni. Tregoni kujdes për to dhe mësoni për vetitë e tyre.

5. Në të gjithë botën fabulat për lulet dhe bimët janë të pambaruaraNë mitologjinë e të dy popujve, lulet e egra dhe shkurët marrin rëndësi të madhe dhe lidhen me hyjnitë dhe njerëzit. Përpiquni të merrni «erë» të vogël nga fabulat. Mjafton t'u drejtoheni të rriturve ose të kërkoni në libra. Lexoni fabulat në klasë dhe do të shikoni se aroma dhe bukuria do të vërshojnë klasën tuaj! Si shembull përmenden disa. (Erevnites, v. 482, f. 8-9)

Iakinthos

Një i ri nga Sparti ishte i bukur si perëndi dhe shok i ngushtë i perëndisë së Apolonit. Shpesh gjuanin dhe stërviteshin bashkë. Derisa një ditë, atje ku ndesheshin në hedhjen e diskut dora e Apolonit, qëlloi gabimisht kokën e Iakinthos dhe e vrau. Nga gjaku i të riut pa fat, Apoloni bëri një lule me erë të këndshme, zymbylin, të njohurin, zumbul.

Lulëkuqja e egër dhe Anemona

Adonis ishte njeriu më i bukur dhe Afërdita e dashuroi. Aris, perëndia e luftës zilisi dhe u kthye në derr të egër dhe plagosi Adonin për vdekje. Nga gjaku i tij thonë se lindi lulëkuqja e egër dhe nga lotët e perëndisë një lule që ka jetë të shkurtër. Me fryrjen e pare të erës petalet e saj shpërndahen larg. Kështu lulja u quajt anemonë.

6. Dëgjoni këngët: A.7.11. «Instrumentale», A.7.9. «Instrumentale».
Nxënësit hartojnë dekalogun e vizitorit të mirë në pyll.

1. Nuk hedh mbeturina.
2.
3.
4.
5.
6.
7.
8.
9.
10.

7. Dëgjoni këngët: A.14.11. «Po zbret thëllëza nga mali», E.10.2. «Lule nga lëndina». Për fat të keq shpesh dëgjojmë në lajme ose lexojmë në gazeta për zjarret që djegin qindra dynyme pylli. Por pastaj ç' bëhet?

Lexoni përrallën «Mëllënja kërkon pylli të shpëtojë» në tekst të Vasilit Iliopulos, me aktivitete të Vasilikis Nika dhe ilustrime të Franceskës Kozanti. «Indiferenca dha pakujdësia ishin armiqtë më të madhenj të pyllit. Pas zjarrit të madh, njerëzit e pyllit harruan se pylli do ripyllëzim dhe e lanë të zi dhe pa jetë. Zogjtë ishin të parët që reaguan. Fëmijët u shqetësuan dhe...»

Vizatoni pikrura me kontraste. Ndahuni në dy grupe. Merrni një letër me gjatësi një metër dhe ndajeni në mes, gjysma e nxënësve vizatoni vetëm me ngjyrë të zezë një pyll të djegur dhe gjysma tjetër në pjesën tjetër të letrës vizatoni një pyll me ngjyrë dhe jetë. Në cilën pjesë doni të jetoni?



8. Dëgjoni këngët:
A 14.11. «Po zbret thëllëza nga mali», E.10.2. «Lule nga lëndina»

Isha një pyll...
Më ndihmoni të ribëhem i bukur, duke më vizatuar pemë, lule dha kafshë.
Të hyjë një fotografi nga një pyll i djegur dhe t'a vizatojnë. Kujdes!

9. Lojë domino!

Në një domino të tregut vizatoni ose gjeni figura nga revista për natyrën (lule, kafshë, pemë, njerëz, perëndime dielli, zjarr etj.). Preni dhe i ngjitni  në pjesët e dominosVendosni në dysheme një hartë të dy vendeve. Vini mbi hartë pjesët me këtë rend: zjarr, bimë, kafshë peizazh, njeri. Hidhni pjesën e parë.
Çdo pjesë e dominos me mënyrë mahnitëse rrëzon pjesën që vjen, duke shkatërruar ekuilibrin ekologjik.

- Cila është hallka e tretë e zinxhirit që prishet?
- Po të ndryshojmë radhën do të kemi të njëjtin rezultat?

- Nëse pjesa e parë që rrëzohet gjendet në vendin tjetër, do të kemi të njëjtin rezultat?
- Ndryshoni shkakun e shkatërrimit (pjesën e parë) me ujëra të infektuara, ilaçe bimësh etj., ç'rezultat do të ketë domino?

10. Dëgjoni këngët: E.13.10. «Dil, nënë, të shikosh diellin» dhe A.3.15. «Më pranon në kopshtin tënd?».

Informim i në çeshtjet që i përkasin mjedisit nuk është i mjaftueshëm. Duhet të kthehet në veprim. Imitoni shembullin e fëmijëve të fotografisë dhe gjeni një kënd në shkollën tuaj, në të cilën do të bëni një kopsht tematik. Gjeni fara dhe bimë të vogla nga lloje farmaceutike dhe aromatike si trumza, sherbelë, dafinë, rigon, çaj, kamomil, livandë, fidanishte etj dhe i mbillni. Tregoni kujdes gjatë gjithë vitit, mësoni për vetitë e tyre, bëni fotografi në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre.



Fëmijë ujitin një pjesë të vogël kopshti në shkollë fillore në Zimbabue. Fotografia është nga revista kosmos të UNICEF, v. 72, f 34.

11. Dëgjoni këngët: E.14.7. «Pesë rrape», A.11.19. «Manushaqe». Dilni një shëtitje nëpër pyll. Shikoni dhe dëgjoni me kujdes...

Mund të zbuloni diçka! Përpiquni t'u përgjegjeni këtyre pyetjeve:

- Shikoni llojet e ndryshme të ngjyrës së gjelbër. Sa tone dalloni?
- Shikoni pemët në mjedisin përreth. Ç' karakteristika kanë në këtë stinë?
- Bëj fotografi.
- Takoj:

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| përnar | ☐ po | ☐ jo | kumar | ☐ po | ☐ jo |
| dushk | ☐ po | ☐ jo | ahe | ☐ po | ☐ jo |
| gështënja | ☐ po | ☐ jo | bredh | ☐ po | ☐ jo |
| të tjera | ☐ po | ☐ jo | | | |

- Trungjet e pemëve janë krejt të zhveshur apo kanë organizma të tjerë të ngjitur mbi ta?
- Si janë gjethet e tyre?

Kur keni studiuar pemët dhe shkuret, përqendroni vëmendjen tuaj në pjesët e tjera të pyllit. Vëreni truallin dhe kostatoni ekzistencën ose mungesën të elementeve të mëposhtme:

☐ Pa bimësi, tokë e zhveshur
☐ I mbuluar me gjilpëra
☐ I mbuluar me gjethe
☐ I mbuluar me myshqe
☐ I mbuluar me myshqe dhe me bar
☐ I mbuluar me bar




Vëreni bimët që gjenden afër pyllit si blerimi: bimë me frura, bimë aromatike, bimë kacavarëse. bimë me lule. Takuat kërpudha?

12. Mendohuni se gjatë vizitës në pyll takoni një grup druavarësh të paligjshëm që kërcënon pyllin. Pyesni veten pse njeriut i duhet pylli dhe në cilat raste i duhet lënda e drurit. Shkruani çfarë ndjejnë dhe si reagojnë krijesat e pyllit, kur shikojnë druavarë të paligjshëm. Si planifikojnë të mbrojnë pyllin e tyre? Hyni në vendin e çdo heroi të pyllit dhe shënoni argumentet e tij. Përpiquni të propozoni zgjidhje për problemin e shfrytëzimit të madh të pyllit.

13. Përpiquini të plotësoni fjalëkryqin me fjalë pylli.
(Burim: http://www.kpekonitsas.gr/index.htm)

1) Insekt me ngjyrë të ndritur.
2) Bar aromatik.
3) Ngjitet në plaggia të thepisura.
4) Kjo kafshë fsheh fruta dhe kështu ndihmon në ripërteritjen e pyllit.
5) Kacavaret në pemë dhe pi lëngjet e tij.
6) Quhet dhe lis.
7) Frutat e tzre janë bocët e pishës.
8) Pemë gjethedendur si pëllembë.
9) Quhet kështu, sepse tund bishtin e saj.
10) Ekyistojnë të sbijshme, por dhe helmuese.
11) Lëviy duke kërcyer.




[1] livelulë, [2] trumza, [3] dhia e egër, [4] kerti, [5] urthi, [6] dushku,
[7] halorët, [8] rrapi, [9] bishtatundësi, [10] kërpudha, [11] lepuri

14. Ndahuni në grupe dhe gjeni informata për valësat (mënyra e prodhimit, fabula, vetitë bamirëse,këngë etj). Të dhënat që do të grumbulloni do të përbëjnë materialin për një shfaqje. Pyesni nxënësit e shkollës që bashkëpunoni nëse në zonën e tyre ekzistojnë këto valësa dhe si i përdorinKështu mund të pasuroni materialin që keni mbledhur. Të dhënat që keni grumbulluar mund t'i shkruani dhe të krijoni librin tuaj me «këshilla dhe barna nga natyra».

15. Më poshtë mund të lexoni informata për valësat e dy vendeve. Këto valësa gjënden edhe në zonën tuaj? Si i përdorin dhe për ç' sëmundje, sipas mjekësisë «praktike»?

**Informata nga një libër shqiptar**



*Murriz (Crataegus Oxycantha)*

*Substancat e tij ndihmojnë në parandalimin e shumë sëmundjeve. Sidomos ndihmon ata që kanë problem me zemrën, sepse forcon muskujt dhe siguron ritmin normal.*



*Hithra (Urtica diocia)*

*Hithra është mbetëresha e bimëve mjekësore. Ndihmon në pastrimin e gjakut, gjithashtu larja e kokës me lëndën që prodhohet pas zierjes se hithrës lufton rënien e flokëve dhe zbokthin.*



*Rigon (Lamiacease)*

*Rigoni lufton gurin në tëmth.*



*Sherbeli (Salvia officinalis)*

*Çaji nga sherbeli ësthë për uljen e temperaturës. Rekomandhet të pihet mëngjes ose çdo darkë.*



Limoni (Citrus limon)

Një metodë e mirë për tensionin është lëngu i limonit. Rekomandohet lëngu i katër limonave në ditë për dy muaj.

**Informata nga faqet greke të internetit**



Trumza (Thymus serpyllum)

Rekomandohet për shumë sëmundje infektuese të tubit gastroenterik dhe të mushkërive. Me trumzën e zier luftonin zgjebën. Përdoret gjithashtu në blektori dhe si aromatik gjatë gatimit.



Diozm (Mentha viridis)

Në farmaceutikë përdoren gjethet e thata të diozmit nga të cilat përgatitet valësa me veti përforcuese,nxitëse dhe kundër spazmave. Përdoret gjithashtu kundër dispepsisë, shqetësimeve nervore, shpejtim pulësi , kundër dhimbjeve të stomakut dhe të fshikëzës së tëmthit.



Borziloku (Ocimum basilicum)

Nga lulet dhe nga gjethet prodhohet diuretic dhe qetësues të sëmundjeve të stomakut dhe të zorrëve.



Diktamo (Origanum dictamus)

Përveç valësës së veçantë, diktami ka edhe veti kuruese. Është antiseptik, shëron plagët, qetësues i sistemit tretës, përdoret kundër gripit dhe ftohjeve.



Bar blete (Melissa officinalis)

Në praktikën mjekësore bari i bletës përdoret si përforcues, kundër spasmave, kundër reumatizmave, kundër astmës

*dhe për hapjen e oreksit. Rekomandohet sidomos për përballimin e dhimbjeve dhe spazmave të stomakut, kolikëve, dispepsi, kriza nervore,dhimbje dhëmbësh etj.*



*Hithra (Urtica diocia)*

*Grekët e lashtë konsideronin hithrën nga bimët më të mira nga pamja mjekësore. Përdoret si bimë mjekësore, është e mirë për ndalimin e rrjedhjes së hundës, gjithashtu, përdoret për ndalimin e rënies së flokëve.*

## 16. Çfarë frutë jam?

Dëgjoni këngët: E.14.10. «Molla ime e kuqe», A.14.8 «Kajsi e mbushur».
Pjesët e mësipërme (Gazeta «Erevnites», v.184, f. 10) flasin për disa fruta. Bëni kartela frutash dhe të luani me to. Mund të shkruani pjesët tuaja. Njëri grup përshkruan dhe tjetri parashikon.

Nëna ime ka prejardhjen nga Kaukazi, është një pemë që arrin gjatësinë 10-15 metra. Fruta e saj,domethënë unë, piqem nga fundi i majit dhe nga fillimi i qershorit, por shpesh nuk nxitohem të shfaqem dhe në korrik. Kur merreni me vjeljen time, duhet të jeni shumë të kujdesshëm, që të mos lëndoni mbulesën time të ndjeshme.

qershi

Kam prejardhje fisnike. i përkas fisit Prunos dhe familjes Rodhite. Kam paraqitje të mirë dhe kam shumë lëng sa duhet që të kënaq qiellzën e atyre që më shijojnë. Nëna ime që është pemë, me kushte të përshtatshme zhvillimi mund të jetojë mbi 100 vjet.

kajsia

Nëna ime për të bërë fruta të pjekura dha të lëngëta i duhen 80 me 120 ditë pa ngrica dhe me temperature të lartë. Për të vërtetuar se arriti koha e ndarrjes nga nëna, zakonisht, më qëlloni lehtë me gishtat tuaj dhe nëse tingulli që nxjerr është i thellë dhe jo metalik, më këpusni, më ngarkoni në kamionë dhe më çoni në shtëpitë tuaja, për të më... prerë dhe të më shijoni.

shalqiri

Pa diell, vapë, atmosferë të thatë nuk është e mundur të jem në orën time gjatë verës. Jam shëndetpak dhe shumë shpesh sulmohem nga shumë armiq dhe kur i përmend dridhem.

pjepri

Spartiatët e lashtë më shijonin me mani. Në mitologjinë latine konsideronin se nëna ime ishte një pemë e shenjtë e Vakhut dhe bijtë e saj, mua dhe vëllezëtit e mi, na përdornin në ceremoni fetare. Greqia, Italia, Turqia dhe Algjeria, në rradhë të parë ndajnë midis tyre shijen time dhe kënaqen me hijen e thellë të gjetheve që hedh nëna ime.

fiku

Disa prej jush që jeni më të vëmendshëm do të më keni parë në shfaqje pikturash afër perëndisë së Dionisos. Jam për përdorime të shumta: dhe më hani, por dhe më përdorni për krijimin e një pije shumë të kënduar. Kemi shumë vëllezër në të gjithë botën. Nëna ime, nuk është e dëgjuar për shtatin e saj, por është e ndjeshme me mua..

rrushi

17. Krijoni dhe ju artin tuaj të shijshëm!

Si materiale do të përdorni fruta dhe lakra të stinës. Kujdes gjatë prerjes! Skiconi mbi frutën ose lakrën skicën e frymëzimit tuaj dhe në vazhdim hiqni atë që tepron. Krijimet tuaja mund të zbukurojnë shfaqjen tuaj, por dhe të përbëjnë meze të freskëta dhe të shijshme! Mund të «vidhni» dhe ide nga fotografitë e mëposhtme.







1. Le të njohim nuancat e natyrës në një pikturë. Vëreni me kujdes pikturën e V. Van Gong «Natë me dritë yjesh».

Sa nuanca të ngjyrës blu dallon?

Le të meremi me katër nuancat e ngjyrës blu:

- blu e thellë,
- blu,
- blu e hapur,
- e kaltër.

Edhe muzika ka nuanca.
Dëgjoni tani veglat.
Cilën nuancë të ngjyrës blu do të jepje në veglat?





violinë violë violinçelo kontrabaso

2. Parqet kombëtare Butrindi, Prespa dhe Viku-Vjosa janë afër vijës kufitare të dy vendeve. Nevoja për mbrojtjen e përbashkët të zonave të mbrojtura krijoi një marrëveshje të përbashkët të tri vendeve ballkanike në rastin e liqeneve të Prespës.

- Për ç'arsye u bë kjo?
- Mbrojtja e këtyre zonave mos tejkalon kufijtë e ngushtë të vendeve dhe është temë që duhet të shqetësojë gjithë planetin?
- Grumbulloni material informatik dhe fotografi nga territoret e mbrojtura. Diskutoni për florën dhe faunën. Flisni për bimët endemike të zonave edhe për biotopet me lagështirë të Prespës.

### 3. «Ndokush, do të rrojë apo jo?»

Pyetja për mijëra kafshë dhe bimë nuk është retorike. Dhjetra lloje kafshësh dhe bimësh zhduken çdo ditë. Shkaku është zvogëlimi i pakontrolluar i biotopeve, gjuetia e paligjshme, ndotja e atmosfrës dhe ndryshimet klimaterike.Shumë prej tyre nuk kemi arritur t'i njohim. Por,çdo lloj që zhduket, merr me vete dhe një pjesë të gjenetikës dhe të historisë së zhvilluar gjatë qindra viteve, burim i çmuar njohurie për njeriun.
Për fat të keqë nga Greqia dhe Shqipëria ekzistojnë shumë kafshë dhe bimë që janë përfshirë në listën e kuqe. Krijoni, grupin e listës së kuqe, në zonat që gjenden në të dyja anët e kufijve.
Për të bërë të ndjeshëm edhe nxënësit e shkollave të tjera, por edhe banorët e dy zonave, krijoni një afishë për mbrojtjen e tyre.

4. Lexojmë për një kompozitor.

Bela Bartok (1881-1945): Ndoshta është kompozitori më i madh kombëtar i Hungarisë dhe një nga kompzitorët më të rëndësishëm që përdori materialin tradicional popullor. Kompozotori studioi në thëllësi muzikën popullore të vendit të tij, por edhe të popujve fqinjë të Evropës Lindore, duke udhëtuar pothuaj në gjithë vendin dhe duke regjistruar muzikën popullore-tradicionale të vendit të tij. Ka shruar opera, koncerte muzikë për piano, kuartete për kordofonet etj.

Kuarteti i kordofonëve përbëhet zakonisht nga dy violina, violë dhe violinçelo. Quhet kuartet, sepse marrin pjesë në të katër vegla (quarto = katër në italisht).

- Dëgjo një nga kuartetet e kordofonëve të Bela Bartok dhe përpiqu të dallosh veglat.
- Zgjidh një ngjyrë nga nuancat e tij (si bëmë më lartë me ngjyrën blu) dhe përpiqu të vizatosh me nuancën përkatëse çdo herë që dëgjon veglën përkatëse.

Kërkimi që bëri Bela Bartok, quhet etnomuzikologji. Mund të imagjinosh ç' tregon termi?

Përbëhet nga tri fjalë. Përpiqu t'i gjesh:

etnomuzikologji = .............................. + .............................. + ..............................

Një kërkim i tillë u realizua nga një grup kërkues Grekë në zonat e Konicës në Greqi dhe të Përmetit në Shqipëri. Kërkuesit udhëtuan në këto zona dhe inçizuan banorët e

tyre të këndojnë këngë tradicionale popullore. Njëkohësisht inçizuan muzikantët që ekzekutuan me veglat e zonës këngë dhe valle tradicionale.

Dëgjoni shembuj nga materiali instrumental që regjistruan kërkuesit e grupit: A.7.2, 3, 7, 8, 9, 10, 11.

- Mund të dallosh veglat që dëgjohen?
- Kërko ndihmën e mësuesit ose të mësueses suaj për veglat që nuk dallon.
- Cilat nga këto ke takuar në përallën «Petros dhe ujku»?

Etnomuzikologji veglat ndahen në katër kategori të mëdha: idiofone, membranofone, aerofone, kordofone. Shkruani në shtyllën e duhur secilën nga veglat që dallon në pjesët e mësipërme instrumentale::

idiofone ..........................................................

membranofone ..........................................................

aerofone ..........................................................

kordofone ..........................................................

5. Muzika është një nga shtatë artet dhe llojet e saj janë të shumta. Çdo kohë dhe çdo popull gjen mënyra të ndryshme të shprehet nëpërmjet muzikës. Si fillim,mund të ndajmë muzikën  në dy kategori shumë të mëdha: në klasiken dhe popullorentradicioinale:

- Përpiquni të përshkruani me gojë secilën nga këto kategori.
- Dëgjoni të dy shembujt muzikorë: Nga «karnavali i kafshëve» pjesën e palloit, dhe këngën «Ju zogj fluturues».
- Cilën do të karakterizoje si vepër klasike dhe cilën të muzikës tradicionale?



6. Muzika tradicionale është mënyrë shprehjeje e çdo populli dhe e çdo zone. Kështu, tjetër është muzika tradicionale e Greqisë, tjetër e Spanjës, tjetër e Italisë, tjetër e Kinës etj. Dëgjoni pjesët e mëposhtme të muzikës tradicionale dhe i vendosni në hartë në zonën përkatëse. Kështu do të krijojmë një hartë etnomuzikologjike.

- Mos takove pjesë tradicionale që të kanë ngatërruar dhe beson se shkojnë në më shumë se një vend?
- Cilat janë këto?
- Ç'konkluzione do të nxirrnim  për muzikën tradicionale të dy popujve?

7. Korrespodo numrat që shikon në hartën e vendit me Parqet e tjera Kombëtare, si dhe të Parqeve Kombëtare që njeh.



**Parqe Kombëtare në Greqi:**

**1.** Parku Kombëtar i Prespës,

**2.** Parku Kombëtar i Vikut-Vjosës,

**3.** Parku Kombëtar i Olimpit,

**4.** Parku Kombëtar i Pindit,

**5.** Parku Kombëtar i Itit,

**6.** Parku Kombëtar i Parnasos,

**7.** Parku Kombëtar i Enos,

**8.** Parku Bregdetar i Zakinthos,

**9.** Parku Bregdetar i Allonisos,

**10.** Parku Kombëtar i Skinjas,

**11.** Parku Kombëtar i Parnithës,,

**12.** Parku Kombëtar i Sunios,

**13.** Parku Kombëtar i Samarias.



**Parqe Kombëtare në Shqipëri:**

1. Parku Kombëtar i Dajtit,
2. Parku Kombëtar i Thethit,
3. Parku Kombëtar i Lurës,
4. Parku Kombëtar i Llogarasë,
5. Parku Kombëtar i Butrindit,
6. Parku Kombëtar i Prespës.

8. Jepet një varg nga organizata mjedisore që aktivizohen në territorin grek dhe shqiptar. Ndahuni në grupe dhe vizitoni vendet e internetit të organizatave dhe lajmëroni klasën për qëllimet dhe veprimtaritë e tyre.Krijoni tablo me fotografi, tekste, piktura etj që të jepet figura e çdo organizate. Tablotë do të vendosen në vende të përdorimit të përbashkët të shkollës.

Aktiviteti Organizata që aktivizohen në territorin grek

- Greenpeace (http://www.greenpeace.org)
- WWF Hellas (http://www.wwf.gr/)
- Shoqatë Ornitologjike Greke (http://www.ornithologiki.gr)

- ANIMA, Shoqata e Mbrojtjes dhe e mjekimit të Jetës së Egër. (http://www.wild-anima.gr)
- Arkturos (http://www.arcturos.gr)
- Kalisto (http://www.callisto.gr)
- QGMKE, Qendër Greke e Mjekimit të Kafshëve të Egër (http://www.ekpazp.gr)
- Shoqata e mbrojtjes të Prespës (http://www.spp.gr)

Organizata që aktivizohen në territorin shqiptar.

- Organizata Dora e bardhë. Dora e bardhë,organizatë për mbrojtjen e mjedisit. Që përpiqet të sensibilizojë shqiptarët për të ndihmuar në zgjidhjet e problemeve të mjedisit.
- http://www.eden-alb.org
- www.tipplers.org
- Ekolëvizja (http://sq.oneworldsee.org/article/view/126420/1/)

9. Dëgjoni këngët: E.4.5. «Kur niset shqiponja», A.15.8-9. «Zura një thëllëzë».

QGMKE (ΕΚΠΑΖ) ju fton të adoptoni një kafshë të vogël. Më poshtë mund të lexoni informata lidhur me procedurën e adoptimit. Këtë geraqinë para se të arrijë në QGMKE (Ε.Κ.Π.Α.Ζ) e mbanin në mënyrë të paligjshme në robëri. Tani e kanë adoptuar nxënësit e klasës së dytë, të tretë, të katërt të shkollës fillore Ag. Paraskevis-Neofrakti të Dramës.

Dëgjoni këngët: E.10.11. «Bilbili», E.10.13. «Drenushe», A 15.13. «Këndojnë gjashtë bilbila», Shikojmë dokumentarin për kafshët që kemi zgjedhur.





Adoptoni një kafshë të egër dhe merrni:

1) një çertificatë adoptimi
2) fotografi dhe të reja nga kafsha juaj
3) ftesë për lirimin e saj.

Adoptimi është një veprim simbolik nëpërmjet të cilit do të ndihmoni një kafshë të egër nga hyrja deri në lirimin e saj. Do të ndihmoni tek ilaçet që do të duhen në krijimin e ambietit të saj në mjekimin dhe në lirimit e saj. Zgjidhni tani duke shkruar në ekpaz@ekpazp.gr llojin që ju intereson dhe ne do t'ju informojmë menjëherë se cilat janë të lira për adoptim. Në qoftë se kafsha është gati për lirim, përderisa e dëshironi, mund të gjendeni në lirimin e saj që do të bëhet në biotop të përshtatshëm.
Mund të ndihmoni për një kohë të caktuar një kafshë konkrete që ka problem dhe do të qendrojë për gjithë jetën e saj afër nesh. Kafshë të tilla janë të shumta, si Miko Rakun një lloj amerikan që hyri ilegal në Greqi dhe nuk mund të kthehet në atdheun e saj. Gjyshi, majmuni nga Amazona që mbushi 25 vjeç, kormoranos i verbër dhe të tjera që do të shihni në katalogun që vijon. Na shkruani për të mësuar për historitë e tyre. Nëse nuk ju intereson asnjë nga këto që po vijojnë pyesni! Ekzistojnë dhe të tjera...
Pajtimet për adoptimin mund të bëhen: në llogarinë tonë në Bankën Kombëtare Greke: 241/ 9601688 ose në përmjet internetit www.paypal.com për email: ekpaz@ekpazp.gr
Çmimi I adptimit është 50 evro për çdo kafshë për një vit.
http://www.ekpazp.gr/multi/index.php?option=com_content&task=view&id=17&Itemid=3

10. Ariu i murmë është një kafshë që gjëndet dhe në të dyja vendet. Është kafshë që kërcenohet me zhdukje. Me pretekst tekstin dhe fotografitë bëhet diskutimi në klasë për arushën. Përgatitni një punim për arin e murmë të Pindit. Ndahuni në grupe dhe merruni me:

- Imitimet e ariun nga njeriu (enë, filma, përralla, fabula, piktura etj.)
- Biologjia-Ekologjia (karakteristika, sjellje, zakone ushqimore, riprodhimi, elemente të mjedisit).
- Rreziqe.
- Aktivitete të njerëzve për jetësën e tij.

11. Dëgjoni këngë: A.15.8-9. «Zura një thëllëzë». Kjo këngë këndohet në fejesë ose në dasmë dhe thëllëza simbolizon nusen. Fatkeqësisht shumë kafshë dhe zogj kapen nga tregtarë të paligjshëm për t'u shitur. Numri i kafshëve që janë viktima të njerëzve të tillë gjithmonë numri shtohet. Sipas kërkimeve të fundit, vitet e fundit tregtimi i paligjshëm te kafshëve ka marrë përmasa të mëdha: në këtë kohë është operacion i tretë i paligjshëm në botë, pas tregtimit të drogës dhe të armëve. (gazeta «Erevnites», v. 200, f. 6-7)

- Përse ekziston tregtimi i paligjshëm i kafshëve?
- Shumë njerëz duan të kenë në shtëpinë e tyre kafshë që nuk konsiderohen shtëpiake (gjarpërinj, papagallë, majmunë etj.).



Një arushë që u përpoq të arrijë në një fushë me grurë bashkë me të voglin e saj u plagosë rëndë nga makinat që vinin kur kaloi një gardh të përkulur. Arusha, në përpjekjen e saj për të shpëtuar të voglin, që ishte mbetur pas dhe pasi ishte plagosur një herë nga makina nuk u përpoq të ikte, por vazhdoi rrugën e saj,rrugën drejt të voglit të saj, me rezultat të qëllohet përsëri nga e njëjta makinë,që përpiqej ta shmangte me dredha.
Pasi kafsha e plagosur u narkos mga veterineri i grupit «Kalisto», u soll në qendrën veterinere të mjekimit të kafshëve të egra të Arkturos, në Aeto të Florinës, por siç theksohet në shpalljen përkatëse «e ardhmja e kafshës nuk është e sigurtë, si edhe të voglit të saj, që mbetet pa nënën e tij».

http://www.in.gr/news/article.asp?lngEntityID=909834

- Ndoshta me blerjen e kafshëve të tilla marrim pjesë dhe ne në tregtinë e paligjshmë?
- Nëse këto kafshë do të kishin mundësi të flisnin ç'do të thoshnin? Shkruani një intervistë fantastike për një kafshë që u largua nga biotopi i saj dhe jeton në një shtëpi.

### 12. «Por mirë, e kanë humbur fare?» (Gazeta «Erevnites», v.349, f. 7)



Natyrisht shprehja s'u referohet kafshëve të mjera, por njerëzve që i detyrojnë të vishen me «modën për kafshët». Besoni se kafshët kanë mundësi të zgjedhin veshjet për vallet dhe sportet që bëjnë? Diskutoni në klasën tuaj rreth fotografive dhe shprehni pikpamjen tuaj për «të drejtat e kafshëve».

- Keni vërrejtur apo keni dëgjuar për sjellje të tilla tek kafshët e zonës suaj?
- Cili është mendimi juaj?
- Ç' masa duhet të merren? Propozoni zgjidhje.

### 13. Pastroj ekologjikisht me bimë dhe materiale nga natyra.

Kush tha se limoni bëhet vetëm limonadë dhe i jep shije gjellës? Nuk kaluan shumë vite qysh atëhere kur banorët e dy vendeve pastronin ekologjikisht! Përdornin lëngun e një limoni për kripërat, uthullën për pastrimin e qilimave etj. Pyesni më të rriturit ose kërkoni në libra dhe në intrenet, për të grumbulluar këshilla për «pastrimin ekologjik». Informatat që do të grumbulloni t'i dërgoni dhe në shkollën që bashkëpunoni dhe të krijoni një libër të përbashkët me këshilla. Sigurisht do të jetë një libër shumë i vlefshëm për çdo shtëpi dhe për mjedisin, sepse do të përkufizojë përdorimin të mjeteve moderne për pasrtrim që jo vetëm pastrojnë, por edhe infektojnë!

14. Zjarri nuk njeh kufij.

Ftoni në klasë një zjarrfikës pylli për t'ju sjellë përvojën nga shuarja e zjarrit. Diskutoni për pasojat e zjarrit në shëndetin, ekonominë, mjedisin etj.

*Vazhdon shkatërrimi i Amarandos (28.07.07)*
*Po të përjashtojmë Amarandon, pamjet që kishim dje nga zjarret në gjithë Epirin ishin të përmirësuara në lidhje me ditët e mëparshme, si dhe të gjitha frontet ishin në ulje dhe nën kontroll. Optimisht është gjithashtu se gjendja në Shqipëri përmirësohet dhe kështu pakësohet rreziku për zjarret e «importuara».*
*Në Amarando zjarri vazhdon shtatë ditë rresht veprën e tij shkatërruese dhe janë djegur 1200 dynyme pylli.Vendi përreth banjave shërruese është i shkretë dhe kërcenohet shumë herë nga kahu i erës. Gjatë gjithë kohës vendbanimi kërcënohej shumë herë dhe përsëri rreziku largohej. Gjatë gjithë kësaj kohe kjo është përpjekja e madhe e forcave zjarrfikëse,për të mbrojtur vendbanimin përderisa brenda në pyllin e ndezur nuk është e mundur të afrohen forcat tokësore. Nga njëra anë pjesa e pakalueshme dhe e thepisur dhe nga ana tjetër shpërthime të vazhdeushme në vendet e minuara dhe nga predhat e luftës civile shkaktojnë rrëzikshmëri afrimin në të. Fakti se në të gjitha frontet në zonat e tjera janë në ulje, lejoi dje forcat zjarrfikëse të hedhin gjithë peshën në Amarando në një përpjekje për të kufizuar zjarrin, por nuk dihet sa do të mbajë kjo «dhuratë» që bëri Epiri tjetër tek Amarando.*
*Gjendja e njerëzve është tragjike që jetesa ekonomike varet nga funksioni i banjave shërruese. Kanë mbi një javë që jetojnë me frikën se mos bëhen pluhur pronat e tyre dhe njëkohësisht demi ekonomik që kanë pësuar është shumë i madh. Hotelet mbetën bosh dhe sezoni për to*

Në të gjithë popujt ekzistojnë fabula dhe tradita për bimët dhe kafshët (historia e Narkisos,ariu i madh dhe i vogël etj.) Kërkoni fabula dhe përralla për të paraqitur në shfaqjen e vitit me veprime teatrale dhe lojëra.



Nxënësit mund të marrin pjesë në mbjelljen e pemëve në zonën e tyre.

Në faqen WWF (http://www.wwf.gr/footprint) mund të gjejmë shënjën tonë energjitike, dmth sa dioksid karboni ($CO_2$) lëshojnë në atmosferë shprehitë tona të përditshme, që lidhen me shpenzimet energjike. Ndiqni shigjetat që ju çojnë nga dhoma në dhomë dhe «bëni klik» mbi duart që shfaqen në aparatet e ndryshme. Në fund do të keni si shembull një figurë që tregon sa energji shpenzuat dhe sa rrezatime $CO_2$ i korrespodon këtj shpenzimi. Gjithashtu do të shihni këshilla se si mund t'i shmangeni një pjese të rrezatimeve $CO_2$ dhe njëkohësisht të përfitoni energji dhe para.

*mbaroi para se të fillojë. Si thonë vetë,banjat punojnë në një periudhë dhe kjo periudhë u shkatërrua. Dhe zjarri është vetëm fillimi. Sapo të mbarojë lufta me zjarrin duhet të niset menjëherë një luftë tjetër me kohën, sepse është e nevojshme të ndërtohen vepra kundër përmbytjeve, para se të fillojnë shirat që në zonën malore janë të shpeshta dhe të forta qysh në vjeshtë. Me pastrimin e malit nëse nuk ndërtohet në kohë veprat kundër përmbytjeve një katastrofë e re kërcënon vendbanimin.*

*Zjarret e tjera. Si përmendëm më lartë në Epirin tjetër kishim një ulje të zjarrit. Nën kontrollin e pjesshëm është vënë mbasdite zjarri në Bashkinë Mastorohorion që digjte qysh më 24 korrik. Zjarri «hyri» nga Shqipëria dhe kishte djegur deri në këtë kohë 100 dynyme (50 dynyme pylli dhe 50 dynyme livadhesh).*

*(http://www.neoiagones.gr/index.php?option=com_content@task=view@id=1221@myarchive=2007)*

15. Dëgjoni këngë: E.14.7. «Pesë rrape». Çdo vit digjen mijëra dynyme pylli. Ndiqni videon (pylli) dhe imagjinoni si do të jetë zona juaj pas 100 vjetësh, nëse vazhdon shkatërrimi dhe mosinteresimi. Shkruani mendimet tuaja dhe pikturoni.

# uji na fletë

1 2 3



Uji është jetë!

Element i domosdohëm për jetën e të gjithë njerëzve, por për çdo formë jete që ekzi ston në tokën tonë.

Banorët e dy zonave kuptuan vlerën që ka për ekzistencën e tyre uji dhe e kënduan! Si mos ta bënjë, kur Vjosa, lumi i dy zonave, është ai që me ujërat e tij i freskon, u fal çaste gëzimi, jep jetë në zonën e tyre, ujit arat e tyre dhe ndihmon në zhvillimin kulturor të zonës së tyre?



Le të udhëtojmë nëpër ujërat e tij dhe të këndojmë të gjithë bashkë. Elemente të domosdoshme që duhet të marrim me vete për udhëtimin është respekti dhe dashuria për lumin që na bashkon.




© Googlemaps

1. Vështroni me kujdes hartën. Duke ndjekur lumin Vjosa, përpiquni të dalloni nga cilat krahina, nga cilat fshatra, por dhe nga cilat shtete kalon.

- Nga cili vend niset dhe në cilin det derdhet.
- Ka të njëjtin emër gjatë gjithë rrugës, së tij?
- Shkruani në vendet boshe të dy emrat e lumit, sipas vendit në të cilin ndodhet.

SHQIPERIA........................................ GREQIA..............................................

2. Dëgjoni me kujdes të dyja pjesët.

- Mund të dalloni veglat që dëgjoni?
- Janë të shpejta apo të ngadalta?
- Ekzistojnë zëra që këndojnë apo melodia dëgjohet vetëm nga veglat?
- Mund të dalloni nga cili vend vjen çdo këngë?
- Në shtyllat e mëposhtme gjeni të dhënat e përbashkëta që ekzistojnë midis muzikës së të dy vendeve:

| shqip | greqisht |
| --- | --- |
| .................................................. | .................................................. |
| .................................................. | .................................................. |
| .................................................. | .................................................. |

Nga të dyja veprimtaritë mund të gjejmë, deri tani, dy të dhëna të përbashkëta bazë për të dyja shtetet fqinje. Plotësoni fjalitë e mëposhtme me fjalët e duhura që janë në kllapa.




3. Dëgjoni me kujdes të dyja pjesët: E.13.6 «O Zot, hidh një shi» dhe A.5.11. «Shkove për një apo jo».

***O Zot, hidh një shi***
*O Zot, hidh një shi,*
*një shi shumë të mirë*
*që të rriten grunjtë*
*elbi ynë i mirë*

**Shkove për një apo jo**

*Shkove për ujë apo jo.*
*Llambadhe, moj llambadhe.*
*Unë shkova, nuk me pe*
*llamadhe moj llambadhe.*
*Birin tonë do të martojmë,*
*do të vish dhe ti me ne*
*të marrim ujë në burim*
*ta bëjmë dhëndër*
*llambadhe, moj llambadhe*

- Mund të dallosh nga cili vend është çdo këngë?
- Nga e kupton?
- Po të mos ishin fjalët, mund ta dallojë me të njëjtën lehtësi?

Le të merremi pak me përmbajtjen e dy këngëve.

- Për ç' arsye është i nevojshëm uji në këngën e parë dhe për ç' arsye tek i dyti?
- Tek kënga e dytë uji është i lidhur me një zakon dasme. Mund të kërkoni dhe zakone të tjera, në të cilat është i domosdoshën uji?

4. Dëgjoni këngët: E.13.6. «O Zot, hidh një shi» dhe A.11.20. «Një ujë zonja Vangjelo».
Le të dëgjojmë edhe një herë këngën «O Zot, hidh një shi».

Uji është i domosdoshëm për kultivimet dhe jo vetëm.
Por, si, arrin uji tek ne?

Le të flasim pak për ciklin e ujit. Uji mbulon më shumë se ¾ të tokës. Mund të gjesh ku e takojmë ujin në tokë?

TUji udhëton vazhdimisht. Nga detet dhe lumenjtë arrin në atmosferë dhe vjen përsëri në tokë me formën e shiut ose të borës.

Cila forcë është ajo që bën ujin të udhëtojë vazhdimisht.

Natyrisht, dielli.

Me rrezatimin diellor, ujërat që janë në sipërfaqen e detit avullohen dhe ngjiten në atmosferë. Atje vijnë në kontakt me shtresa të ftohta ajri dhe **lëngëzohen** përsëri, kështu kthehen në tokë në formë shin, bore ose breshëri. Uji që bie në tokë, kalon tek nëntoka dhe arrin përsëri në det. Kështu uji qarkullon, duke **udhëtuar** vazhdimisht nga toka në atmosferë.

Vizatoni ciklin e ujit, si e imagjnoni ju.

5. Po të përpiqeshit të paraqitnit në mënyrë muzikore ciklin e ujit si mund ta bënit? Le të fillojmë. Duhet të ndaheni në tri grupe.



**Grupë 1:** Uji në sipërfaqen e tokës.
Një grup do të marrë përsipër të bëjë tingullin e ujit, kur ai është në sipërfaqen e tokës.

- Si dëgjohet vallë deti? Lumi? Liqenet?
- Cilët nga të tre ju duket më i qetë?
- Tingulli është gjithnjë i njëjtë?
- Si është tingulli i detit të qetë dhe si i detit të dallgëzuar?
- Lumi është vallë kudo i njëjtë apo si pas vendeve uji rrjedh i vrullshëm apo i qetë?
- Si janë këta tinguj?
- Mund të imagjinoni me ç' mënyrë mund të prodhoni të gjithë ata tinguj të ndryshhëm të ujit? Keni në dispozicionin tuaj pjesët e trupit tuaj, me të cilin mund të prodhoni sa tinguj doni, sipas mënyrës që do ta përdorni dhe diçka tjetër që mund rë imagjinoni, si fletë letre, pjesë stofi etj.



**Grupë 2:** Uji avullohet.
Pamë se uji me rrezatimin diellor avullohet dhe ngjitet në atmosferë.

- Si dëgjohet vallë era?
- Ikën gjithmonë me të njëntën shpejtësi?
- Si dëgjohet puhiza? Era e fortë? Tufani?





- Mund të imagjinoni me ç'mënyra mund të prodhoni të gjithë këta tinguj të ndryshën të erës? Përveç trupit tuaj mund të vlerësoni dhe materiale të tjera, si fletë letre, shishe ku mund të fryni brenda në to, por edhe diçka tjetër që mund të prodhoni tingujt që doni.

**Grupë 3:** Uji kthehet në tokë.
Erdhi ora e kthimit të ujit në tokë në formë shiu, bore, breshëri.

- Cili nga këta ka tingullin më të fortë?
- Sa tinguj të ndryshëm mund të ketë shiu?
- Si dëgjohet shiu i imët? Shiu i qetë? Furtuna?
- Duke u bazuar në imagjinatën tuaj përpiquni të prodhoni sa më shumë tinguj keni mundësi, për të dhënë fenomenet e natyrës që doni.

Uji në gjuhë të ndryshme.
Formoni një listë me fjalën «ujë» në ato gjuhë ku mund ta gjeni. Ngjajnë fjalët midis tyre?
Mitilogjia e ujit. Bëni një antologji të vogël me fabula rreth ujit.



6. Bëni afishen më të gjallë duke vënë materialet përkatëse në vend të fotografive.




*Afishen nga programi të Helmepa «Detet të pastër dhe brigjet të pastër».*
*http://www.helmepa.gr*

7. E.13.6. «O Zot, hidh një shi»

Thatësira shpesh mundon tokën dhe njerëzit, prandaj njerëzit i referohen zotit për t'i ndihmuar. Këtë e takojmë në popuj të ndryshëm. Kërkoni të gjeni me ç' mënyrë njerëzit në kultura të ndryshme bëjnë diçka të tillë. Mblidhni informacione për zakonin e pirpirunës në Greqi dhe për vallen e shiut në Shqipëri. I jetoni, duke u përpjekur t'i përfytyrou këto zakone.

**Mënyra provokimi të shiut për frytëzimin e të mbjellave dhe barërave në Epir.**

Pirpiruna

Në maj ose qershor, kur qëllon të jetë thatësirë(nuk bie shi) për t'u rritur të mbjellat dhe barërat, vajzat e moshës 10-14 vjeçe mblidhen dhe veshin një vajzë të varfër, që të jetojnë prindërit e saj, me rroba të vjetra të gjata dhe me gjethe mbi to. Mbi thesin qepin shami të gjera (gjethe të gjera të trasha, të gjelbra si fletë Kungulli). Vendosin një magje ose tenxhere në kokë së prapthi për të mos u lagur dhe kështu nuk duket fytyra e saj dhe trupi.

E bëjnë Pirpirunë si e quajmë dhe kthehen në shtëpi zbathur, duke kënduar. Ajo kërcen sipas ritmit të këngës:

Pirpirunë që ecën, lutu Zotit që të hedh shi,
një shi shumë të mirë, që të rriten grunjtë, barërat
dhe qepujkat e plakës (farë qepe).

Çdo amvisë, sapo mbarojnë këngën hedh ujë me kanën mbi kokën e saj dhe uji bie si shi. Ajo shkundet tri herë dhe e gostisin para dhe miell, që i mbledh vajza tjetër.

Sapo mbarojnë, mblidhen në shtëpinë e pirpirunës, e çarmatosin, i japin asaj miellin, numërojnë paratë, nga të cilat një pjësë e disponojnë për të blerë vaj dhe qirinj dhe ato që mbetën, i ndajnë, por më të shumtat ia japin Pirpirunës. Pastaj

shkojnë në kishë, ndezin kandilin dhe qirinjtë dhe i luten Zotit, shën Mërisë, Shën Nikollës dhe gjithë shënjtorëve që të bjerë shi.

### Litani

Nëse nuk bie shi, atëherë bëhet ***litania*** (lutje), nga të gjithë banorët dhe priftin, që i lajmëron një ditë më parë dhe ditën tjetër mblidhen të gjithë të vëgjel e të mëdhenj në oborrin e kishës qendrore. Prifti dërgon në mëngjes herët dy fëmijë që t'i sjellin ikonën çudibërëse të Shën Mërisë së. Madhe nga Manastiri ynë, që janë dhe dy të vogla. E presin të gjithë tek Shën Thanasi, me devocion dhe me madhështi bizantine, duke mbajtur në duart qirinj dhe llambadhe të ndezura.

Paraprin  prifti i veshur shkëlqyer, duke bërë lutje dhe falje Zotit dhe e ndjekin tre fëmijë të veshur me rroba kishtare, duke mbajtur nga një eksapterigë. Tre fëmijë të tjerë më të mëdhenj,duke mbajtur flamurin dhe fener thonë trishtuar, ritmikisht gjatë gjithë rrugës «Zoti na ndihmoftë»... Pas tyre vijnë banorët kambana vazhdimisht bie trishtueshëm.

Kur mbërrin ikona e Shën Thanasit, i afrohen, bëjnë, kryqin të gjithë. Gjunjëzohen, bëjnë pendesa dhe e puthin. Shë Mërinë dhe lutjet për Atë, ndalojnë të keqen. Litani e tillë bëhet dhe në rrethana të jashtëza-konshme (epidemi = sëmundje të njerëzve dhe të kafshëve) në fatkeqësitë e natyrës (termite, shtrëngata, etj.) dhe në karkalecat.

Të gjitha këto kanë lidhje me ceremonitëe misterëve të Elevsinasve që janë Zakone shumë të vjetra. (Burim: http://www.fourka.gr)

**Në Shqipërinë e Jugut.**

### Vallja e shihut

Luhet në natyrë dhe nga burrat. Dordolec bëhet një djalë, të cilin e mbulojnë me gjethe. Grupi i burrave vendoset qark i zënë për dore. Këta këndojnë dhe ngacmojnë

Dordolecin, ndërsa dy gra rrinë gati-njëra ka një kovë me ujë, kurse tjetra një tepsi me kuleçë. Kënga e kënduar nga valltarët dhe pa instumenta muzikore, thotë:

Dordolec, bjerna shi, të na bëhet misri i ri,

mistri i ri sa trari, të na mbusehet hambari.

Në fund Dordolecit i hidhet kova e ujit dhe gostitet me kuleçë.

Krahasoni zakonin e pirpirunës dhe vallen e shiut që ekzistojne në të dyja krahinat. Por edhe në krahina të tjera të botës ekzistojnë zakone të ngjashme.

A.11.9. «Burimi i Gusharës».
Kërkoni informata dhe fotografi nga e kaluara për të parë me ç' mënyrë furnizohen me ujë fshatrat në të dyja vendet.

A.11.7-8. «Eja, Maro, tek burimi».
Burimet dhe puset tek sheshi i fshatit ishin vend takimi dhe njohjeje në të dyja vendet. Nxënësit pyesin të mëdhenjtë ose kërkojnë informacione në libra ose në internet për të vërtetuar këtë pikpamje.

http://www.fourka.gr
Në «faqe internet» të fshatit Furka, fshat në Janinë ekzistojnë shumë doke dhe zakone të krahinës. Mund ta vizitoni. Studioni zakonet e dy krahinave. Ndani rolet dhe përpiquni të gjalleroni me dramatizim zakonet e mësipërme.



8. Çfarë mund të bëjnë nxënësit e të dy krahinave për t'u shmangur shpërdorimit të ujit? Më shumë nga sa mund të imagijinoni!

Përgatitni një formular që do të ketë propozime për bashkëqytetarët tuaj për pakësimin e shpërdorimit të ujit me titull: «Pse e lë të shkojë dëm?».

9. Ndiqni në hartë ose me google earth ecurinë e Vjosës.
Diskutoni në klasë:

- Nga buron? Ku derdhet?
- Morfologjinë e tokës.
- Faunën rreth lumit.
- Peshqit dhe bimët që jetojnë dhe rriten brenda ose rreth Vjosës.
- Si ndikon në aktivitetet njerëzore të dy vendeve.

10. Problemi i mungesës dhe i ndotjes së ujërave bën të merren me të edhe poetet. Lexoni vjershën e mëposhtme.

Imagjinoni ç' farë do të ndodh, nësë për një arsye Vjosa humbet "j" e saj, domethënë do të ndalojnë ujërat e saj të rrjedhin.

**Ndihmë**

*Popo, çfarë ka ndodhur?*
*Nga uji ka ikur shkronja "j"*
*Duket se ka avulluar.*
*Me ketë të re, pa më thuaj?*
*Çfarë do të bënte dikush?*
*As anija lundron aty brenda*
*as mund të lahesh,*
*as mulliri nuk rrotullohet*
*as peshqit gjejnë ushqim*
*dhe ekziston dhe diçka e rëndëshishme:*
*Këtë të re mund ta pish?*
*Nuk është e pishme, e pastër*
*e kristaltë dhe e freskët.*
*Doni t' ju them ç' është?*
*Është uji i thatë,i thatë.*
*Thërrisni kryetarin e bashkisë,*
*Kryetarin, gjykatësin.*
*Çfarë do të bëjmë së fundi*
*pa ujë, pa burim?*
*Ja, do t'i japim*
*«j» e tij*
*dhe ai do të rrjedh menjëherë.*

*Xhani Rodari*

- Pasojat do të jenë të njëjta në të dyja vendet? Flisni për ndotjen e ujërave dhe propozoni zgjidhje, që të mbeten ujërat e Vjosës të kthjellëta dhe gurgulluese.

11. Lumenjtë bashkojnë, por mund të përbëjnë dhe shkaqe përplasjeje. Vjosa buron nga Greqia dhe derdhet në Shqipëri.

- Çfarë do të ndodhte nëse Greqia vendoste të përdorte ujërat e lumit, duke qenë indiferente për nevojat e Shqipërisë?
- Mund të përbënte kjo gjë shkak grindjeje midis dy vendeve dhe për shumë arsye?
- Mund të propozoni zgjidhje për t'u shmangur një koflikti të tillë?
- Ekzistojnë krahina nëpër botë ku uji përbën vatra konflikti?

12. Çfarë fal Vjosa në të dyja vendet? Shkruani brenda në pikat çfarë na ofron lumi. Mbi pikën shkruani fjalën stërvitje. Bëni pesë pika.



13. Drejtoni çdo kafshë në ushqimin e saj:















14. Proverbat dhe shprehjet e mëposhtme, që përmbajnë fjalën ujë, përdoren dhe nga të dyja anët e kufijve. Ç' duan të thonë? Shkruani shpjegimet dhe kërkoni dhe të tjera.

E solli në ujërat e tij. ..........................................................................

..........................................................................................................

Bëri nje vrimë në ujë. ..........................................................................

..........................................................................................................

Vuri ujin tek përroi. ..........................................................................

..........................................................................................................

Transporton ujë me shosh. ..........................................................................

..........................................................................................................

Uji i mbetur ndotet. ..........................................................................

..........................................................................................................

Do të themi ujin ujë. ..........................................................................

..........................................................................................................

U mbyt në një pikë uji. ..........................................................................

..........................................................................................................

Nje pikë në çati prish gjithë shtëpinë. ..........................................................................

..........................................................................................................

«Mbani Vjosën të pastër»

Në kuadrin e një ekspedite për të mbrojtur Vjosën krijoni një afishë informuese.

Flora dhe fauna në krahinën e Vjosës janë shumë të pasura. Shkruani llojet e florës e të faunës të vendit tuaj dhe i krahasoni me të dhënat e anës tjetës të kufijve.

Krijoni një hartë eniologjike të lumit, duke vënë figura të kafshëve e të bimëve karakteristike.



15. Lexoni artikullin e gazetës për Prespën e Vogël. Prespa e Vogël Burim: ΑΠΕ-ΜΠΕ «Ta Nea» (http://www.acrobase.gr/showthreaol.php?t371) u takon të dyja vendeve. Vazhdimi i jetës është temë e përbashkët dhe zgjidhjet duhet të jenë të përbashkëta. Me shkollën që bashkëpunoni, shkruani një vendim të përbashkët me mendime dhe propozime për mbrojtjen e saj dhe e dërgoni në autoritetet e vendit tuaj.

**Me zhdukje kërcenohet Prespa e Vogël.**

Me tharje të përgjithshme kërcenohet Prespa e Vogël në anën shqiptare, nëse vazhdon përdorimi i ujit të saj për ujitje të Korçës, gjë që rezulton nga studimi i parë i përbashkët Greqi-Shqipëri për sistemin ujor të Prespës së Vogël dhe të lumit Devoll.
Devijimi i lumit Devoll në mes të viteve 1970 në Prespën e Vogël ka nënvlerësuar në një masë të madhe skajin jugor të pjesës shqiptare të liqenit, konkludon studimi. Me tharjen e liqenit u zgjerua në mënyrë dramatike bimësia ujore dhe kallamishtet dhe ndryshuan karakterin ekologjik dhe funksionet e zonës. Pasojat ekonomike dhe mjedisore janë serioze për shoqërinë vendase të Shkqipërisë, e cila vuan nga emirgimi masiv dhe nga humbje të burimeve jetësore, vë në dukje studimi, të cilin e përpiluan shoqatat joqeveritare për mjedisin Shoqata e Mbrojtjes për liqenet e Prespës dhe Shoqata për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Natyror të Shqipërisë, me bashkëfinancim të Shërbimit Ndërkombetar të zhvillimit dhe Bashkëpunimit të Ministrisë së Jashtme dhe të WWF të Greqisë.
Megjithatë që llimi i autoriteteve kopotente të ujërave të Shqipërisë, siç u duk në takimet e tyre me studiuesit e programit qe i referohet komunikatës së Shoqatës për Mbojtjen e liqeneve te Prespës, është të mos përdorin në të ardhmen liqenin se depozitë për ujitjen e fushës së Korçës, por të shtyjnë vlerësimin e potencialit mjedisor të zonës.
Shkencëtarët konkluduan se për t'u shmangur pasojave që kanë shkaktuar ndërhyrjet dekadave të fundit, duhet të studjohen masa të mëtejshme konkrete të rimëkëmbjes së mjedisit dhe të administrimit të tij.

16. Lexoni historinë që vijon. Historia përshkruan peripecitë e fkit ujës dhe të fëmijëve të klasës pastë të shkollës fillore në Janinë (viti shkollor 2005-2006). të gjithë bashkë ndihmuan lumin Vjosë të shëtojë nga shopëria e mbeturinave. Kur ta lexoni, të shkruani dhe ju një shpëtim fantastik të lumit Vjosë nga fëmijët e klasës suaj.

## Akis Ujës
## dhe shpëtimi i lumit Vjosë




Zakonisht pikat e një burimi nuk kanë emër.
Kjo është një pikë shumë e veçantë.
Këtë pikë e quanin Akis Ujës.

Një ditë Vjosa, babai i Akit Ujës, u sëmur rëndë. Kishte ngrënë 1000 teneqe të vogla, 2000 qese plastike, shishe uji, shishe për pije freskuese dhe kimikë të panumërt.







U mendua çfarë do të ndodhte tani që u sëmur babai i tij! U mendua për njerëzit dhe për fëmijët që nuk do të mundin më të freskohen duke pirë një gotë ujë! U mendua për kafshët dhe për bimët që rrëzikonin të zhdukeshin, po të pinin ujërat e tij!

Kaq shekuj të gjithë pinin ujë në emrin e tij dhe tani? Asnjëri nuk i afrohej! Të gjithë u trembën! Sapo e mësoi këtë Akis Ujës, vendosi të shkojë ta ndihmojë. Rruga ishte e madhe dhe Akis Ujës ishte dëshpëruar. Si ky, një pikë e vogël uji, do të mundte të arrinte deri tek babai i tij, pa u humbur?

## RULA FILTRULA



Dhe atje që besonte se nuk do t'ia arrinte qëllimit vetëm, dëgjoi nga pas tij një zë t'i thotë: «Mirëmëngjes, Akis Ujës. Jam Rula Filtrula dhe erdha të të ndihmoj.»



«Mësova se ke problem me babanë tënd, Vjosën, dhe erdha të të ndihmoj. Pas meje vijnë shumë fëmijë, që jetojnë në krahina afër lumit dhe në të dyja vendet e kufijve. Sapo dëgjuan për babanë e sëmurë, vrapuan të ndihmojnë».

Akis Ujës u gëzua shumë, kur i pa. Tani më nuk ishte vetëm. «Ju falenderoj shumë që erdhët», u tha, «por duhet të dini se misioni ynë është i vështirë. Nuk duhet të humbim kohë!».



Kur arritën afër lumit, panë Arin e ndyrë, Kikinë e Kimisë, Toton Fshesar dhe shumë mbeturina të ndotin Vjosën.



Shoqëria e mbeturinave flakte çdo lloj mbeturinash. Mishra të kalbura, djathëra të mykura, shishe, teneqe të vogla, lëvozhga banane, plastikë, gota, të gjitha ishin atje. Të gjitha këto nuk mjaftonin dhe fabrikat e Kikisë së Kimisë mbushin lumin freskues me mbeturina!

«Sa neveri!!!», tha Akis Ujës, «babai im rrezikohet në të vërtetë! Kam frikë se është vonë dhe nuk do t'ia arrijmë qëllimit më në fund ta shpëtojmë...».
«Mos u shqetëso», thirrën fëmijët, «jemi shumë dhe sigurisht të bashkuar do t'ia arrijmë qëllimit!».





«Le të rrëshqasim për t'i befasuar!», propozoi Rula Filtrula. Vrapuan, pra, dhe u fshehën pas disa shkëmbinjve të mëdhenj, që gjendeshin aty afër. Prej andej donin të kallonin në bregun përballë. Që të vidhnin makinat djallëzore të mbeturinave.




Por largësia qe e madhe dhe ata shumë të vegjël për ta arritur qëllimin. Një pllaq i fortë u dëgjua dhe miqtë tanë u gjendën të gjithë brenda në ujë. Miqtë e tyre kishin kuptuar.




«Alarm, alarm! Pushtues!» thirri Totos fshesar, që ishte, siç ishte e natyrshme, kryetar batalioni të mbeturinave dhe menjëherë filloi hedhjen e mbeturinave.

Me thithësen e madhe të mbeturinave kapi në çast Arin, Kikinë, Toton dhe gjithë shoqërinë e tyre të mbeturinave.




Gjendja për Akin Ujës dhe për miqtë tanë ishte më shumë se kritike. Miqtë tanë do të ishin mbuluar me mbeturina shumëtonëshe, po të mos dukej befasisht i paftuar Makis Mbeturinambledhës.






I drejtoi menjëherë në vendin e Riedukimit që quhej «Riciklimi», ndoshta të bëheshin përsëri të vlefshëm për mjedisin.
Shoqet e Rulës Filtrulës morën përsipër armikun më të vështirë Kikinë Kimikën. U vërsulën brenda nëpër fabrikat e saja dhe me bashkëpunimin e nxënësve, lumi Vjosa u bë përsëri i pastër, si më parë, plot jetë.
Nuk rrëzikohen më as njerëzit as kafshët as bimët.



Vjosa ishte përsëri e gëzuar, se zogjtë dhe kafshët shkonin afër saj të freskoheshin dhe nuk ishin më në rrezik. Peshqit notonin përsëri të lumtur dhe pa u rrëzikuar nga asfiksia në ujërat e pastra. Bimët që ujiste u mbushën sërish me gjethe të gjelbra dhe lulet e tyre kundërmojnë erë të mirë!
Njerëzit hapën përsëri çezmat e shtëpive të tyre dhe pinin ujë pa frikë. Gëzimi i lumit Vjosë nuk përshkruhej.

Akis Ujës dhe Rula Filtrula u martuan, bënë shumë pika të vogla dhe formuan një liqen kaq të pastër dhe të kaltër dhe si të mos ishte me të tillë prindër, që e quajtën Kaltërsi.




Fëmijët ishin të lumtur që ndihmuan edhe ata shpëtimin e së Ftohtës të Burimit. Sigurisht nuk harruan miqtë e tyre Akin Ujës edhe Rulën Filtrula dhe çdo ditë i vizitonin dhe luanin me djemtë e tyre në Liqenin Kaltërosh!



# profesionet tradicionale

1 2 3



Shekulli që kaloi solli ndryshime të rëndësishme në jetën e përditshme të njeriut dhe në kulturë. Punët tradicionale dhe profesionet që kishin filluar t ë lulëzojnë në të dyja zonat ndryshuan formë ose u zëvëndësuan me të reja ose nuk ekzistojnë më. Më ndihmën e këngëve popullore nga të dyja zonat do të çfletojmë fillin e profesioneve tradicionale dhe do të udhëtojmë në të kaluarën, për të njohur profesione që janë drejt zhdukjes, vështirësitë që ndeshnin profesionistët, mënyrën me të cilën çfrytëzonin ato që u jipte natyra, pa e shkatërruar atë. Do të krenohemi me shkathësinë e tyre dhe nuk do t'i lëmë të harrohen gjithashtu me kalimin e kohës.



Udhëtimi nëpër vite për t'u njohur me profesionet tradicionale fillon!

### 1. Nuancat e tingullit.



Vëreni me kujdes veglat e mëposhtme. I njihni të gjitha? Plotësoni emrin e tyre poshtë fotografisë. Dëgjoni tani me kujdes tingujt. Mund të korrespodoni secilën figurë me tingullin e saj?

Përpiquni të vendosni tani tingujt që dëgjuat në një radhë duke filluar nga tingulli me i fortë dhe duke përfunduar tek tingulli më i dobët.



Ndani në dy vija tingujt që dëgjuat. Në vijën e parë do të shkruani tingujt që zgjasin një çast dhe në tjetrën ato që zgjasin më shumë.

të çastit ........................................................

të vazhdueshëm ........................................................

2. Dëgjoni me kujdes dy shëmbuj tingujsh (tinguj nga ambientet e punës në qytet dhe në fshat. Shënoni sa më shumë tinguj që keni njohur prej tyre. Pyetje të mundshme:

- Ç' punë bën njeriu?
- Është burrë apo grua?
- Gjendet në qytet apo në fshat?
- Vizaton një figurë për secilin nga të dyja profesionet që dëgjuat.



3. Luajmë me imitime?

Udhëzime për lojën:

1) Ndahuni në skuadra.
2) Zgjedhja e temës.
3) Secila skuadër bisedon fshehurazi se cilin profesion do të paraqesë skuadrës tjetër.
4) Njëra nga skuadrat paraqet temën me lëvizje. Nuk lejohet të përdorni fjalë, por mund të përdorni tinguj nga profesioni që shfaqni. Jeni të lirë të riprodhoni tingujt që doni dhe t'i vlerësoni:
   - trupi juaj (goja,përplasja e duarve etj),
   - tinguj nga fletë letre,goditje lapsash etj,
   - vegla muzikore që kemi në klasë (sistër, ksistër, daulle etj).
5) Skuadra tjetër përpiqet të parashikojë.
6) Në qoftë se do të arrijnë qëllimit, fiton.
7) Loja vazhdon me ndërrim rolesh.

4. Dëgjoni me kujdes këngën: «Kërraba jote e qendisur».

***Kërraba jote e qendisur***

*Kërraba jote e qendisur, more çoban*
*Kur kalon nëpër gryka, more çoban*
*Syzeza dhe vetullashkruar gjen, more çoban*
*Kalove nga Përmeti, more çoban*
*Në një pemë, të madhe pemë, more çoban*
*Të prisnin disa zonja, more çoban.*

- Shoqërohet ajo nga vegla muzikore,apo dëgjohen vetëm zëra?
- Kënga këndohet nga një burrë i vetëm, nga një grua e vetme, nga një grup

këngëtarësh si kor. Mund të gjeni radhën që dëgjohen dhe si kombinohen?

- Në fillim këndon ...
- Në vazhdim fillon dhe ...
- Në fund dëgjohet ...

- Kush mendoni se është këngëtari kryesor në këngë?
- Pse besoni se ka edhe të tjerë?
- Cilit profesion i kushtohet kënga?
- Ky profesion ushtrohet në fshat apo na qytet?
- Mund të mendoni dhe profesione të tjera që i takojnë vetëm në qytet apo vetëm në fshat?

Në këngën e mësipërme folëm për dy gjëra: për mënyrën se si këndohet, **muzikën** e saj, dhe për kuptimin e saj, atë që në këngë e quajmë **varg**. Ç'farë mendoni se cila u shkrua e para, muzika apo vargu?

- Shikoni fotografitë e mëposhtme. Përbëjnë material fotografik me vepra të njerëzve që banojnë në të dyja anët e kufirit. Mund të gjeni profesionet e banorëve në të dyja zonat?
- Plotësoni fotografitë tuaja që tregojnë ushtrimin e profesioneve të përbashkëta të banorëve në të dyja zonat.

- Ajo që na bën t'i dallojmë tingujt quhet nuancë, e cila është një nga karakteristikat bazë të tingullit.
- Një tjetër karakteristikë bazë që ka tingulli është intensiteti i tingullit. d.m.th se sa i fortë është.
- Përfundimisht, një karakteristikë tjetër bazë që ka tingulli është zgjatja.



| Shqipëri | Greqi | Profesioni / Zanati |
|---|---|---|
|  |  | ........................................ |
|  |  | ........................................ |
|  |  | ........................................ |

| Shqipëri | Greqi | Profesioni / Zanati |
|---|---|---|
|  |  | ........................................ |
|  |  | ........................................ |
|  |  | ........................................ |

5. Vizitoni një punishte (argjendari, druskalitje etj). Shkruani të dhëna për profesionin si për veglat e punës, teknikën, personelin. Përpara se të bëni vizitën të hartoni një pyetësor tek i cili pyetjet të kenë formën:

- Sa vite e bëni këtë punë?
- Kush u ka mësuar këtë profesion?
- Është e lodhshme puna që bëni?

6. Uluni të gjithë në formën e një rrethi dhe dëgjoni këngën E.10.16. «Ura e Artës». Përpiquni ta thoni vjershën si një përallë. Secili nga ju të thotë nga një fjali. Kërkoni nga mësuesi apo mësuesja të shkruajë fjalitë tuaja në dërrasë dhe në fund lexoni të gjithë së bashku përrallën.

Fjalia e parë do të fillojë: «Një herë e një kohë...»

***Ura e Artës***

*Dyzet e pesë mjeshtër dhe gjashtëdhjetë nxënës*
*një urë po ndërtonin, në lumin e Artës*
*Gjithë ditën e ndërtonin natën ajo rrëzohej*
*Vajtojnë mjeshtërit dhe nxënësit po qajnë*
*–Mjerë fatit tonë gjynah për punën tonë*
*gjithë ditën e ndërtojmë, natën ajo rrëzohet*
*Një zogëz shkoi dhe ndenji djathtas sofrës*
*as si zog këndonte, as si dallandyshe.*
*Vetëm këndonte dhe thoshte bisedë njerëzore.*
*–Në qoftë se një njeri nuk do të flijohet, ura nuk do të mbahet*
*të mos flijohet jetim, as i huaj e as kalimtar*
*por vetëm gruaja e bukur e kryemjeshtrit.*
*Me zogun porositi:*

–Ngadalë të vishesh, ngadalë t' ju çosh drekën
Dhe zogu nuk dëgjoi mirë dhe ndryshe shkoi dhe i tha:
–Shpejt të vishesh, shpejt ndërrohesh, shpejt të çosh drekën
Ja ku u duk ajo, ardhur nga rruga e bardhë
e shikon kryemjeshtri dhe bie për të vdekur.
–Mirëmëngjesi mjeshtër dhe ju more nxënës
po ç' ka kryemjeshtri që është i mërzitur
–Unazën e ka humbur tek qemeri i parë
dhe kush do futet e të dalë, unazën që të gjejë
–Unë do futem, unë do futem unazën për të gjetur
siç varen të githa zinxhirët
–Tërhiqe, o i mirë zinxhirin tërhiqe
gjithë vendin e gjezdisa dhe asgjë nuk gjeta
Njeri kërkon me mistri dhe tjetri në gëlqere
një gurë të rëndë hedh dhe kryemjeshtri
–Mjerë fatit tonë, gjynash për fatin tonë
tre motra ishin, të tria me fat të keq
njëra në Danub, tjetra në Eufrat e
tjetra më e vogla në urën e Artës.
Siç dridhet trupi im të dridhet ura
siç bien gjethet e pemëve, të bien kalimtarët
–Vajzë ndërro mendimin dhe tjetër mallkim të japësh
ke një vëlla të vetëm që të mos rastisë të kalojë.
–Në qoftë se dridhen malet e egër, të dridhet edhe ura
në qoftë se bien zogjtë e egër të bien dhe kalimtarët
kam një vëlla të vetëm e të shtrenjtë, të mos rastis të kalojë.

E ndërtuat përrallën tuaj? Tani mendoni:

- Çfarë ndryshimi ka vjersha nga përralla?

- Lexoni më parë përrallën dhe pastaj vjershën duke u përpjekur njëkohësisht të përplasni pëllëmbët! Në cilin nga të dyjat është më thjeshtë ta bëni? Mund ta imagjinoni pse?

**Një e dhënë bazë e vjershës që e bën të dallohet nga fjala e thjeshtë është ritmi.**

- Rilexoni vjershën. Përpiquni të shoqëroni ritmikisht recitimin jo vetëm me pëllëmbët e duarve por dhe me një vegël muzikore që gjëndet në shkollën tuaj ose me vegla të ndërtuara prej jush në klasë.
- Realizoni këtë aktivitet (bëjeni këngën përrallë) dhe me këngën popullore nga Shqipëria:

**Kalaja e Rozafatit**

*Na i ra tymi Buenasë,*
*mjegulla shikon kalanë,*
*ku punojnë tre ustallarë.*
*Ku punojnë e çmur murojnë?*
*Murin e kalasë qytet.*
*Shkoi një plak-o andej pari.*
*"Puna mbarë, o ustallarë!"*
*"Ku po e shef ti t' mbarën tone?*
*Të gjithë ditën po punojmë,*
*të gjithë natën po na rrxon!...*
*A din, plak, këshill me na dhanë?"*
*"Unë e di, po m'vjen gjynah.*
*A jeni ju tre vllazën?"*
*"Po, të tre vllazën na jena".*
*"A keni të tre vashat?"*
*"Po, të tre vashat i kena".*
*"Lidhni besë e lidhni fe,*
*vashave mos u kallxoni:*
*cila sosh-o t'u bjerë bukë,*
*atë muronje n'mur qytet."*
*Ma i pari Gjon vëlla,*
*çarti besën qi kish vu:*
*në konak e bisedoi*
*vashës s'tij aj i kallxoi.*
*Edhe i dyti Gjon vëlla,*
*çarti besën qi kish vu:*

në konak e bisedoi
vashës s'tij aj i kallxoi
Ma i vogli Gjon vëlla
mbajti besë e mbajti fe:
vashës s' tij aj s' i kallxoi.
Isht errë natë e dritë kish zbardhë,
me punue djelmët kanë dalë.
Kur erdh koha me çue cillë,
nana rejave u ka thirrë:
"Gjelinë, e para gjelinë,
çou m' u ço ti djelmëve cillë!"
"Besa, nanë, po më dhemb kryet,
pse m' ka ardhë mue fjala mbramë,
qi m' ka dekun qyrja nanë".
"Gjelinë, e dyta gjelinë,
çou m' u ço ti djelmëve cillë!"
"Besa, nanë, po m' kjajnë fmijtë
vetë kam ndjehun sot e ligë."
"Gjelinë, e treta gjelinë,
çou m' u ço ti djelmëve cillë!"
"Urdhëro,nanë!" Braf në kambë!
E ka vu djalin në gjumë,
të dy faqet ia ka puthë:
"Lamtumirë, njomzaku i nanës,
se s' t prek nana ma me dorë."
Kjenka nisë nusja me shkue,
ka marrë bukë e ka marrë uj,
i isht afritë murit qytet
e p'e shef i shoqi i vet.
Kur e pa çekiçi ra.
"Ç' isht në ty sot, o emzot?"
"Po t' murojmë në mur qytet!"
"Qyrja unë, kërcuna e mjera,
nafakzeza paskam kenë!
Veç po t' la nji porosi:
anën e dhjathtë ma lini jashtë.
Kur t' më korkoi djali mue,
me sy t' dhjathtë m' e lurtue
e me gji t' dhjathtë m' e pajtue!"
Rasen sipri ia kanë vu!
Çohet djali në mjesditë,
lyp, kërkon nanën e tij nëpër shpi.
Po i thotë gjyshja e vet:
"T' isht murue në mur qytet."
Djali kjan edhe vërret
e po çojnë te nana e shkretë.
Nana e vet-o nuk po i flet...
Djali kjan edhe vërret,
Shtjen në dhimbje mal e gur t' shkretë.
Cica e dhjathtë po nis me rrjedhë.

7. Dëgjoni këngët: «Lajmin e sjell lajmëtari», E.10.16. «Ura e Artës», A.8.9. «Një çoban lart në mal». Për cilat profesione bëhet fjalë në këngët e mësipërme? Referohuni profesioneve të prindërve tuaj, i shkruani ato dhe plotësoni një tabelë me profesione të tjera. Gjithashtu shkruani profesionet që shfaqen në këngët e vendit tjetër dhe gjeni ato që janë të përbashkëta.

8. Dëgjoni këngët: E.10.16. «Ura e Artës», «Lajmin e sjell lajmëtari». Shkruani fjalët e reja që lidhen me profesionet që i takojnë në këngët greke dhe shqiptare. Përshkruani veshjet tradicionale të krahinës suaj (shamia, futa, këmisha etj).

Propozim për leximin dhe përpunimin e mëtejshëm të pjesëve letrare me temë profesionet:

- «Buka më e ëmbël», përrallë.
- «Peshkatarët që zunë» një gur të Ezopit.
- «Dikur zinin rrënjë edhe fjalët», përrallë.
- «Zoti Lazaros dhe dragonjtë»



9. Lexoni vjershën e mëposhtme.

**_Siç shkon, Mallamo ime, për ujë_**
*Dhe une tek burimi po të pres.*
*Do të të thyej kanën e ujit*
*të shkosh tek nëna duarbosh*
*dhe në të pyestë nëna jote*
*Mallamo ime, ku është kana jote?*
*–Nëna ime,u rrëzova*
*dhe kanën time e theva.*
*–Kjo nuk është se u rrëzove*
*por vetëm e dashurisë është thyerja.*





Objektet prej balte të përdorimit të përditshëm janë të ndërtuara prej baltëpunuesve. Shiko videon: *http://www.pestaola.gr/nikos-rodios-skopelos-interview-pottery-make*
dhe me plastelinë ose me argjil bëhu dhe ti një baltëpunues i vogël.

- Çfarë objekte ndërtonin me argjilin?
- Sot cilat prej tyre përdorim?
- Me cilat u zëvendësuan sot disa të tjera?

Ndihmoni baltëpunuesin të stolisë kanat e mëposhtme. Skiconi kana dhe i stolisni ato me skica dhe ngjyra.





10. Dëgjoni këngët: E.10.16. «Ura e Artës», A.12. 2. «Aman, mullixhi more mullixhi».

Në të dyja vëndet ekzistojnë zanatxhinj që bëjnë të njëjtën punë dhe përdorin të njëjtat mjete pune. Në tabelën e mëposhtme mjetet e domosdoshme të punës dhe puna që bën secili zanatxhi u ngatërruan.

Korrespodoni fjalët e ngatërruara si në shembullin. (Burim: http://www.kpekonitsas.gr/index.htm)





**Kush e bën**

- muratori
- argjendari
- lëkurëpunësi
- mullixhiu
- shportbërësi
- endësja
- druvari
- nallbani
- ikonograf

**Çfarë bën**

- thurr shporta
- mbath kuaj
- bën stoli
- përpunon lëkurë
- pret pemë
- bluan grurë
- pikturon kisha
- ndërton shtëpi
- end

**Çfarë mjete-pune përdor?**

- argjend
- avliment
- kalama
- penel
- gurë
- mulli
- gozhdë
- sharrë
- lëkure kafshësh

11. Vizitë në muze. Dëgjoni këngët: Gr. Kacalidha, «Vajza në avliment», Këngë popullore nga Epiri V., fq. 528, «Siç dalin plakat në lëmë» (10).

- Ke vizituar ndonjëherë muze të kulturës popullore?
- Çfarë shikon ndokush atje?
- Si e përfytyron muzeun përkatës në vendin tjetër?
- Mund të ekzistojnë objekte të përbashkëta? Pse? Thoni disa.
- Përshkruani një objekt nga muzeu. Gjatë përshkrimit tëobjektit nuk harroj të përmend: formën, madhësinë, ngjyrën, përmbajtjen, përdorimin etj.

### 1. Nuancat e tingullit



Vëreni me kujdes veglat e mëposhtme.
I njihni të gjitha? Plotësoni emrin e tyre poshtë fotografisë.

Dëgjoni tani me kujdes tingujt. Mund të korrespodoni secilën figurë me tingullin e saj?

.............................................



Përpiquni të vendosni tani tingujt që dëgjuat në një radhë duke filluar nga tingulli me i fortë dhe duke përfunduar tek tingulli më i dobët.

Ndani në dy vija tingujt që dëgjuat. Në vijën e parë do të shkruani tingujt që zgjasin një çast (**të çastit**) dhe në tjetrën ato që zgjasin më shumë (**të vazhdueshëm**).

të çastit .............................................

.............................................

të vazhdueshëm .............................................



### 2. Luajmë me imitime?

Udhëzime për lojën:

1) Ndahuni në skuadra.
2) Zgjedhja e temës.
3) Secila skuadër bisedon fshehurazi se cilin profesion do të paraqesë skuadrës tjetër.
4) Njëra nga skuadrat paraqet temën me lëvizje. Nuk lejohet të përdorni fjalë, por mund të përdorni tinguj nga

.............................................

profesioni që shfaqni. Jini të lirë të riprodhoni tingujt që doni dhe t'i vlerësoni:
- trupi juaj (goja,përplasja e duarve etj),
- tinguj nga fletë letre,goditje lapsash etj,
- vegla muzikore që kemi në klasë (sistër, ksistër, daulle etj).

5) Skuadra tjetër përpiqet të parashikojë.
6) Në qoftë se do të arrijnë qëllimit, fiton.
7) Loja vazhdon me ndërrim rolesh.

3. Dëgjoni me kujdes këngën: «Kërraba jote e qendisur».

***Kërraba jote e qendisur***

*Kërraba jote e qendisur, more çoban*
*Kur kalon nëpër gryka, more çoban*
*Syzeza dhe vetullashkruar gjen, more çoban*
*Kalove nga Përmeti, more çoban*
*Në një pemë, të madhe pemë, more çoban*
*Të prisnin disa zonja, more çoban.*

- Shoqërohet kënga me vegla muzikore,apo dëgjohen vetëm zëra?
- Kënga këndohet nga një burrë i vetëm, nga një grua e vetme, nga një grup këngëtarësh si kor. Mund të gjeni radhën që dëgjohen dhe si kombinohen?
  - Në fillim këndon ...
  - Në vazhdim fillon dhe ...
  - Në fund dëgjohe ...
- Kush mendoni se është këngëtari kryesor në këngë?
- Pse besoni se ka edhe të tjerë?
- Dëgjoni pjesën e mëposhtme:

- Mund të njohësh disa vegla muzikore?
- Ekziston ndonjë vegël që dallohet?
- Ç' farë roli kanë të tjerat?

- Mund të dallosh ngjashmëri në mënyrën si këndohet kënga «Kërraba jote e qendisur» dhe koncertit?
- Në muzikë kur bashkëbisedojnë ndërmet tyre e gjithë orkestra nga nja njëra anë dhe një vegël muzikore nga ana tjetër, këtë vepër e quajmë koncert.
- Cilit profesion i kushtohet kënga?
- Është profesion që ushtrohet në qytet apo në fshat?
- Mund të mendoni dhe profesione të tjera që i takojnë vetëm në qytet apo vetëm në fshat?

Në këngën e mësipërme folëm për dy gjëra. Për mënyrën se si këndohet, për **muzikën** e tij, dhe për **kuptimin** e tij, atë që në këngë e quajmë **varg**. Çfarë mendoni se u shkrua më parë, **muzika** apo **vargu**?

- Ajo që na bën t'i dallojmë tingujt quhet nuancë, e cila është një nga karakteristikat bazë të tingullit.
- Një tjetër karakteristikë bazë që ka tingulli është intensiteti i tingullit. d.m.th se sa i fortë është.
- Përfundimisht, një karakteristikë tjetër bazë që ka tingulli është zgjatja.



4. Kënga bëhet shkak për të biseduar për ato forma të artit tradicional në të dyja zonat. Sugjërohet vizita në një pinishte (argjendari, druskalitje etj).

Shkruani të dhëna për profesionin, si për veglat e punës, teknikën, personelin. Përpara se të bëni vizitën të hartoni një pyetësor, pyetjet e të cilit do të kenë formën:

- Sa vite e bëni këtë punë?
- Kush jua ka mësuar këtë profesion?
- Është e lodhshme puna që bëni?

5. Dëgjoni këngën E.10.16. «Ura e Artës» (vargjet e vjershës mund t'i lexoni në faqen 139) dhe ndahuni në grupe për të shkruar historinë vjershës si një përrallë.

Fillimi mund të jetë: «Një herë e një kohë...»

E ndërtuat përrallën tuaj? Tani mendoni:

- Çfarë ndryshimi ka vjersha nga përralla?
- Lexoni më parë përrallën dhe pastaj vjershën duke u përpjekur njëkohësisht të përplasni pëllëmbët! Në cilin nga të dyjat është më thjeshtë ta bëni? Mund ta imagjinoni pse?

**Një e dhënë bazë e vjershës që e bën të dallohet nga fjala e thjeshtë është ritmi.**




Rilexoni vjershën. Përpiquni të shoqëroni ritmikisht recitimin jo vetëm me pëllëmbët e duarve, por dhe me një vegël muzikore që gjëndet në shkollën tuaj ose me vegla të ndërtuara prej jush në klasë.

Shkoni tani në faqen 141 dhe lexoni vjershën për ndërtimin e kalasë. Ndahuni në grupe përsëri nde shkruani historinë vjershës si përrallë.

Fillimi mund të jetë: «Një herë e një kohë...»

- Kanë të dyja këngët ngjashmëri dhe ndryshime në formë dhe në përmbajtje?
- Janë të rastit ngjashmëritë dhe në qoftë se jo çfarë tregojnë ato ?
- Njihni këngë të tjera,fabula ,tradita që ekzistojnë në të dyja vendet?

6. Në qoftë se viziton dikush fshatin Kastanea siç quhet ndryshe fshat ustallarësh dhe një nga fshatrat me të bukura të Epirit, në Shen–Nikollën (1926) mund të shohë një ikonostas të gdhendur në drujë i autorit Harallamb Skalistit, shkolla dykatëshe më gurë (1894), Shën Dhimitri (ndërturar rreth vitit 1670), katër urat njëharkëshe, shtëpia e arhondit Gosko, shumë shtëpi prej guri, edhe kalldreme dhe shumë mure që tregojnë një fshat me vyrtyte arqitektonike.





http://users.kyk.sch.gr/aristhodas/mastroxoria.htm

Tabloja plotësohet me kishën e Shën Apostojve "në anë të fshatit në lagjen Mesarja në një peizazh me bukuri të mahnitshme".

Udhëzuesi turistik i Dropullit (1999) na informon se mund të vizitojmë kishën dhe të shohim ikonostasin. Bashkëbisedoni me shokët tuaj për arkitekturën e kishave në të dyja vendet dhe për druskalitjen.

- Ekzistojnë karakteristika të përbashkëta?
- Çfarë konkluzione mund të nxirrni për adhurimin,profesionet dhe zakonet e banorëve?

Ustallarët e të dyja zonave gdhendin gurin me të njejtën teknikë.



- Mund të kuptoni se cilët janë nga Dropulli i Shqipërisë së Jugut?
- Pse nuk mund të bëhet korrespodimi?
- Besoni se rruga e përbashkët e ustallarëve të të dyja zonave mund të kontribuojë rëndësishëm në shtytjen e komunikimit ndërballkanik (ekzistojnë afër tyre qendra të rëndësishme të traditës arkitektonike siç janë fshatrat e ustallarëve të

Janinës, të Voit, të Kastorias, të Fllorinës, të Xhumerkës, dhe të tjerat nga ana tjetër e kufirit siç janë ato të Gjirokastrës, të Korçës, të Elbasanit dhe të Dibrës?

Me cilat mënyra mund të arrihet komunikimi dhe të përforcohen marrëdhëniet midis të dyja vendeve?

7. Lexoni vjershën e mëposhtme.

**Mallkim dimri**

*Mallkim dimri (sarakaçana ime)*
*(Ore) Janar edhe Shkurt*
*[ dhe ti more Mars antikrisht ]*
*dhe ti more Mars antikrisht (sarakaçana ime)*
*bën dimër të rëndë (more) [ na ngordhe more delet ] oh, oh, oh, oh,*
*na ngordhe delet (more Mars antikrisht)*
*na ngordhe dhitë [ na ngordhe more dhe kuajt ] oh, oh, oh, oh,*
*na ngordhe edhe kuajt (more Mars antikrisht)*
*mushkat edhe pelat [ na ikën edhe djemtë ] oh, oh, oh, oh,*
*na ikën edhe djemtë (sarakaçana ime)*
*ikën drejt mërgimit [ shkoi dhe plahu nga afër ] oh, oh, oh, oh,*
*U shkoi dhe plaku nga afër (sarakaçana ime)*
*(ore)shkoi për t'i kthyer [ kthehuni mbrapa more djem ] oh, oh, oh, oh,*
*kthehuni pas more djem (sarakaçana ime)*
*(ore) pas për në shtëpi [ Unë do t'ju bëj me dhënë ] oh, oh, oh, oh,*
*Unë do t'ju bëj me dhënë (sarakaçana ime)*
*Unë do t'ju bëj me dhi, unë do t'ju jap qumësht*

Punët bujqësore janë të njëjta në zonat fqinje të të dyja vendeve dhe varen shumë nga stinët e vitit.

- Për cilët muaj dhe cilat stinave u referohet kënga që dëgjuat?
- Për cilat punë?
- Përpiqu të gjesh sa më shumë punë bujqësore që kryhen gjatë katër stinëve.

Dëgjoni këngën E.4.3. «Në fushën e Sirgjiotit» dhe të bëni përshkrimin e veshjes tradicionale të vendit tuaj (shamia, futa, këmisha etj).

| punimet |
|---|
| Dimri ........................................ |
| ........................................ |
| Pranvera ........................................ |
| ........................................ |
| Vera ........................................ |
| ........................................ |
| Vjeshta ........................................ |
| ........................................ |



### 8. Formoni hartën muzikore!

Kërkoni profesione të rëndësishme në krahina të Greqisë dhe gjeni këngë që u kushtohen atyre. Vëzhgoni relievin e Shqipërisë.

- Cilat profesione që përmënde në ushtrimin e mëparshëm mund të lulëzojnë këtu?
- Si të ndihmoi harta reliev?
- Gjej këngët që u kushtohen profesioneve dhe vendosi ato në hartë për të formuar hartën muzikore të Shqipërisë.



9. Një nga kompozitorët më të shquar të muzikës klasike është Antonio Vivaldi (1678-1741). Lindi dhe jetoi në Itali dhe një veprat më të njohura të tij është «Katër stinët».

- Dëgjoni fragmente dhe përpiquni të dalloni se nga cila stinë është secili fragment.
- Vizatoni për secilën nga stinët një punë bujqësore, nga ato që kemi gjetur në aktivitetin e mëparshëm.

10. Gr. Kacalidha, «Në futën tënde të qendisur», Këngë popullore nga Epiri V., fq. 556.

Përpiquni të zbukuroni me skica dhe ngjyra futat tradicionale. Thithni informacion për skicat e këmbëve nga intreneti ose nga faqja e muzeve të kulturës popullore.



11. Lexoni e mëposhtme vjershën:

*Siç shkon,mallamo ime, për ujë*
*Dhe une tek burimi po të pres.*
*Do të të thyej kanën e ujit*
*të shkosh tek nëna duarbosh*
*dhe në të pyestë nëna jote*
*Mallamo ime, ku është kana jote?*
*–Nëna ime, u rrëzova*
*dhe kanën time e theva.*
*–Kjo nuk është se u rrëzove*
*por vetëm e dashurisë është thyerja.*



Objektet prej balte të përdorimit të përditshëm janë të ndërtuara prej baltëpunuesve. Shiko videon: http://www.pestaola.gr/nikos-rodios-skopelos-interview-pottery-maker
dhe me plastelinë ose me argjil bëhu dhe ti një baltëpunues i vogël

- Çfarë objekte ndërtonin me argjilin?
- Sot cilat prej tyre përdorim?
- Me cilat u zëvendësuan sot disa të tjera?

## 12. Udhëtim me një qilim fluturues

Qilimi më i vjetër në botë ruhet në muzeun Ermitazh të Shen Petërburgut. U zbulua nga arkeollogët në lartësinë 1650m në malet Alltai në një krahinë që quhet Parizik. Është prej lesh deveje, mbulon katër metra katrore dhe u zbulua i ngrirë brenda në shpellat e Sqithos dhe mbahet mire dhe i pacenueshëm. Llogaritet se përbëhet nga

1.500.000 nyje. Në bordurat e tij janë vizatuar 28 kalorës dhe 24 drenj (gazeta Erevnites, volumi 353, fq.10-11). Vazhdoni tani rrugën e teknikës së endjes gjatë kalimit të viteve dhe në vende të ndryshme të Mesdheut. Gjeni infomacione dhe bëni një reportazh për qylymat duke udhëtuar mbi një «qylym fluturues».

13. Dëgjoni këngët: E.4.3. «Në fushën e Sirgjiotit», A.12.2. «Aman, mullixhi more mullixhi». Në të dyja vendet ekzistojnë zanatxhinj që bëjnë të njëjtën punë dhe përdorin të njëjtat mjete pune. Në tabelën e mëposhtme mjetet e domosdoshme të punës dhe puna që bën secili zanatxhi u ngatërruan. Vendosni fjalët e ngatërruara.

| Kush e bën | Çfarë bën | Çfarë mjete-pune përdor? |
| --- | --- | --- |
| muratori | thurr shporta | argjend |
| argjendari | mbath kuaj | avliment |
| lëkurëpunësi | bën stoli | kalama |
| mullixhiu | përpunon lëkurë | penel |
| shportbërësi | pret pemë | gurë |
| endësja | bluan grurë | mulli |
| druvari | pikturon kisha | gozhdë |
| nallbani | ndërton shtëpi | sharrë |
| ikonograf | end | lëkure kafshësh |

Dëgjoni tani këngët: E.1.8. «Mallkim dimri», A.8.9. «Një çoban lart në mal», A.6.6. «Vajta në mulli», E.4.2. «Vreshti im gjethegjerë», A.11.11. «Lart në vresht».

- Këngët që dëgjuat u referohen të njëjtit profesion.
- Cilat profesione janë të përbashkëta?
- Çfarë konkluzione mund të nxirrni për jetën e përditshme në të dyja zonat?

Dëdjoni këngët: «Unë isha arkond i vogël», E.8.9. «Një çoban lart në mal». Dëgjojmë njërën pas tjetrës, të dyja këngët dhe mësojmë t'i kërcejmë me hapa. Mund të gjejmë brenda në këngën shqiptare si quhet çobani?



14. Ndahuni në skuadra dhe grumbulloni emra dhe mbiemra (nofka) të cilat lidhen me profesionet dhe përcaktoni profesionin si shkak, të cilit ju dha mbiemri ose i përafërt në brezat e ardhshëm. (mullixhi, këpucar, kopshtar, çoban, furxhi, samarxhi, marangoz, berber).

15. Dëgjoni këngët: E.4.3. «Në fushën e Sirgjiotit», A.12.2. «Aman mullixhi, more mullixhi».

Duke udhëtuar nëpër kohë ndahuni në katër skuadra dhe transferohuni në dy epoka të ndryshme kohore. Skuadra e parë dhe e dytë do të punoni si baltëpunues në lashtësi në Greqi dhe Shqipëri përkatësisht. Skuadra e tretë dhe e katërt do të transferoheni në fillimin e shekullit të 20të dhe do të ushtroni profesionin e mullixhiut përkatësisht. Secila skuadër do të përshkruajë një ditë pune të përditshme. Komentoni tekstet që do të shkruhen dhe gjeni ngjashmëri dhe ndryshime në profesione gjatë periudhave të ndryshme kohore në të dyja vendet.

16. Dëgjoni këngët: E.10.16. «Ura e Artës».

Banorët e të dyja zonave ndërtonin mure guri tradicionalisht për të përballuar nevojat e përditshme njerëzore. Nevojat e përbashkëta i detyruan në ndërtimin e mureve pak a shumë të ngjashëm. Plotësoni tabelën e mëposhtme.

| Nevoja njerëzore | Mure guri tradicionale |
|---|---|
| ........................................ | çesma, puse, shtera, kanale guri, kulla uji, ura ujore, prita ujore |
| ........................................ | mulli uji, mulli ere, lemenj, punishte vaji |
| ........................................ | mure guri pa llaç, oborre shtruar me pllaka, shtëpi kulla, oxhaqe guri të rumbullaktë, frëngji, vend per përvëlimin e rrobave |
| ........................................ | kisha, vakëfe, manastire, ikonostase, këmbanore relieve kishtare |
| ........................................ | monopate ndërtuar me gurë dhe pllaka guri, hane, ura guri harkore |

Burim: http://kpe-kastor.kas.sch.gr/kpe/yliko/sppe1/oral/PDFs/97-106_oral.pdf

17. Dëgjoni këngët: E.9.4. «Të kisha një postier», E.10.16. «Ura e Artës», A. «Lajmin e sjell lajmëtari», A.11.20. «Një ujë zonja Vangjelo».

Sot disa zbulime e kanë bërë më të lehtë jetën e njerëzve. Të njëjtat punë

realizoheshin ndryshe në të kaluarën dhe sot. Korrespodoni figurat në të dyja shtyllat. Kur çdo punë bëhej më lehtë. Vendosni në çdo çift figurash këngën greke ose shqiptare që u përshtatet. Kur çdo punë bëhej më lehutë?







të dërgoj mollë, kalbet...











ura e Artës



një ujë zonja Vangjelo







18. Dëgjoni këngët: E.4.3. «Në fushën e Sirgjiotit», A.12.2. «Aman mullixhi, more mullixhi». Në kriptogramin e mëposhtëm eksiztojnë shtatë profesione që kanë humbur gjatë viteve. Përpiqunu t'i gjeni.

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | Ç | I | R | R | O | J | F | W | P | O | X | T | T | E | S | H |
| Ë | K | O | K | M | R | F | U | I | F | N | D | H | I | N | K | Q |
| T | E | R | R | I | O | A | K | R | T | Z | I | A | G | D | J | I |
| P | I | N | Z | E | K | R | Z | Y | A | S | H | M | T | Ë | N | B |
| M | M | A | Y | L | Ë | K | U | R | P | U | N | U | E | S | H | I |
| K | Q | L | D | E | P | D | H | T | N | I | O | L | P | R | R | W |
| I | E | L | B | L | U | Ë | K | J | N | T | E | L | L | A | L | B |
| U | Y | B | X | Y | C | A | U | E | W | G | T | I | K | E | I | M |
| A | K | A | L | L | A | N | X | H | I | K | E | X | T | X | I | N |
| S | H | N | E | N | R | T | W | Q | L | D | Q | H | I | E | T | O |
| D | K | N | V | A | S | D | H | P | P | O | Z | I | Y | Ë | R | P |
| E | R | T | Z | I | O | P | A | N | E | Y | D | F | K | C | Ç | O |

Këshilla e të moshuarve për të rinjtë gjithmonë ishte: «Në qoftë se doni të keni shëndet të mirë,zbatoni në jetën tuaj: tre – pesë – tetë. Me fjalë të tjera: të hani bukë të pjekur para tre ditësh dhe jo të ngrohtë. Të pini verë qysh prej pesë vjetësh në fuçi dhe të hani mish vetëm çdo tetë ditë.



19. "Nga fara e mirë, bëhet bukë e mirë", thotë një proverbë. Si u nis dhe cila rrugë ndoqi që të arijë buka e ngrohtë në tavolinën tonë?

Në të dyja zonat aktivitetet janë të njëjta. Gjeni fotografi që tregojnë procesin e prodhimit të bukës. Të punoni me udhëzues procesat e mëposhtme: *mbrujtja, bluarja, plugimi, korrja, lutja për shiun,mbjellja, pjekja, shirrja, transporti i prodhimit.*

Të përshkruani këtë rrugë sipas kalendarit e një banori të fshatit dhe fotografitë që gjetët.

20. Nëse doni të mësoni më shumë për profisionet mund të lexoni librate mëposhrëm.

- Andonis Samarakis, «Në një stacion kufitar», Kërkohet shpresë-Shenjë rreyiku, Athinë, 1996, Estia.
- Jeorgjios Andonakis, «Buka më e ëmbël», Athinë, 2002, Akritas.
- «Peshkatarët që zunë një gur» fabul e Ezopit.
- «Ndonjëherë hedhin rrënjë dhe fjalet», përrallë popullore.
- Valasi Zoi, «Tregtari I nuditshmëm vogëlsirash», Diell, diell dhe shi, Athinë, 1982, Kedros.
- Hahn Johan Georg Von, «Yoti Lazaros dhe dragonjitë», Contes Populaires Grecs, Athinë, 2002, Karavia, D. N. – Anastatikes Ekdoseis.
- Shoqëri Latrare e grave, «Profesione të vjetra», Athinë, 2006, Kedros
- Haxikokalaki Sofia, «Profesione të vjetra që nuk ekzistojnë më», Ikonograf: Diamanti-Meletiu Violeta, Athinë, 2006, Kedros.
- Speis Jorjos, Paleologou Katerina, «Një mulli vaji në Alonisso», Ikonograf: Drakos-Dranis Janis, Athinë, 2005-6, Kedros.
- Speis Jorjos, Paleologou Katerina, «Një mulli uji në Xia», Ikonograf: Platanioti Dona, Athinë, 2006, Kedros.
- Speis Jorjos, Paleologou Katerina, «Melisanthi dhe bletët», Ikonograf: Drakos-Dranis Janis, Athinë, 2005, Kedros.
- Ganeri Anita, «Mësoj profesionet», Ikonograf: Jobs People Do, Athinë, Savalas.
- Haximanoli Anna, «Profesionet», Ikonograf: Moshopulos Viktor, Selanik, 2001, Kirki.
- Vasilopulu Maria, «Mjeshtër të një epoke tjetër. Për nxënës të shkollës fillore», Athinë, 2005, Muzeu Benaki.

1. Dëgjoni me kujdes këngën: «Kërraba jote e qendisur».

***Kërraba jote e qendisur***

*Kërraba e qendisur, more çoban*
*Kur kalon nëpër grykat, more çoban*
*Syzeza dhe vetullashkruar gjen, more çoban*
*Kalove nga Përmeti, more çoban*
*Në një pemë të madhe pemë, more çoban*
*Të prisnin disa zonja, more çoban*

- Shoqërohet kënga me vegla muzikore,apo dëgjohen vetëm zëra?
- Kënga këndohet nga një burrë i vetëm, nga një grua e vetme, nga një grup këngëtarësh si kor. Mund të gjeni radhën që dëgjohen dhe si kombinohen?
  - Në fillim këndon ...
  - Në vazhdim fillon dhe ...
  - Në fund dëgjohe ...
- Kush mendoni se është këngëtari kryesor në këngë?
- Pse besoni se ka edhe të tjerë?
- Dëgjoni pjesën e mëposhtme:
  - Mund të njohësh disa vegla muzikore?
  - Ekziston ndonjë vegël që dallohet?
  - Ç' farë roli kanë të tjerat?
- Mund të dallosh ngjashmëri në mënyrën si këndohet kënga «Kërraba jote e qendisur» dhe koncertit?
- Në muzikë kur bashkëbisedojnë ndërmet tyre e gjithë orkestra nga nja njëra anë dhe një vegël muzikore nga ana tjetër, këtë vepër e quajmë koncert.
- Cilit profesion i kushtohet kënga?
- Është profesion që ushtrohet në qytet apo në fshat?
- Mund të mendoni dhe profesione të tjera që i takojnë vetëm në qytet apo vetëm në fshat?

Në këngën e mësipërme folëm për dy gjëra. Për mënyrën se si këndohet, për **muzikën** e tij, dhe për **kuptimin** e tij, atë që në këngë e quajmë **varg**. Çfarë mendoni se u shkrua më parë, **muzika** apo **vargu**?

2. Dëgjoni këngët E.10.16. «Ura e Artës» dhe «Kalaja e Rozafatit» (vargjet e vjershës mund t'i lexoni në faqen 139 dhe 141). Përpiquni të shoqëroni ritmikisht recitimin jo vetëm me përplasjen e pëllëmbëve, por dhe me një vegël muzikore që gjëndet në shkollën tuaj ose prej veglash të ndërtuara prej jush në klasë.

Numërojmë rrokjet e çdo vargu?

Dy-zet-e-pe-së mje-shtër e gja-shtë-dhje-të nxë-nës

Një u-rë po ndër-to-nin në lu-min e Ar-tës.

Bëj të njëjtën dhe me "Kalanë e Rozafatit"

Na i ra ty-mi Bu-e-na-së

Mje-gu-lla shi-kon ka-la-në

Dhe një të fundit...

Unë isha djalë arhond dhe me shumë pare

Dhe tani si u katandisa të rregulloj unë masha.

Ç'farë vëreni? Nga sa rrokje përbëhet çdo varg në të gjitha vjershat?

Le të rilexojmë ritmikisht këngën «Ura e Artës». Vetëm se këtë herë do ta bëjmë më të vështirë. Duhet që rrokjen e parë ta lexojmë fortë dhe tjetrën dobët. Do të lexojmë fortë rrokjen me gërma të theksuara.

Fillojmë!

**Dy**-zet e **pe**-së **mje**-shtër e **gja**-shtë-**dhje**-të **nxë**-nës

**Një** **u**-rë **po** ndër-**to**-nin **në** **lu**-min e **Ar**-tës.

E lexojmë tani me theksi të kundërt:

Dy-**zet** **e** pe-**së** mje-**shtër** e gja-**shtë**-dhje-**të** nxë-**nës**

Një u-**rë** po ndër-to-**nin** në lu-**min** e Ar-**tës**.

- Cilat nga të dyja mënyrat ju shkon më shumë?
- Mund të plotësosh përkufizimin për metrin e poezisë popullore sipas atyre që ke mësuar?
- Shumica e këngëve tona popullore dhe e vjershave është 15-rrokëshe, sepse kanë 15-rrokje në çdo strofë dhe metri i tyre është:

..........................................................................................

Kur ndajmë vargjet e një vjershe në rrokje dhe i theksojmë çdo dy prej tyre, përkatësisht në qoftë se theksojmë të parën apo të dytën gjejmë metrin e vjershës. Kështu, kur theksojmë rrokjen e parë themi se hapi i vjershës është trokaik ´— —, ´— — kur theksojmë të dytën themi së është jambaik — ´—, — ´—



3. Pjesa e mëposhtme është nga një intervistë që u botua në një revistë muzikore në internet.

«Mblodha familjen time dhe menjëherë ngre një çadër në Qiparisia, një Elea në një pyll me pisha ku dy kilometra më poshtë ishte mobiljeria e një miku tim. Njohuri të veçanta nuk kisha dhe pas një muaji del një objekt që i ngjante kitarës. Si kafaz pëllumbash do ta karakterizoja më tepër se sa si vegël muzikore. E fotografoja dhe e sodisja me kënaqësi si evgjiti skeparin e tij. Ika prej andej dhe shkova në Korfuz.

Paratë më ishin mbaruar dhe shkova për të kaluar verën e mbetur. Nxjerr kitarën nga makina, sapo kisha mbritur. Mburesha unë dhe filloi të më tall vëllai im "Ç'është ajo që ke bërë?". Mua më hypi dhe u nevrikosa shumë, se ai shikonte realitetin dhe unë kujtoja se kisha bërë kryeveprën e shekullit.Nuk kishte natyrisht as kordat ,as tastat,as kalorës. Ishte një trup kitareje me një krah».

Intervistë e kitaristit Pavllo Gipa tek N. Caftaridhi. www.tar.gr.

Gjej në fjalor ose në librin e muzikës tënde ç' kuptim kanë fjalët: *kordat, tasta, kalorësi*.

4. Një nga kompozitorët e shquar të muzikës klasike është Antonio Vivaldi (1678-1741). Lindi dhe jetoi në Itali dhe një nga veprat e tij më të njohura është «katër sinët».

- Dëgjoni fragmente dhe përpiquni të njihni se nga cila stinë është çdo fragment.
- Vizato për secilën stinë një punë bujqësore nga ato që takuat në aktivitetin e mëparshëm.

5. Dëgjoni dhe një herë këngët me të cilat jeni marrë. Bëj një listë me profesionet në të cilat përmënden.

- Këngët besoni se u rishkruan nga njerëz që jetojnë në qytet apo në fshat?
- Veçoni dhe shkruani vargjet tek të cilat bazohet përgjigjja juaj.
- Besoni se njerëzit që i kanë shkruar jetojnë afër malit apo detit? Justifikoni përgjigjen tuaj dhe përsëri me vargjet dhe me njohuritë që keni për profesionet.

- Dëgjoni këngën e mëposhtme. Krahina në të cilën këndohet kjo këngë besoni se është afër detit apo në mal?

Le të lexojmë përkufizimin:

Kënga popullore si lloj letrar thith materialin e vet nga tradita letrare gojore, ajo që u zhvillua në një rajon gjeopolitik të gjerë të Ballkanit dhe lidhet me pamjet e aktivitetit shoqëror të asaj kohe.

www.el.wikipedia.gr

Midis aktiviteteve shoqërore të njeriut mund të vendosim dhe profesionet. Në bazë të këngëve që dëgjuat edhe të tjera që mund të gjeni, përpiquni të bëni hartën e Greqisë (e Shqipërisë) profesionet që prezantohen në këngët e secilës krahinë. Shikoni relievin e Shqipërisë:

- Cilat profesione që permenden në ushtrimin e mëposhtëm mund të lulëzojnë këtu?
- Si të ndihmoni relievin e hartës?
- Gjej këngët që permendin profesione dhe vendosi ato në hartë për të ndërtuar hartën muzikore të Shqipërisë.





♪ Dëgjoni këngët: E..4.3. «Në fushën e Sirgjiotit», A.11.22. «Karaguna».

♪ Kërko në internet dhe në enciklopedi dhe grumbullo fotografi dhe pamje nga veshjet tradicionale të të dy vëndeve. Fotografitë mund të vendosen në një pikturë dhe poshtë çdo fotografie të shkruhet vendi nga vjen dhe informacione të tjera. Kështu, do të realizohet një paraqitje e përgjithshme e veshjes tradicionale

♪ Dëgjoni këngën E.4.3. «Në fushën e Sirgjiotit» dhe bëj përshkrimin e veshjes tradicionale të vëndit tënd (shamia, futa, këmisha etj).



6. Dëgjoni këngët: E.4.3. «Në fushën e Sirgjiotit», Këngë: Kacalidhas Gr., «Një vajzë, një Leshniçote», Këngë popullore nga Epiri V., fq. 525.

Krahasoni rrugën e bërjes së një veshjeje në në të kaluarën dhe sot. Cilët profesionistë takojmë gjatë këtij procesi? Çfarë nevojash mbulonin atëhere veshjet dhe çfarë sot?

7. Të dëgjuara në gjithë botën janë qylymat e punuara me dorë të Lindjes. Sado që t'i admirojmë qilimat e Lindjes, nuk duhet të harrojmë se në disa vende për prodhimin e tyre punojnë fëmijë në kushte shumë të vështira...

Cili është mendimi i juaj për punën e fëmijëve?





Dëgjoni këngë: Kacalidhas Gr., «Vajza në avlimnet», Këngë popullore nga Epiri V., fq. 528. Ndërtoni qilimat tuaj. Në endjen e qilimave përsëriten disa motive. Gjeni informacione për qilimat e lashtë nga faqja e internetit të një muzeu të kulturës popullore.



8. Dëgjoni këngët: E.1.8. «Mallkim dimrit», A.8.9. «Një çoban lart të mal», E.4.2. «Vreshti im gjethegjerë», A.11.11. «Sukoj në mes të vreshtit». Këngët që dëgjuat u referohen profesione në të njëjta. Cilat profesione janë të njëjta? Çfarë konkluzione mund të nxirrni për jetën e përditshme në të dyja zonat?

Ndahuni në skuadra dhe grumbulloni emra dhe nofka,të cilat janë të lidhura me profesione dhe përpiquni të gjeni profesionistin, për të shkak të cilit iu dha mbiemri ose nofka brezave të ardhshëm. (mullixhi, rëpucari, kopshtar, çoban, furxhi, samarxhi, marangoz, berber).

**Muzeu i mjeshtërve epirotë të Pirsojanit**

Ndërtesa e gurtë e shkollës së Pirsojanit e cila u ndërtua në vitin 1927 u meremetua tani afër. Strehon Muzeun Etnollogjik të mjeshtërve Epiriotë, i cili përbën një ndihmesë të rëndësishme në historinë e panjohur të mjeshtërve Epiriotë të gurit. Muzeu përmban material të rrallë nga arti, gjuhan sekrete, udhëtimet, veglat, marrëveshjet dhe ndërtimet e mjeshtërve të gurit. Materiali që ekspozohet në muzeun e Mjeshtërve të Gurit të Pirsojanit, përbën një regjistrim të rëndësishëm të arkitekturës lokale, të materialeve të çdo krahine dhe të rrymave estetike të tre shekujve të fundit në Ballkan. Mbi 2500 fotografi, skica, fotografi ndërtimesh (ura, kisha, shkolla, këmbanore, xhami, kulla feneri, mullinj, punishte vaji, ndërtesa publike dhe private) nga gjithë Greqia dhe nga jashtë saj. Muzeu Etnollogjik i Mjeshtërve Epiriotë të Pirsojanit, përmban gjithashtu tapi dhe marrëveshje pune, dëftesë llogarish për ditët e punës, dëftesa borxhi dhe këmbime monëtare, pashaporta, ditare personale dhe korrespodenca me familjen, gjithashtu vegla të vjetra, skica veglash dhe skica të përdorimit të tyre me shënime dhe vërejtje të mjeshtërve të vjetër. Gjithashtu ka harta të rrugëve, të karvaneve në bazë të dëshmive të mjeshtërve të vjetër dhe të transportuesve. Së fundi, intervista dhe film dokumentar për jetën dhe teknikën e mjeshtërve.

Burim: http://www.geocities.com/Athens/Thebes/2912/grmuseum.htm

9. Dëngoni këngët:
E.4.3. «Në fushën e Sirgjiotit»,
A.12.2. «Aman mullixhi, more mullixhi».

Ndahuni në katër grupe dhe me makinën e kohës tranferohuni në dy epoka kohore të ndryshme. Skuadra e parë dhe e dytë në lashtësi ku punoni si baltëpunues në Greqi dhe në Shqipëri përkatësisht. Skuadra e tretë dhe e katërt transferohuni në të kaluarën e afërt, në fillim të shekullit të 20të dhe do të ushtroni profesionin e mullixhiut në të dyja vendet përkatësisht. Çdo skuadër të përshkruajë një ditë nga punët e saj të përditshme.Komentoni tekstet që do të shkruhen, gjeni ngjashmëritë dhe ndryshimet në profesionet në të dyja periudhat e ndryshme në dy vendet.

10. Dëngjoni këngët: E.9.1. «Unë isha djalë arkond», A.8.9. «Një çoban lart të mal». Dëgjojmë njerën pas tjetrës të dy këngët dhe mësojmë të kërcejmë më hapa. Për këngën shqiptare mund të gjeni brenda në këngë si quhet çobani?

11. Vizitë në një vendbanim tradicional.
(Burim: http://www.kpekonitsas.gr/index.htm)

| **Fletë pune për studimin e vendbanimit malor.** | | |
|---|---|---|
| Data e vizitës: | | |
| Emri i vendbanimit: | | |
| Vendi rreth fshatit | ☐ Ekzistojnë burime uji? | ☐ Ekzistojnë shtëpi të vjetra? |
| | ☐ Ekzistojnë pyje? | ☐ Diçka tjetër që më bëri përshtypje? |
| Vendbanim | ☐ Ekzistojnë kaldreme? | ☐ Ekzistojnë shtëpi të vjëtra? |
| | ☐ Ekzistojnë shtëpi moderne; | |
| | ☐ Cilat ndryshime vë re ndërmjet shtëpive të vjetra dhe moderne? | ☐ Cilat ngjashmëri vë re ndërmjet shtëpive të vjetra dhe atyre moderne? |
| Përshkrimi i shtëpisë së vjetër. | ☐ Cila është forma e shtëpisë? | ☐ Sa kate ka? |
| | ☐ Cila hollësi të tjera arkitekturore keni vënë re? | ☐ Cili kat ka më shumë dritare? |
| | ☐ Çatia nga ç' materiale është ndërtuar? | |
| Krahasimi me fotografitë nga vendi tjetër | ☐ Ngjajnë shtëpitë? | ☐ Materialet që përdorin janë të njëjta? |
| | ☐ Ekzistojnë kaldrëme? | ☐ Ekzistojnë kisha? |

Ndahuni në pesë skuadra. Secila skuadër merr përsipër të përjetësojë me aparat fotografik një kategori të mureve tradicionale në bazë të tabelës së mësipërme. Fotagrafitë do të përbëjnë materialin për një ekspozitë fotografie. Në bashkëpunim me ndonjë shkollë të vendit tjetër këmbeni materialin fotografik dhe pasuroni ekspozitën tuaj.

Vizitoni faqet e inertnetit: http://www.zagorama.com/zagori-gen/index-gr.html dhe http://www.galenfrysinger.com/gjirokaster.albania.htm. dhe shikoni videon (to the Museum City of Berat). Do të ndiqni një mori fotografish që vërtëtojnë arqitekturën e përbashkët në të dyja vendet.



12. Dëngjoni këngët: E.9.1. «Unë isha djalë arhond», A. «Krraba jote e qendisur».

**Muzeu i kulturës i Ag. Tolit (http://www.epirus.com/tolis/)**

Në fshatin tradicional Qipi i Zagorit një suprizë e madhe e pret vizitorin. Tri arkondoshtëpi strehojnë një koleksion prej afër 40.000 sendesh e një koleksionisti që ia kushtoi tërë jetën e tij për të shpëtuar trashëgëminë kulturore të krahinës më të bukur të Epirit të Zagorit dhe të krahinës më gjerë. Si do të shkoni: Përmes rrugës nacionale Janinë-Kozan, pas fshatit Karies (Metamorfosi), 19km larg nga Janina ktheheni për në Qipus. Rruga figuron në hartën më poshtë. Fshati Qipi është larg nga Janina 38km.
Telefoni i muzeut është: 26530 71826.

Në muzeun e mësipërm poshtë çdo sendi të ekspozuar ekzistojnë legjenda, të cilat japin informacion vizitorit me shprehje të shkurtra. Duke shikuar figurën dhe duke lexuar legjendën poshtë saj përshkruani çfarë shikoni.

Përgjegjësi i muzeut do t'ju kërkojë ta ndihmoni të shkruajë legjendat që do të vendosen poshtë secilës figurë. Lexoni përshkrimin për çdo send të ekspozuar dhe shkruani legjendën.



Baulle prej arre me fildisht. Lartë: një kazan, një gjym, një tenxhere.



Objekte të ndryshme dhe lloje të shtëpisë



..............................................

Këtu shikojmë se ka objekte të ndryshme të skalitura në dru të epokës së vjetër, të cilat i përdornin në jetën e tyre të përditshme. Disa nga ato janë për të prodhuar djathin, disa për të depozituar ujë dhe verë dhe të tjerat janë vegla që përdoren në punët bujqësore.



..............................................

Këtu shikoni sallonin e një shtëpie të shekullit të 19të. Qendismat që ekzistojnë janë punuar me dorë. Në mur shohim se janë të varura gravura të ndryshme dhe fotografi mbretërish. Mobiljet e druskalitura dhe sendet prej argjendi dhe ndriçuesit janë tregues të mjeshtërve të shkëlqyer të prefekturës së Janinës.



........................................................



........................................................

Në figurën e mësipërme shikojmë Olia Pabanu, e cila u fotografua duke veshur një veshje tradicionale nga fshatrat e Zagorit. Veshja ka ngjyrë të kuqe.

Këtu shikojmë se ekzistojnë sende të artit popullor, sende të ndryshme të vlefshme por dhe objekte dekorativë. Dyshemeja është shtruar me qylym që e sollën nga Lindja, i cili i përket shekullit të dhjetë.







13. Fotografitë e mëposhtme paraqesin objekte dhe veshje nga krahina e Shqipërisë së Jugut.

- Ngjajnë me objektet e muzeut të Ag.Tolit?
- Prisni fotografitë dhe i vendosni ato pranë atyre të muzeut me të cilat ngjajnë?

14. Nëse doni të mësoni më shumë për profisionet mund të lexoni librate mëposhrëm.


- Andonis Samarakis, «Në një stacion kufitar», Kërkohet shpresë-Shenjë rreyiku, Athinë, 1996, Estia.
- Jeorgjios Andonakis, «Buka më e ëmbël», Athinë, 2002, Akritas.
- «Peshkatarët që zunë një gur» fabul e Ezopit.
- «Ndonjëherë hedhin rrënjë dhe fjalet», përrallë popullore.
- Valasi Zoi, «Tregtari I nuditshmëm vogëlsirash», Diell, diell dhe shi, Athinë, 1982, Kedros.
- Hahn Johan Georg Von, «Yoti Lazaros dhe dragonjitë», Contes Populaires Grecs, Athinë, 2002, Karavia, D. N. – Anastatikes Ekdoseis.
- Shoqëri Latrare e grave, «Profesione të vjetra», Athinë, 2006, Kedros
- Haxikokalaki Sofia, «Profesione të vjetra që nuk ekzistojnë më», Ikonograf: Diamanti-Meletiu Violeta, Athinë, 2006, Kedros.
- Speis Jorjos, Paleologou Katerina, «Një mulli vaji në Alonisso», Ikonograf: Drakos-Dranis Janis, Athinë, 2005-6, Kedros.
- Speis Jorjos, Paleologou Katerina, «Një mulli uji në Xia», Ikonograf: Platanioti Dona, Athinë, 2006, Kedros.
- Speis Jorjos, Paleologou Katerina, «Melisanthi dhe bletët», Ikonograf: Drakos-Dranis Janis, Athinë, 2005, Kedros.
- Ganeri Anita, «Mësoj profesionet», Ikonograf: Jobs People Do, Athinë, Savalas.
- Haximanoli Anna, «Profesionet», Ikonograf: Moshopulos Viktor, Selanik, 2001, Kirki.
- Vasilopulu Maria, «Mjeshtër të një epoke tjetër. Për nxënës të shkollës fillore», Athinë, 2005, Muzeu Benaki.

# mërgimi

1 2 3



Qysh në lashtësi deri në ditët tona mërgimi shoqëron fatin e njerëzve. Nga lëvizjet e viteve prohistorike, gjatë të cilave racat e ndryshme të njerëzve ishin të detyruara të emigroheshin nga një vend tek tjetri duke u përpekur të mbijetorin, deri tek emigrantët e dekadave të fundit, dhembja e çrrënjosjes është e njëjtë.



Kjo dhembje u shpeh me mjetin kryesor shprehës të kulturës popullore, që është kënga. Këngë plot brenga, shpresa dhe ëndrra për ata që ikën dhe për ata që mbeten.

Le të ecim bashkë nëpër shtigjet e mërgimit nëpërmjet këngëve popullore të të dyja zonave!

## 1. Le të luajmë!

Ndahuni në katër grupe (numri i grupeve varet nga numri i nxënësve që ka një klasë).çdo grup zgjedh një pikë të klasës, ku krijon lagjen e tij.
Çdo lagje përveç shtëpive dhe frinjëve të saj do të mund të kishte: një emër, furrën e saj, dyqanin e bakallit etj. Mund të mendosh dhe diça tjetër që ka lagjja juaj?

Në vazhdim paraqitni lagjen që krijuat tek nxënësit tuaj. Një fëmijë nga ju ose mësuesi ose mësuesja juaj bën postierin. Çdo grup zgjedh një send nga lagjja e tij dhe ia jep postierit me marrës një nga lagjet e bashkënxënësve të tij. Postieri ndan sendet dhe çdo grup duhet të parashikojë cili mund të jetë dërguesi.

Mbyllni sytë tuaj. Një fëmijë nga një lagje, ngrihet dhe i afrohet lagjes që do, duke thënë shprehjen: «Na gostit!». Qëllimi i lojës është të dalloni zërin e bashkënxënësit ose të bashkënxënëses suaj dhe të thoni nga ç'lagje vjen (njohja dhe identifikimi i tingullit).

Hapni sytë... Edalluat?
E mirëpresin në lagjen tuaj. Vazhdoni kështu, sa të krijohen lagje të reja.



## 2. Lagjet këndojnë

Dëgjoni këngën. Çfarë tregon fjala qeras? Kur qerasim dikë?

*Në këtë shtëpi që erdhëm (na gostit,na gostit)*
*të hamë dhe të pimë (eja të qerasësh, të kalosh mirë),*
*ne këtu nuk erdhëm (na gostit, na gostit)*
*të hamë dhe të pimë (eja të qerasësh, të kalosh mirë).*
*Edhëm të argëtojmë (na gostit, na gostit)*

*shumë vjet të themi (eja të qerasësh, të kalosh mire)*
*dhe i zoti i shtëpisë (na gostit, na gostit)*
*shumë vjet të jetojë (eja të qerasësh, të kaloshmirë).*

Mësojmë të këndojmë këngën e mësipërme të gjithë së bashku, si një lagje.

3. Dëgjoni këngën e mëposhtme:

*Të kisha një postier, ta kisha ndihmës,*
*të pyes për zogun tim si kalon vetëm.*
*Ja, vjen një zog me krahët hapur*
*dhe i them turtull (i bukur), si kalon në mergim*
*dhe i lidh në qafë me pe letrën*
*dhe i them turtull (i bukur) ki kujdes të mos humbi,*
*Ku të gjesh dy selvi dhe në mes një ulli,*
*Atje brenda, turtull (i bukur), të shkundësh krahët.*

- Të dyja lagjet që sjell letrat postieri i këngës është kaq afër sa tuajat?
- Nga cilat fjalë të këngës duket kjo?
- Çfarë do të thotë mërgim?

4. Dëgjoni këngën e mëposhtme.

*Jani im, Jani im, hajde Jani im, shaminë tënde, eja, ç'e ke të ndyrë?*
*E ndoti mërgimi, të shkretat vende të huaja*
*Pesë lumenj e lanë dhe shtëruan dhe të pestë.*

Ekziston një fjalë e përbashkët në të dyja këngët «Të kisha një postier» dhe «Jani im, shamia jote». Cila është kjo?

Kjo fjalë na tregon për cilën arsye janë shkruar të dyja këngët. Dëgjojini tani dhe përsëri me kujdes. Gjeni ç'të përbashkët tjetër kanë përveç fjalës së përbashkët:

- Janë të shpejta apo të ngadalta?
- Ekzistojnë vegla muzikore që shoqërojnë këngëtarët?
- Këndojnë burra,gra apo dhe të dy?
- Ç' emocion besoni se ndjejnë ata kur këndojnë: gëzim, hidhërim, mallëngjim?
- Zgjidhni ose shtoni nëse besoni ju se ëshutë i domosdoshëm dhe ndonjë emocion tjetër.




5. Kënga «Lule, moj lule» vjen nga një fshat i Shqipërisë. Dëgjojemi më parë pa lexuar fjalët e këngës. Dëgjoni tani përsëri këngën «Jani im, shamia jotë» dhe i krahasoni:

- Janë të ngadalta apo të shpejta?
- Këndojnë burra, gra apo dhe të dy?
- Ekzistojnë vegla muzikore që shoqërojnë këngëtarët?
- Ç'emocione besoni se ndjejnë ata që i këndojnë?

Këtu ju kemi përkthyer fjalët e këngës. Dëgjojeni përsëri, duke pasur para jush përkthimin.

*Lule, moj lule*
*Lule ku do të shkosh.*
*Larg,në vende të huaja*
*Lule, moj lule*



*Lule çfarë do të më sjollësh.*
*Një degë lajthie.*

Në këngë I flet një grua burrit të saj.

- Si e mbiquan?
- Mund të dallosh si është fjala «lule» në gjuhën shqipe?
- Ç'i thotë?
- Ku mendoni se shkon burri i saj?
- Me cilën fjalë nga greqishtja që dëgjuat mund të zëvendesori shprehjen në vende të huaja?
- Për cilën gjë flasin të dyja këngët?
- Çfarë mund të themi për të dy popujt?




6. Dëgjoni кëngët: E.9.15. «Ikën, ikën levendi im» dhe Shqip: «Për ku u nise të shkosh». Në këngët bëhet dialog d.m.th. kemi dy ose më shumë veta që flasin midis tyre. Bëni dhe ju një dialog të shkurtër, në të cilin do të bashkëbisedoni me ndonjë bashkënxënësin tuaj. Kini kujdes çdo herë që ndryshon përsonazhi që flet të mos harroni të vini **vizë**.

7. 716: Gr. Kacalidhas, «Tani është prill ç' gëzim», Këngë popullore nga Epiri V., Dropull, f.499.
120: Gr. Kacalidhas, «Dallëndyshet e marsit», Këngë popullore nga Epiri V., f.123.

Shikoni figurat e mëposhtme dhe diskutoni nëse emigrimi është karakteristikë vetëm për njerëzit apo është karakteristikë e shumë kafshëve.







- Mund të plotësoni figura kafshëve të tjera që jetojnë në të dyja anët e kufirit dhe emigrojnë?
- Përmendni arsyet për të cilat emigrojnë kafshët dhe zogjtë etë dyja krahinave p.sh. lejleku emigron për të gjetur ushqim.

8. Dëgjoni këngët: E.13.5 «Tani është maj dhe pranverë», E.14.13 «Si të them keni shëndet», 584: Gr. Kacalidhas, «Mërgimtari u mërgua», Këngë popullore nga Epiri V., Pogon-Kardikaki I Delvinës, f. 417.

- Dëgjoni këngët dhe diskutoni për cilat nga arsyet e emëgrimit të kafshëve përbëjnë dhe shkaqet e emigrimit të njerëzve.
- Ekzistojnë dhe arsye të tjera për të cilat njerëzit ikin nga Greqia ose nga Shqipëria?



## 9. Njohim prejardhjen tonë

Plotësoni pemën gjenealogjike. Në çdo degë shkruani emrin tuaj dhe vendin e prejardhjes suaj. Vëreni pemën gjenealogjike të familjeve tuaja.

- Pjesëtarët e familjes suaj banojnë në po atë vend nga i cili kanë prejardhjen?
- Gjatë ecurisë u paraqit nevoja të lëvizin disa pjesëtarë?
- Mos vallë të gjithë jemi «të huaj»?

1. Le të luajmë!

Ndahuni në katër grupe. Çdo grup merr përsipër të paraqesë një pjesë gjeografike të Greqisë ose të Shqipërisë dhe zgjdh nje vend në klasë, ku krijon zonën që do të paraqesë. Grupe mund të paraqesin:

- Hartën politike dhe gjeografike të zonës
- Pjesët më karakteristike
- Prodhime vendi
- Veshje lokale
- Muzikë dhe valle nga zona
- Mund të mendosh dhe diçka tjetër që karakterizon zonën tuaj?

Në vazhdim paraqitni punën tuaj tek bashkënxënësit tuaj.

①


②


③


④


⑤


⑥



2. Vëreni me kujdes fotografitë.

Cilat nga veglat e mësipërme mund t'i dallosh? Gjeji dhe të tjerat duke kërkuar informata dhe fotografi në enciklopedi ose në internet.

3. Çdo zonë ka muzikën e saj tradicionale dhe veglat e saj karakteristike me të cilat ekzekuton atë muzikë. Të gjeni me grupin tuaj informata për muzikën tradicionale të zonës që keni marrë përsipër dhe t'i paraqitni. Sipas informatave që gjetët vendosni veglat muzikore të fotografisë në zonat që i takojmë.

- Dëgjoni me kujdes këngët nga cd. Mund të gjeni nga veglat që dëgjoni nga cilat zona të Greqisë vijnë?

4. Dëgjoni këngën e mëposhtme:

*Të kisha një postier, ta kisha ndihmës,*  
*të pyes për zogun tim si kalon vetëm.*  
*Ja ku vjen një zog krahëhapur*  
*dhe i them :turtull (i bukur) si kalon në mëgrim*  
*dhe i lidh në qafë një letër me një pe*  
*dhe i them: turtull (i bukur), ki kujdes mos të humb,*  
*ku të gjesh dy selvi dhe në mes një ulli,*  
*atje brenda, turtull (i bukur), të shkundesh krahët.*

- Mund të thoni përmbajtjen e këngës?
- Cili flet dhe në cilin flet? Ç'i thotë?

Kënga i takon një kategorie këngësh që i themi **«këngë kurbeti»**. Ai që flet është vetë i mërguari ose ka ndonjë njeri që është në mëgrim.

- Nga cilat vende e kuptoni?

## Le të luajmë!

Një fëmijë nga ju ose edhe mësuesi ose mësuesja juaj bën postierin. Çdo grup zgjedh këngën nga zona e tij dhe ia jep postierit me marrës njërën nga krahinat e bashkënxë-nësve tuaj. Postieri ndan këngët dhe çdo grup duhet të parashikoj kush është dërguesi. Në vazhdim, flet për këto këngë duke u përpjekur të kujtohet dhe të dallojë veglat që dëgjohen. Fiton grupi që do të mbajë mend sa më shumë të dhëna!



«...dhe i lidh në qafë një letër me një pe...

- Cila mënyrë komunikimi përmendet brenda në këngë?
- Është në të vërtetë kjo një mënyrë komunikimi?
- Njihni mënyra të tjera të ngjashme?
- Cilat janë sot mënyrat e komunikimit midis njerëzve?

Çdo grup të zgjedh njërën nga mënyrat me qëllin që të flasë për gjërat pozitive dhe negative të çdo mjet komunikimi. Në vazhdim, të shkruani letra, e-mail, telegrame dhe mesazhe që të komunikoni me ndonjë të afërt ose ndonjë mik.

5. Dëgjoni këngën e mëposhtme:

*-Jani im, Jani im, hajde, Jani, im shamia jote, eja,*
*ç'e ke të ndotur?*
*E ndoti,mërgimi, të shkretat vendet e huaja.*
*Pesë lumenj e lanë dhe u ndotën dhe të pestë.*




Ekziston një fjalë e përbashkët në të dyja këngët«Të kisha një postier» dhe «Jani im, shamia jote». Cila është kjo fjalë?

Kjo fjalë na tregon për ç'arsye janë shkruar të dyja këngët. Dëgjojini tani përsëri me vëmendje. Përveç fjalës së përbashkët, gjeni ç'të përbashkët tjetër kanë:

- Janë të ngadalta apo të shpejta?
- Ekzistojnë vegla muzikore që shoqërojnë këngëtarët?
- Këndojnë burra, gra apo të dy?
- Ç' emocione besoni se ndjejnë këta që i këndojnë: gëzim, hirdhërim, mallëngjim?

- Zgjidhni ose shtoni nëse besoni ju se ëshutë i domosdoshëm dhe ndonjë emocion tjetër.

6. Kënga «Lule, moj lule» vjen nga një fshat i Shqipërisë. Më parë dëgjoni pa lexuar fjalët e këngës. Dëgjoni tani përsëri këngën «Jani im, shamia jote», dhe i krahasoni:

- Janë të ngadalta apo të shpejta?
- Këndojnë burra, gra apo dhe të dy?
- Ekzistojnë vegla muzikore që shoqërojnë këngëtarët?
- Ç' emocione besoni se ndjejnë ata që i këndojnë?

Lexoni vargjet. Dëgjoni përsëri këngën, duke pasur vargjet.

*-Lule, moj lule,*
*Lu ku do të shkosh.*
*-Larg, në vendet e luaja*
*Lule, moj lule.*
*-Lule ç'do të më sjellësh?*
*-Një degë lajthie.*

- Në këngë i flet një grua burrit të saj. Si e mbiquan?
- Ç'i thotë?
- Ku mendoni se shkoi burri i saj?
- Me cilën fjalë nga greqishtja që dëgjuat mund të zëvendesoni shprehjen «në vendet e huaja»?
- Për cilën gjë flasin të dyja këngët?
- Çfarë mund të themi për të dy popujt?

7. Këngët që dëgjuat flasin për mëgimin. Lexojmë nga fjalori kuptimin e termave mëgrim dhe emigrim:

Mërgin: Largimi nga atdheu dhe vendosja në vend të huaj.

Emigrim: Lëvizja përsonale ose me grupe nga atdheu në qytet tjetër ose në vend tjetër.

Fjalor J. Babinjoti

Si quajmë dy fjalë që kanë kuptim të përafërt?
Nëse ke fjalor, kërko dhe ty të njëjtat fjalë dhe të tjera që formohen prej tyre, si *emigrant, i mërguar, emigroj, mërgohem.*

8. Kur flasim për emigrimin, takojmë dy forma emigrantësh: të brendshëm dhe të jashtëm. Lexoni historitë e mëposhtme.Mund të parashikosh kush është emigrant i brendshëm dhe kush i jashtëm?

a. Të tre vëllezërit Frashëri

Të tre vëllezërit Frashëri ishin figurat kryesore të Rilindjes kombëtare. Njëri politik, tjetri poet dhe i treti filozof.Lindën në Dangëlli të Frashërit, studiuan në Zosime të Janinës dhe vdiqen në Konstandinupojë.

b. Odisseas Elitis

Odisseas Alepudelis ashtu si ishte emri i tij i vërtetë, lindi më 2 nëntor 1811 në Iraklio. Origjina e tij –nga të dy prindërit— ishte nga Mitilini. Në Kretë kishin ardhur nga viti 1895, kur Panagjotis Alepudelis dhe vëllai i tij Thrasivullos vendosën të ndërtojnë një fabrikë sapuni. Pak vjet më vonë familja u vendos në Pirea, ku sollën dhe kadedrën e ndërmarjes së sapunit të prindëritve të tij.

c. Aleksandër Moisiou

Lindi në Kavajë dhe u rrit në Durrës.Në moshën 19 vjeçare shkoi në Vjenë ku iu përkushtua aktrimit. Në 1898 e nisi karrierën e vet që përfshin tërë shpektrin e literaturës evropiane dhe të teatrit, duke filluar që nga tragjetia antike greke.

d. Jeorgjios Papanikolau

Lindi në Kimi, në 1883. Gjermania ishte vendi i parë që e mahniti. Atje, veç filozofisë kishte mundësinë më të madhe të merrej me Biologji. Pak vjet më vonë ikën për në Amerikë. Atje, i varfër emigrant i panjohur u zhvillua vrullshëm në formë heroike. Nga nëpunës dyqani dhe gazetar në gazetën greke në fillim, me vështirësi fitoi një vend në Laboratorin e Anatomisë të Universitetit Columbia dhe më vonë një vend në Cornell të Nju Jorkut. Punon natë e di të duke vënë në energji mundësitë e tija të pakufishme.

Jepni nganjë përkufizim për se cilin nga termat: **emigrat i brendshëm** dhe **emigrant i jashtëm**. Për cilat arsye figurat e mësipërme emigruan?

9. Dëgjoni këngët e mëposhtme:

***Aleksandra***

*Pse qëndron e mërzitur, moj Aleksandra,*
*Hajde, pse qëndron e qarë,moj e qarë?*
*Mos je nga era? moj Aleksandra?*
*Hajde,mos je nga veriu,nga veriu?*
*- As nga era jam, levend,*
*hajde, as nga veriu,*
*por vetëm nga ti,more levend,*
*hajde, që shkon në mëgrim, në mëgrim.*

Si quhet heroina e këngës? Pse është e mërzitur dhe qan?

**Si të them keni shëndet**

*Si të them keni shëndet*
*që nuk më lë zemra*
*të kesh gjynahun ,nëna ime*
*që kaq larg më dhe.*
*Nëntë lumenj kalova*
*dhe nëntë të tjerë kam pa kaluar*
*dhe këtu kam mall dhe atje kam mall.*
*Këtu kam mall për babanë tim*
*atje kam mall për vjehirrin.*
*Këtu kam mall për nënën time*
*atje kam mall për vjehrrën time.*
*Këtu kam mall për vëllezërit e mi*
*atje kam mall për vëllezërit e burrit tim*
*Si të them keni shëndet*
*që zemra nuk më lë?*

- Për ç'arsye imagjinoni se iku nga shtëpia e saj heroina e këngës?
- Për ç'gjë flasin dhe të dyja këngët?
- Mund të imagjinoni tek të dyja këngët kush është emigranti i brendshëm dhe kush i jashtëm?

10. Dëgjoni këngë: A.4.6. «Për ku u nise të arrish».

Ndahuni në grupe. Me ndihmën e mësuesit tuaj ose të mësueses suaj, bëni një fletëanketë, të cilën do ta vlerësoni për të bërë një kërkim tek njerëzit e afërm, tek miqtë dhe tek fqinjët tuaj. Qëllimi i kërkimit do të jetë të zbuloni sa dendur emigrojnë njerëzit dhe për ç'arsye.

Ju propozojmë fletëanketën e mëposhtme. Mund të shtoni ose të hiqni pyetje.
Suksese!

1) Keni lindur këtu? A. Po B. Jo

2) Babai juaj ka lindur këtu? A. Po B. Jo

3) Nëna juaj këtu ka lindur? A. Po B. Jo

4) Keni ndonjë njeri që nuk jeton në vendin e lindjes? A. Po B. Jo

5) Nëse u përgjigjet JO në ndonjë pyetje,mund të na thoni për ç'arsye ikët ju ose njerëzit e afërm nga atdheu juaj?

A. Për të gjetur punë më të mirë (ekonomike)
B. Sepse atje u martova (shoqërore)
C. Tjetër

Nëse në rezultatet tuaja zbuluat se ekzistojnë njerëz që vijnë nga zonat e tjera të vendit tuaj ose dhe nga vendet e tjera, kërkojuni t'ju këndojnë një këngë nga vendi i tyre dhe inçizojeni.

11. Dëgjoni këngën:

*Në këtë shtëpi që erdhëm (gostit na, gostit na)*
*të hamë dhe të pimë (hajde të qerasësh, të kalosh mirë),*
*ne këtu nuk erdhëm (gostit na, gostit na)*
*të hamë dhe të pimë (hajde të qerasësh, të kalosh mirë).*
*Erdhëm të dëfrejmë (gostit na, gostit na)*
*shumë vjet të themi (hajde të qerasësh, të kalosh mirë)*
*dhe i zoti i shtëpisë (gostit na, gostit na)*
*shumë vjet të rrojë (hajde të qerasësh, të kalosh mirë).*

Ç' tregon fjala qeras?

- Kur qerasim dikë ?
- Mësoni të këndoni në mënyrë kolektive,të ndarë në dy grupe, këngën e mësipërme.

12. Gr. Kacalidhas, «Zogu im i mërguar», Këngë popullore nga V. Epiri, f. 400.

Shikoni figurat e mëposhtme dhe diskutoni nëse emirgimi u perket vetëm njerëzve apo është edhe karakteristikë e kafshëve? (Mund të plotësosh figurat e kafshëve që jetojnë në të dyja anët e kufijve dhe emigrojnë). Përmendni arsyet e mundshme për të cilat emigrojnë kafshët dhe zogjtë e të dyja zonave.









13. Dëgjoni këngët: E.13.5. «Tani është maj dhe pranverë».

Qysh në antikitet deri në ditët tona banorët e të dyja zonave u detyruan të marrin rrugëm e mërgimit. Lëvizjet e popullsive në Greqinë antike detyruan disa fise greke të emigrohen. Eolët, Ionët dhe Dorikët u vendosen në ishujt e Egjeut lindor dhe në Azinë e Vogël dhe në vende të tjera të Mesdheut. Invazioni i Turqve në Shqipëri detyroi shumë shqiptarë, sidomos banorë të qyteteve dhe të fshatrave të shkatëruara,të mërgonin në zona të ndryshme të Italisë, të cilat nuk kishin rënë nën sundimin turk. Numri i të mërguarve llogaritet të ketë arritur në rreth 200.000 veta.

- Cilat nga arsyet për të cilat emigrojnë zogjtë, mund të jenë shkaqe dhe arsye dhe për emigrimin e njerëzve?
- Ekzistojnë dhe arsye të tjera,për të cilat njerëzit ikin nga Greqia ose nga Shqipëria?

14. Degjoni këngë: A.4.6. «Për ku u nise të arrish?» Njerëzit që ndërruan vendbanimin morën me vete një valixhe të mbushur me ëndërra. Bagazhet e tyre nuk kishin vetëm rroba dhe çdo gjë tjetër që u duhej. Mbartnin me vete dhe elemente të tjera të kulturës së tyre.

- Shënoni ndikimet që pranoi zona juaj (zakonet e të ushqyerit, këngët dhe të dhëna të tjera të kulturës).

Çdo popull rreth Mesdheut sipas prodhimeve që prodhonte vendi i tij dhe imagjinata e tij, krijoi recetat e veta. Detarët,udhëtarët,të arratisurit dhe emigrantët mbartnin në bagazhët e tyre shijet më të mira që kishin provuar.

Me ndihmën e mësuesit të muzikës, të edukimit fizik, të mësuesit tuaj dhe të mesueses suaj,organizoni një festë në fund të vitit, në të cilën do të paraqesni këngët që keni inçizuar në kërkimin tuaj me këngët tradicionale të zonës, në të cilën banoni të gjithë bashkë. Mund të kërkoni dhe të paraqesni me të njëjtën mënyrë valle, veshje tradicionale dhe receta lokale.

Festa mund të mbyllet me këngën «Gostit na».



Ekzistojnë tri elemente të përbashkëta në të ushqyerit e të gjithë popujve të mesdheut: buka, vaji, vera.

Vëreni fotografitë e mëposhtme që vërtetojnë pretendimin e mësipërm. Gratë e fotografisë, jetojnë në vende të ndryshme, por kanë dhe një element të përbashkët. Jetojnë rreth Mesdheut. Bluajnë grurin, për të marrë miellin që u duhet për bukën, karakteristikën themelore e të ushqyerit e tyre. Kërkoni të gjeni ngjashmëri dhe ndryshime në të trija fotografitë.

Përpiquni të gjeni të dhëna (fabula, fotografi, këngë, zakone), për të mbështetur pretendimin e mësipërm për vajin, verën ose atë që kanë të përbashkët në zakonet e të ushqyerit të popujve të Mesdheut.



Shqipëria



Tinisia



Greqia

15. Vështroni hartën e mëposhtme. Mund të nxirrni disa konkluzione për të dhënat gjeomorfologjike të zonës? Për klimën, për punën e njerëzve?

Shënoni morfologjinë e tokës së zonës në të dyja anët e kufijve.




© Googlemaps

| male | lumenj | fusha |
|---|---|---|
| .................................... | .................................... | .................................... |
| .................................... | .................................... | .................................... |
| .................................... | .................................... | .................................... |
| .................................... | .................................... | .................................... |
| .................................... | .................................... | .................................... |
| .................................... | .................................... | .................................... |

klimën e zonës ....................................................................

largësia nga deti ....................................................................

lartësia nga nivelli i detit të zonës ....................................................

male që ndikojnë në erërat dhe shirat ...................................................

16. Për komunikimin me të afërmit e tyre, në atdheun e tyre,emigrantët përdornin letrat. Sot me ç' mënyra komunikojmë?

Çdo grup do të zgjedhë njërën nga mënyrat me qëllim të flasë për gjërat pozitive dhe negative në çdo mjet komunikimi. Në vazhdim do të shkruajmë letra, e-mail, telegrame dhe mesazhe, me qëllim të komunikojmë me bashkënxënës të shkollës të vendit fqinj.

## 1. Le të luajmë!

Ndahuni në katër grupe. Çdo grup merr përsipër të paraqesë një vend dhe zgjedh një pikë të klasës ku krijon «vendin» e tij. Çdo vend mund të paraqesi:

- Hartën e tij politike dhe gjeofizike,
- Flamurin e tij,
- Gjuhën e tij,
- Kuriozitete të rëndësishme,
- Prodhime lokale,
- Veshje lokale.

Mund të mendosh dhe diçka tjetër që karakterizon vendin tënd?

Në vazhdim paraqit karakteristikat e vendit tënd tek bashkënxënësit e tu. Një fëmijë nga ju (ose edhe) mësuesi ose mësuesja juaj bën postierin. Çdo grup zgjedh një element nga vendi i tij dhe ia jep postierit, me marrës një nga vendet e bashkënxënësve të tij. Postieri ndan sendet dhe çdo grup duhet të parashikojë kush është dërguesi.

## 2. Vendet ngatërrohen

Mbyllni sytë tuaj. Një fëmijë nga një vend,duhet të ngrihet dhe t'i afrohet cilit vend do dhe të thotë «mirëmëngjes» në gjuhën e vendit të tij duke dhënë dhe një element nga kultura e tij.

Qëllimi i lojës është të dalloni fillimisht vendin nga i cili vjen bashkënxënësi juaj duke u bazuar në gjuhën me të cilën ju ka pëshëndetur dhe në vazhdim në zërin e tij.

Hapni sytë...

E dalluat? E mirëprisni në vendin tuaj. Vazhdoni kështu,deri sa të trazohen elementet kulturore të vendeve dhe të krijohen vende ndërkulturore.

## 3. Me pretekst gërnetën

Vëreni figurën. A besoni si mund të luajë ndonjeri muzikë me gërnetë?




Çdo vegël, sipas mënyrës së prodhimit të tingullit renditet në një familje. Kështu u krijuan katër familje të veglave muzikore:

1) **aerofonet**, që vlerësojnë në përgjithësi **ajërin** për të prodhuar tingullin,
2) **kordofonet**, në të cilat tingulli prodhohet nga goditja e **kordës**,
3) **membranofonet**, që prodhojnë tingullin nga goditja e **membranës** se tendosur,
4) **idiofonet**, të cilat prodhojnë tingullin ose zhurmat me lëkundjet e **trupit** të tyre.

Veglat që lexoni më poshtë, janë ngatërruar dhe do secila të shkojë

në familjen e saj. Përpiqu t'i ndihmosh.

violinë
fyell
ksilofon
daulle
harpë
dajre

aerofonët
kordofonët
membranofonët
idiofonët

saksofon
flaut
kitarë
matalofon
kambana
tambur

Pas shekullit të 20të, lindi dhe një familje e re, elektrofonet, në të cilat për të prodhuar tingullin është i domosdoshëm përdoromi i elektricitetit. Mund të mendosh ndonjë vegël tjetër elektrofone?



4. Gërneta udhëton...

Njerëzit si bënit edhe ju në lojën e mëparshme me vendet, me udhëtimet e tyre, mbartnin me vete dhe elemente të kulturës dhe traditës së tyre. Shumë prej tyre u pëlqyen kaq shumë popujve që prisnin udhëtarët–mërgimtarët që me kalimin e kohës i inkuadronin në kulturën e tyre. Le të shohim historinë e gërnetës tradicionale në Greqi:

*«Gërneta si vegël klasike muzikore, vjen në Greqi nga Turqia me Turkoevgjitët,rreth viteve 1835. U shfaq për herë të parë në Greqinë Veriore, në Epir dhe në Maqedoninë Përendimore, dhe vazhdon më poshtë. Bashkë, fillimisht me violinë dhe flautin dhe më vonë dhe me sandurin përbëjnë kompaninë kryesisht formë muzikore popullore që zëvendeson ngadalë-ngadalë sazet tradicionale daullen-zurnanë. [...]*
*Gërneta përbën stacionin e fundit në ecurinë e muzikës organike në aerofonet e reja greke. Forma e saj e sotme është zhvillimi i një vegle të vjetër popullore që quhej*

*chalumeau ose zambanore. Tingulli prodhohet nga një gjuhë e thjeshtë prej kallami (kallam) që gjendet në gojën e veglës. Rol të rëndësishëm në teknikën e gërnetës luan fryrja. Me shtypjen përkatëse në kallamin e pjesës gojore të veglës ngrihet ose ulet lartësia tonike e çdo tingulli, kurse «shkarja» e tingujve (glisanto) mund të bëhet dhe me fryrje dhe me gjishtat.*
*Gjatë kohës që u shfaq për herë të parë gërneta, rreth vitit 1835, kënga popullore ka mbyllur në thelb ciklin e saj krijues. Për hir të teknikave të mëdha dhe mundësive shprehëse në krahasim me zurnanë —ku ngadalë ngadalë e menjanon— gërneta merr shpejt vendin e parë midis veglave melodioze. Dallohet si vegël kombëtare dhe në duart e muzikantëve të denjë bëhet kryesisht vegël muzikore shprehëse ne Greqinë epirote. Me gërnetën melodia popullore përjeton një periudhë të re të shkëlqyer në sektorin e muzikës organike. Sepse ajo që karakterizon kryesisht këngën popullore në 150 vjetët e fundit, nuk është krijimi i melodive të reja,por përpunimi i të vjetrave. Dhe në këtë sektor roli i gërnetës ishte vendimtar. Gërneta përbën njërin nga konfiçentet më përfaqësues dhe mbartësit e idesë që karakterizon këngën popullore në 150 vitet e fundit.»*

*«Enciklopedia e veglave popullore muzikore», Fivu Anojanaki.*

- Nga cili popull erdhi në Greqi gërneta?
- Kur u shfaq për herë të parë në Greqi dhe ku?
- Si prodhohet tingulli nga gërneta?

Gërneta nuk përdoret vetëm në muzikën tradicionale, por edhe në atë që e quajmë klasike. Është nga veglat që kanë mundësi,sipas llojit që do të ekzekutojë muzikanti, të prodohoijnë dëgjime të ndryshme. Kur gërneta ndodhet në një orkestër klasike muzikore, quhet klarinetë.

*Klarineta erdhi se rezultat i zhvillimit të mëtejshëm të veglave të vjetra të përafërta. Bibliografia përmend si paraardhës të klarinetës veglën franceze me fryrje chalumeau, që do të thotë «kallam», në të cilin gradualisht u shtruan një radhë çelësa. Stacion kryesor përbën shtesa nga gjermani Johan Kristof Denner e çelësit pranë vrimës së veglës në pjesën e pasme (në gjuhën greke quhet edhe «shpirt»). Nga fillimi i shekullit të 19të, klarineta,duke pasur një formë shumë të ngjashme me të sotmen, gjeti vendin e saj në orkestrën simfonike. Më 1839, francezi Iakinthos Kloze rregulloi çelësat duke sjellë klarinetën në formën me të cilën është sot në përgjithësi e njohur. (www.el.wikipedia.org)*

Dhe në cilat vende kaloi gërneta? Si e quajmë llojin e muzikës që luajmë me klarinetën në këto vende?

Më 1492, Kristofor Kolombo zbuloi një kontinent të ri, Amerikën. Banorët e parë të Amerikës ishin Indianët, por shumë shpejt vendi u bë territor emigrimi për popujt nga gjithë Evropa, të cilët mbartnin me vete doket, zakonet dhe traditat nga atdheu i tyre. Në shekujt që vijuan deri sot, u takuan shumë elemente të ndryshme kulturore. Ky takim krijoi shumë herë lloje të reja në sektorin e arteve.

*Xhazi u shfaq si lloj muzikor i njohur dhe i veçantë rreth vitit 1900. Konsiderohet e dhënë se vendosja e themeleve të muzikës xhaz janë afrikane. Skllevërit me ngjyra, që – vijnë nga Afrika perëndimore – u transportuan në jug të Shteteve të Bashkuara dhe mbartën me vete pjesë nga traditat e tyre. Midis tyre takojmë zakone të adhurueshme, edhe karakteristika muzikore afrikane si vështirësia ritmike dhe shkallët muzikore abstrakte. U mbartën dhe disa lloje këngë dhe forma muzikore si polifonia dhe improvizimi [...]. Në muzikën xhaz nga veglat kryesore ishin në fillim klarineti,paralelisht me trombonin/kornetën. Me kalimin e kohës mbizotëroi në preferencat sakzofoni.* *(www.el.wikipedia.org)*

- Si quhet lloji i ri muzikor që u krijua në Amerikë?
- Si u krijua?
- Me ç'mënyrë imagjinon se arriti gërneta/klarineta në Amerikë?

5. Shënoni në hartën e mëposhtme zonat, nga të cilat gjete se kaloi gërneta. Mund të paraqitni me ndihmën e hartës si lindi muzika xhaz?



Ndahuni në tri grupe.
Çdo grup të marrë përsipër
të mbledh metarial muzikor
nga të trija llojet
e muzikës, që u morëm.

6. Gërneta, pra, bën një udhëtim të madh e të largët,duke kaluar pothuaj nga gjithë bota. Çdo popull që e takonte, luante me të, me llojin e muzikës që shprehte më shumë. Me pretekst udhëtimin e tij, folëm për të tri llojet e muzikës: klasiken, tradicionalen dha xhaz. Mund të gjesh ç'muzikë luajnë muzikantët në secilën nga fotografitë e mëposhtme?







## 7. Muzika dhë mërgimi

Më 2005, një muzikant grek nga Epiri, Petrollukas Halkias, mjeshtër i gërnetës tradicionale,bëri një koncert në teatrin e Likavitos në Athinë. Gjeja e veçantë në koncert ishte se bashkë me të luajtën muzikantët nga India dhe Afrika. Le të lexojmë intervistën që dha pak ditë para koncertit.

**«Megjithatë nuk qëndruat atje [nënkupton Janinën] Ikët për në Amerikë...»**

*«U mërgova, si shumë bashkëvendasit e mi, në Amerikë. Epirotët njohin mirë çdo të thotë mërgim. Qëndrova 20 vjet në Nju Jork. Ngrita dyqanin tim, i shoqëruar gjithmonë me gërnetën. Luaja kaba me gërnetë tek të huajt, vaje epirote pa ndonjë përpjekje për t'i ndryshuar. Luaja si i dija qysh nga vitet '60. Si i kisha mësuar në vendin tim. Në dyqan vinin njerëz me ngjyrë të zezë, të verdhë, njerëz nga gjithë bota dhe më kërkonin të luaja gërnetë të vërtetë. "I thoni të luajë ato epirote" u thoshnin kamarierëve. Dëgjonin të heshtur dhe qanin...»*

**«Qysh atëherë kishit mësuar pse gërneta mund të mallëngjejë dhe të kombinohet me muzika të tjera nga bota...»**

*«Gërneta mallëngjen. Tingujt e Epirit mbyllin në vetvete njeriun dhe emocionet e tij. Shpirtin e tij... Qajmë nga gëzimi por dhe nga hidhërimi dhe gërneta di t'i shpjegojë të gjitha këto. Sa kalojnë vitet, aq më thellë hyj në thelbin e gërnetës. Rri dhe sjell në mendjen time, në të shtatëdhjetat e mia sot,moshën time 18 vjeçare. Bashkë me kujtimet vijnë tingujt, të cilët i riprodhoj ndryshe, sipas mjedisit në të cilën ndodhem. Nuk luaj gjithmonë të njëtën pjesë... Kjo është e çuditshme tek unë. Vetëkrijoj sipas mjedisit në të cilin mdodhem. Syri im dhe mendja ime bashkëpunojnë. Mund të mos shikoj njerëzit që kam para meje në dyqane dhe në koncerte. Por kuptoj si ndjejnë. E njëjta gjë ndodh me muzukantë të ndryshëm të këtyre takimeve. Muzika indiane është shumë afër me forcën emocionale që nxjerr gërneta...»*

**«Çfarë të presim prej jush në shfaqjen e Likavitos?»**

*«Kam përgatitur këngë të reja, por edhe disa prej tyre kemi luajtur në koncertet tona unë dhe indianët. Më i mahnitshëm është grupi ynë i ri, muzikantët afrikanë.*

*Pres si e si të shoh si mund të më ndjekin. Kam mësuar gjithashtu se do të ketë dhe ata indianë që do të luajnë me zjarret. Dhe ne kemi zakone me zjarret. Besoj se do të jetë një mbrëmje mjaft e mirë...»*

***«Çfarë ju ndihmon dhe ju jep kurajo kaq vjet?»***

*«Nuk di sa më kanë ndihmuar malet e Epirit në muzikën time... Kur bëra tingujt baritorë shkova atje dhe jetova në natyrë. U ngrita, zbrita nga malet, dëgjova tingujt e këmbanave të tufave, fryrjen e erës, zhurmën e lumit dhe të gjitha këto i bëra tinguj. Mendoja natyrën dhe luaja... Edhe gjyshërit tanë këtë gjë bënin. Derdhën gjakun e tyre për të mbajtur këtë vend dhe bëmat e tyre u bënë tinguj të këngëve. Do të jem i kënaqur të vdes dhe të di se disa do të jenë në gjendje t'i mbajnë të gjalla.»*

*http://www.hotstation.gr/article678.html*

Muzikanti përmend në fillim të intervistës së tij se «...Epirotët njohin mirë çdo të thotë mërgim». Pse besoni se e thotë këtë? Kërkoni informata për temën «Epiri dhe emirgimi».

Muzika mund të themi se është një «gjuhë» me të cilën njerëzit komunikojnë pavarësisht nga vendi i prejardhjes së tyre dhe gjuhën e folur në vendin e tyre. Petrollukas Halkias thotë se në Nju Jork luante në një dyqan këngë epirote.

- Ç' prejardhje besoni se ishin dëgjuesit e tij me ato që thotë?
- Ç' emocione iu shkaktonte muzika që dëgjonin?
- Mund të të mallëngjejë një muzikë që nuk është e vendit tënd?
- Nëse po,pse beson se ndodh kjo?

«Tingujt e Epirit mbyllin brenda tyre njeriun me ndjenjat etij. Shpirtin e tij... Qajmë nga gëzimi, nga hidhërimi dhe gërneta di si t'i shpjegojë të gjitha këto» muzika mund të tregojë histrori...

Dëgjoni pjesën e mëposhtme [A.7.2.] dhe përpiquni të bëni një histori për dikë që detyrohet të emigrojë nga vendi i tij. Historia duhet të thotë ku jetonte fillimisht, në cilën vend vendosi të shkojë, për ç' arsye u emigrua, si ndërtoi shtëpinë e re dhe nëse përfundimisht qëndroi atje ose u kthye në atdheun e vet. Tregojeni historinë në klasën tuaj duke vlerësuar si shoqërim muzikor pjesën që dëgjuat.

- Besoni se fakti që Petrollukas Halkias udhëtoi dhe jetoi në vend tjetër e ndihmoi të bashkëpunojë me muzikantë nga vende të tjera dhe nëse për cilën mënyrë?
- «...Mendoja natyrën dhe luaja... Dhe gjyshërit tanë atë bënin. Derdhën gjakun e tyre për të mbajtur këtë vend dhe bëmat e tyre u bënë tinguj këngësh. Do të jem i kënaqur të vdes dhe tëe di se disa do të jenë në gjendje t'i mbajnë të gjalla». Pse muzikanti e konsideron se është aq e rëndësishme të ruhet gjallë tradita muzikore?

8. Dëgjoni këngët: E.9.8. «Jani im, shamia jote». Në këngën dëgjohet se shaminë e ndoti mërgimi. Përdorni fjalorin dhe gjeni përkufizimin e mërgimit dhe fjalë të tjera sinonime. Fjalët dhe në të dyja gjuhët në kuadrate dhe i varni në klasë.

Nga sa keni lexuar mund të jepni një përkufizim për emigrimin?

Emigrimi është..............................................................................................................

..............................................................................................................................................

..............................................................................................................................................

9. Lexoni të dhënat bibliografike të bamirësve të mëposhtëm.Ishin dhe ata emigrantë dhe u shquan jashtë shtetit dhe në vendet e tyre. Përcaktoni ecurinë e tyre ne rrugën e emigrimit dhe në jetën e tyre.

**Apostolos Arsakis (1792-1874)**



Apostolos Arsakis lindi më 1792 në fshatin e vogël Hotahovë, afër Përmetit. Fillimisht shkoi tek xhaxhai i tij në Bukuresht, mësoi shkronjat e para dhe pastaj në Vjenë, ku mësoi gjuhën greke me mësuesin Neofito Duka. Përfundimisht studioi për Mjekësi në Universitetin e Hallit. Pas studimeve u vendos në Rumani dhe arriti postet e larta, ministër i jashtëm, kryetar i këshillit të Ministrave të Rumanisë dhe për pak kryeministër i Rumanisë. Edhe pse me shumë poste nuk harroi atdheun e tij. Fillon me meremetimin e kishës së fshatit të tij dhe pastaj vëmendjen e tij e tërheq vepra Shoqërisë Arsimdashëse të Athinës (Shkollë femërore, Shkollë, Kishë) në të cilën u emërua bamirësi i madh.

*http://www.neb.gr/node/60*

**Domenikos Theotokopulos (1541-7 Prill 1614)**



Domenikos Theotokopulos, i njohur gjithashtu me nofkën italiane El Greko [i] d.m.th Greku, ishte piktor nga Kreta,skulptor dhe arkitekt i rilindjes spanjolle. Jetoi pjesën më të madhe të jetës së tij larg atdheut duke krijuar pjesën kryesore të veprës së tij në Itali dhe Spanjë. U arsimua fillimisht si ikonograf në Kretë, ku bërbënte atëherë pjesë të shtetit Venedikas dhe më vonë udhëtoi në Veneti. Në Itali u ndikua nga mësuesit më të mëdhenj të artit italian, si Tidoreto dhe Ticiano, i të cilit ishte nxënës, duke adoptuar elemente nga manierizmi. Më 1577 u vendos në Toledo, ku jetoi deri në fund të jetës së tij dhe perfundoi disa nga vepat e tij të njohura.

*http://el.wikipedia.org*

**Jeorgios Papanikolau, bamirës i madh i njerëzimit**



Ishte shkencëtar I veçantë Grek i padiskutueshëm jo vetëm për Greqinë, por për gjithë botën Jeorgios Papanikolau. Lindi më 1883 në Kimi. Gjermania ishte vendi i parë që e mahniti. Atje, veç Filozofisë, kishte mundësi të merrej me Biologjinë. Plasi lufta e Parë Ballkanike që e risolli në Greqi për ta mbrojtur, rrëmbeu rastin vendimtar për karierën e tij të njohë ushtarakë grekoamerikanë, të cilët e nxitën të vizitojë Amerikën, vendin që më vonë u bë atdheu i dytë.
Atje emigranti i varfër dhe i panjohur, u zhvillua me vrull në formë heroike nga nëpunës në dyqane dhe gazetar në gazetë greke në fillim, me vështirësi, fiton një vend në Laboratorin e Anatomisë në Universitetin Columbia dhe më vonë në Cornell të Nju Jorkut. Punon natë e ditë duke vënë në veprim mundësitë e tij të të pakufishme.
Për kontributin e tij mori shumë tituj nderi, jashtë shtetit dhe në Greqi. U propozua për çmimin Nobel. Greqia e nderoi duke vënë formën e tij në kartmonedhën e dhjetë mijë dhrahmive dhe në pulla.Pulla, gjithashtu,nxorën Qipros dhe SH.B.A.

*http://www.cuma.gr*

**Nënë Tereza, kontributi i rëndësishëm i «motrës së shpirtit», një nënë ndërkombëtare (Nobel i paqes i 1979).**



Lindi me emrin Gonxhe Bojaxhiu, në krahinën që sot gjendet në Shkup, nga familje shqiptare. Vendosi të udhëtonte në Dublinë për t'u inkuadruar tek motrat Loreto, një batalion që u krijua në shekullin e 17të. Batalioni e dërgon në qytetin Darzling në Indinë verilindore. Më 24 Maj 1931,Bojaxhiu merr emrin e murgjeshës që e bëri të njohur në gjithë botën: Nënë Tereza. Kalonte orë të pambaruara nëper rrugët e Kalkutës,duke mësuar fëmijtë të lexojnë dhe të shërohen nga sëmundjet e tyre.
Më 1971,Nënë Tereza merr çmimin i parë Nobel që ia jep Papa.
Tetë vjet më vonë, më 1979, i jepet murgeshës së madhe çmimi Nobel i Paqes.
Vetë deklaroi: «E mora në prani të Akademisë Suedeze dhe të njerëzve të fortë të botës në emër të të varfërve,sepse besoj se duke më dhenë këtë titull

nderi,pranojnë ekzstencën e të varfërve në tokë... Isha dhe unë një nga ata. Në gjak isha shqiptare, shtetase indiane, isha murgeshë katolike, sa për destinacionin tim, i takoja botës. Dhe nëse ekzistonin të varfër në hënë do të shkoja dhe unë atje».
Deri më 1997, kur Nënë Tereza la frymën e fundit më shumë se 3.000 Motra të Shpirtit ndodheshin në më shumë se 25 vende. Shikoni videon përkatëse (Nënë Tereza).
*http://www.enet.gr/onlinetext/c=111. d.t=27.08.2001,id=56214556*

- Mos njeh ndonjë tjetër që mori rrugën e mërgimit dhe u shqua në atdheun e ri?
- Mund tani të kuptosh çfarë do të thotë fjala «bamirës»? Shkruaj përkufizimin e saj.

Në shkollën tënde ose në qytetin tënd ndoshta ekzistojnë grupe ndërkulturore ose shkolla. Mund të organizoni nje ekskursion në atë shkollë. Atje mund të diskutoni me nxënësit, përvojen tuaj. Në Gjermani, Zvicër, Australi dhe në vende të tjera ekzistojnë shkolla me nxënës Grekë dhe me nxënës Shqiptarë. Mund të kominikoni me ta,pasi të vizitoni faqet e internetit të tyre dhe të binjakëzoheni me ndonjë prej këtyre shkollave. Bëj regjistrimin tënd të këngëve (muzikë dhe fjalë). Mund të jenë këngë popullore,rebete dhe të tjera. Këngët do të përbëjnë material nga i cili do të zgjidhen këngët që mund të mësoni t'i këndoni (në orën e mësimit të Muzikës) ose të kërceni (në orën e mësimit të Gjimnastikës) për t'i paraqitur në aktivitetin e fundit të shkollës

10. Gr. Kacalidhas, «Amerikë», Këngë popullore nga V. Epiri, f. 426. Lexoni dëshmitë e mëposhtme të njerëzve që udhëtuan ne kushte shumë të vështira duke kërkuar «tokën e premtimit».

A. Kordopatis, përshkruan udhëtimin më të fashmën «Austroamerikane». *(http://politikokafeneio.com/istoria/usa106.htm).*

«Tri ditë ecnim, të martën në mesnatë, anija u prish, pa kuptuar asgjë ne. Vetëm kapitenët dhe mekanikët e dinin dhe në vend që të shkonte para, kthehej pas. E rregulluan dhe filloi përsëri të shkonte, por rregullim i rremë, bëri vetëm tetë milje. Dy orë me këmbë, një me anijen Austroamerikane, Anonte anash.Tendoseshim poshtë dhe kapnim ujin e detit kur ishte i kaltër. Kur koha ishte e zezë, trëmbeshim shumë. Shpirti i njerëzve ishte fundosur tek frika. Për të ngrënë therrnin dhe na jepnin disa kuaj të vjetër. Pothuaj një javë e nxorrëm me ato që kishim blerë tek Patra, por shpëtuam. Na jepnin disa harenga me krimba, të prishura, i flaknim. Jetonim brenda këtij tmerri, poshtë deti, sipër qielli. Pastaj u shfaq morri. Rrinin të ngritura tek palltot të pasagjerëve, te bardha me bisht. Për pak ditë me vonesën e anijes, uji u pakësua. Tre mijë njerëz që ishim brenda kishim etje. Mblidheshim si milingona para depozitave dhe atje prishej bota». (Rreth viteve 1900).

2001 në Greqi:

1 dhjetor 2001: Gjashtë Avganë të arratisur humbën jetën e tyre, duke u përpjekur të kalojnë me varka plastike për fëmijë nga Aivali në Mitilini.

10 dhjetor: Dyzet Kurdë dhe Irakianë të arratisur që kishin arritur në brigje të Lakonisë zbritën në Jithio.

22 dhjetor: Katër të arratisur nga Iraku u vranë në fushë të minuar në Evro,duke kaluar në tokën greke. Tri të tjerë u plagosën nga minat që plasën.

8 dhjetor: 180 nga 700 të arratisurit që kishin arritur në Zakintho.

5 nëntori: Dërgohen në një repart ushtarak të braktisur rrezë malit të Olimbit, dhe lihen pa ushqime dhe pa ngrohje. Burra,gra,fëmijë nisin marshim brenda në borë, për të ikur dhe përfundojnë në një kishë të vogël të fshatit Pithio.

3 shkurt: Trishjetë klantëstinë u zbuluan dje në darkë brenda një vendi të fshehtë në kamion, i cili ndodhej në portin e Patrës dhe do të futej tek anija Olimpic Champion, me destinacion Italinë. Pesë prej tyre i çuan në spital për arsye profilaktike, kurse të tjerët mbahen në kapitanërinë e portit. (www.114.org)




www.unhcr.gr/Ekdilosis.htm

- Përshkruani kushtet, udhëtimin dhe problemat e emigrantëve. Mund të mblidhni dhe dëshmitë tuaja dhe fotografi nga emigrantët.
- Ndiqni videot (1895-1905 Greqi-Mërgim, YouTube-Emigrimi-Këngë popullore, dhe PASSPORT PLEASE). E para i referohet emigrimit grek, e dyta emigrimit shqiptar dhe e treta ka karakter ndërkombëtar. Krahasoni dëshmitë, informatat dhe të dhënat që merrni nga videot me ato të aktivitetit të mëparshëm. Kaloi më shumë se një shekull. Çfarë ndryshoi?

Këtu udhëtimi ynë në Vjosë mbaroi.

Shpresojmë se mësuat shumë gjëra për muzikën tradicionale
të vendit tuaj dhe për njerëzit që jetojnë pranë lumit
të madh në të dyja anët e kufirit.

Ju përshëndesim ,të takohemi së shpej!



Tregues i fotografive

Të materiali fotografik i botimit vjen nga grumbullimet përsonale të pjesmarrësve të botimit dhe nga public  domain faqe interneti të mëposhtme:

http://www.grida.no/
http://www.un.org/Depts/Cartographic/english/htmain.htm
http://commons.wikimedia.org/
http://student.britannica.com
http://freephotos.lu/
http://freephotogate.com/
http://freephotogate.com/
http://pdphoto.org/
http://public-photo.net/
http://www.ars.usda.gov/is/graphics/photos/
http://www.bigfoto.com
http://www.freephotos.se/
http://www.imageafter.com/
http://www.morguefile.com/
http://www.public-domain-image.com/
http://www.publicdomainpictures.net/
http://www.public-domain-photos.com
http://www.republicdomain.com/
http://cultureportalweb.uoi.gr/cultureportalweb/index.php

Material edukativ eshtë krijuar në kuadrin e programit:

Bashkëpunim kërkues dhe edukimi nga largësia në kulturën greke

9789602331903

INTERREG III

Vepra u realizua ne kuadrin e Programit INTERREG III / PROGRAMI I FQINJESISE GREQI- SHQIPERI
Boshti 2-Metri 2.2. me bashkefinancim nga Fondi Evropian i Zhvillimit Periferik (F.E.ZH.P.) dhe nga Burime Kombetare.
Pergjegjes Shkencor: Anastasios Emvalotis, Profesor Asistent i Universitetit te Janines